Sipas informatave të fituara nga Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, momentalisht nuk ekziston ose nuk është përgatitur analizë për shpenzimet, përkatësisht për kushtimin e një dite burgu për të dënuarin. Në përputhje me disa deklarata (të dhëna nga drejtorët e disa prej burgjeve), lartësia e kësaj shume, duke mos përfshirë kompensimet e të punësuarve nëpër institucione, lëvis prej 150-300 denarë në SHNP (Shtëpinë ndëshkuese përmirësuese) në Idrizovë, 1.100 denarë në burgun e Ohrit, 800 denarë në burgun e Manastirit.<sup>13</sup> Është i dukshëm dispariteti dhe jo realiteti i shpenzimeve të këtylla, që gjithashtu, ishte konfirmuar edhe nga burimi i të dhënave. Kjo tregon se Drejtoria nuk ka ndërtuar metodologji për caktimin e çmimit të kushtimit të një dite burgu të burgosurit, i cili vuan dënimin në burg. Gjithsesi, ekzistimi i një metodologjie të këtillë të punës të Drejtorisë dhe të SHNP do t'ua lehtësonte punën dhe planifikimin, e njëherësh është një domosdoshmëri, shikuar nga aspekti i masave alternative, veçanërisht gjatë evaluimit të tyre dhe vlerësimit të kushtimit të tyre.

## 1.2. DËNIME AFATSHKURTËR ME BURG

Kur flasim për politikën ndëshkimore të ne, është i padyshimtë fakti se dominojnë dënimet afatshkurtër me burg.<sup>14</sup> Sipas pasqyrës për vitin 2003<sup>15</sup>, dënimet afatshkurtër me burg marrin pjesë me një përqindje tejte të lartë nga numri i përgjithshëm i personave të dënuar. Vetëm dënimi me burg deri në një vjet merr pjesë me mbi 60% nga numri i përgjithshëm i të dënuarve.

Sipas të dhënave të tjera, përfaqësimi procedural i dënimeve afatshkurtër me burg deri në 1 vjet, në vitin 1998 merr pjesë me 9.2% nga numri i përgjithshëm i dënimeve me burg, kurse deri në 3 vjet, me 9.5%. Në vitin 1999 dhe 2000 dënimet me burg deri në 1 vjet arrinin 32%, kurse deri në 3 vjet 48,5% nga numri i përgjithshëm i dënimeve me burg. Në vitin vijues 2004, dënimet me burg deri në 1 vjet kanë qenë 30%, deri në 3 vjet- 41%, kurse në vitin 2005 kjo përqindje arrin 28% deri në 1 vjet dhe 38% deri në 3 vjet<sup>16</sup>.

<sup>10</sup> Lupço Arnaudovski, „Mbikëqyrja mbrojtëse dhe sanksionet alternative në konceptin e reformës së legjislacionit ndëshkimit të Maqedonisë”, faqe 12, në Eliminimin e pengesave për implementim praktik të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, 2002, Shkup.

<sup>11</sup> Në tekstin e mëtejshëm do të përdoret termi masa alternative.

<sup>12</sup> Gordana Buzharovska, Alternativa të burgut, faqe 263.

<sup>13</sup> Informatë nga zonja Lidija Gavrilovska, drejtoreshë e Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve.

<sup>14</sup> Dënimi më i ulët me burg arrin 30 ditë.

<sup>15</sup> Dragan Tumanovski, „Roli i Gjykatës Supreme në krijimin e politikës ndëshkimore në Republikën e Maqedonisë, faqe 73, Revista maqedonase për të drejtën ndëshkimore dhe kriminologjinë, Shoqata për të drejtën penale dhe kriminologjinë, UKD 343, viti 12, nr. 2, 2005, Shkup.

<sup>16</sup> Pasqyrë statistikore, 328, „Kryerës të veprave penale, të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar në vitin 1998, madhor dhe të mitur”, Enti i Statistikës i Republikës së Maqedonisë, 1999, Shkup, faqja 10; Kumtesa 2.1.4.08 - 2003; 2.1.5.13 - 2004; 2.1.6.13 - 2005, Enti shtetëror i statistikës i Republikës së Maqedonisë, Shkup. [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)

VITI	Deri në 30 ditë	1-2 muaj	2-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjeç	2-3 vjeç
1998	12	56	138	140	46	14	3
1999 <sup>17</sup>	94	246	1181	1604	1015	n/dh	n/dh
2000 <sup>18</sup>	100	225	1106	1514	1100	n/dh	n/dh
2003	26	53	374	723	768	679	186
2004	35	52	415	690	712	464	178
2005	23	71	428	712	783	511	214

Sa u përket dënimeve afatshkurtër me burg, teoria dhe praktika flasin për pamundësinë që t'i arrijnë qëllimet e dënimit, e as që të ndikojnë tek personi i dënuar, e as tek të tjerët në bashkësi, sepse me këtë nuk frikësojnë e as zbrapsin nga kryerja e veprave penale, nuk ndikojnë në përmirësimin e të dënuarve, sepse janë tejet të shkurtër që të mund të risocializojnë dhe rehabilitojnë ndokënd. Kritikant në këtë kontekst flasin se as preventiva e përgjithshme e as ajo speciale, nuk realizohen. Gjithashtu, Rezoluta numër 17 e vitit 1973, e Këshillit të Evropës flet për të njëjtin fakt, për rritjen e dënimeve afatshkurtër me burg, vështirësitë e trajtimit dhe metodave të preventivës së recidivizmit, shpenzimet për mirëmbajtjen e institucioneve penale, efektet e stigmatizimit, nevojën aktivimit të kujdesit social dhe nevojën e zvogëlimit të rolit të burgut, si dhe aplikimin e inovacioneve në sistemin e formave më ndryshe të veprimit gjatë ndëshkimit, veçanërisht me një lloj të caktuar kryerësish<sup>19</sup>.

Viti	Gjithsej	Dënim me burg	Dënim me holla	Vërejtje gjyqësore	Me kusht		
					gjithsej	burg	Të holla
1995	7711	5464	2095	168	3216	3192	24
1998	6128	4280	1555	137	2494	2347	137
2003	7661	5796	1671	183	3166	2831	335
2004	8097	6200	1689	201	3612	3456	156
2005	8845	7168	1521	149	4307	4221	86

<sup>17</sup> Gordana Buzharovska, Alternativa të burgut, faqe 306.

<sup>18</sup> Ibid.

<sup>19</sup> Rezoluta (73) 17, për trajtim afatshkurtër të kryerësve të rritur, Komitetit i ministrave, Këshilli i Evropës, 13 prill 1973.

<sup>20</sup> Dënime të shqiptuara me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse: 1995 prej gjithsej 2463 dënime me kusht vetëm 4 janë me mbikëqyrje të mbrojtur, në vitin 1996 prej gjithsej 2394 dënime me kusht vetëm 3 janë me mbikëqyrje mbrojtëse, në vitin 1997 prej gjithsej 1954 të dënuarve me kusht, nuk është shqiptuar asnjë dënim me mbikëqyrje mbrojtëse, në 1998 prej gjithsej 2347 të dënuarve me kusht, vetëm 4 janë me mbikëqyrje mbrojtëse, në 1999 prej gjithsej 2648 aktgjykime me kusht vetëm 3 janë me mbikëqyrje mbrojtëse dhe në vitin 2000 prej gjithsej 2440 të dënuarve me kusht, vetëm 5 janë me mbikëqyrje mbrojtëse. Dragi Calevski, „Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse”, faqe 35 në Eliminimin e pengesave për implementimin praktik të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, Qendra ndërkombëtare për aktivitetet preventive dhe zgjidhjen e konflikteve, shtator, 2002, Shkup.

Sa u përket llojeve të tjera të sanksioneve, që përdoren të ne, përveç burgut, gjykatësit më shpesh shqiptojnë dënim me të holla dhe dënim me kusht<sup>20</sup>. Siç duket, ky është repertori në të cilin lëviz kreativiteti i gjykatësit.

Përsëri kritikave për burgun, burgosja megjithatë, nuk mund të përjashtohet, ndonëse janë më se të njohura fushatat për abolicion të burgut<sup>21</sup> të cilat i preferojnë masat alternative, zgjidhjen e konflikteve, restitucionin e viktimave, punën në dobi të bashkësisë, si mënyrë e ballafaqimit me krimin<sup>22</sup>. Prapëseprapë, kritikë e veçantë u bëhet pikërisht dënimeve afatshkurtër me burg, për të cilat llogaritet se, jo vetëm që nuk është e mundshme ta risocializojnë (rehabilitojnë) personin, për një kohë aq të shkurtër dhe ta arrijnë qëllimin, por njëherësh çojnë në një varg dukurish negative të cilat, padyshim në masë të madhe, ndikojnë negativisht te i burgosuri. Rrënimimi i marrëdhënieve sociale, vlerave shpirtërore dhe morale, stigmatizimi nga ana e bashkësisë, ndërprerja e punësimit, ndërprerja e lidhjeve me familjen<sup>23</sup>, janë vetëm një pjesë e asaj që, për një kohë të shkurtër, mund ta bëjë burgun, veçanërisht për ata që për herë të parë kanë kryer delikt dhe për kryerësit e veprave penale të lehta. Tendanca e sotme është që burgun të përdoret si opsion i fundit- ultimo ratio.

### 1.3. KARAKTERISTIKA TË MASAVE ALTERNATIVE

Duke marrë parasysh njërin prej qëllimeve të sanksionit- riedukimin, pamundësinë ose vështirësitë e mëdha gjatë realizimit të rolit të risocializimit (rehabilitimit) të burgosjes, të kombinuara me shkallën e lartë të recidivizmit, efektet pas burgimit, mundësitë ligjore për mënyrë alternative të sanksionimit, logjikisht shpie drejt përfundimit se mënyra më ndryshe e veprimit, është e domosdoshme edhe në praktikë. Format e mënyrave më ndryshe të ballafaqimit me krimin, nuk janë as risi, as diçka që duhet të ndjehet si e imponuar. Në të vërtetë, mënyrat me të cilat kanë vepruar kulturat e vjetra<sup>24</sup>, të cilat edhe sot ekzistojnë në disa pjesë të botës, mund të thuhet se e paraqesin lindjen e mënyrës së deinstitutionalizuar të ballafaqimit me deliktet, konfliktet dhe problemet shoqërore<sup>25</sup>.

Masat alternative në legjislativën paraqiten kah fundi i shekullit 20 dhe pranohen si mënyra alternative të veprimit, për veprat më të lehta penale, përmes mbikëqyrjes dhe trajtimit. Qëllimi i tyre është ta realizojnë ose ta arrijnë qëllimin e sanksioneve, duke iu shmangur, me këtë rast, elementeve negative, që janë të lidhura me burgimin, si sanksion i përdorur më shpesh.

Masat alternative i përfshijnë format e deinstitutionalizuar të reagimit, risocializimit dhe restitucionit të dëmit të bërë. Ata mund të paraqesin sanksione që realizohen në bashkësi<sup>26</sup>,

<sup>21</sup> Gjorgji Marjanoviq, „Në kërkim të alternativave për burgun”, faqe 192, Vjetari i Fakultetit juridik, Shkup; Gordana Buzharovska, „Nevoja e masave alternative” faqe 19, në Eliminimin e pengesave për implementimin praktik të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, 2002, Shkup.

<sup>22</sup> [www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org), Wikipedia, “Prison abolition movement”.

<sup>23</sup> Rekomandimi 1340 (1997) për efektet sociale dhe familjare të burgosjes, Këshilli i Evropës, 22 shtator, 1997.

<sup>24</sup> Mark S. Umbreit, Marquette law Review, Restorative Justice in the 21<sup>st</sup> Century: A Social Movement full of opportunities and Pitfalls”, 2006.

<sup>25</sup> Kongresi i gjashtë i Kombeve të Bashkuara për preventivën nga krimi dhe trajtimin e kryerësve, “Deinstitutionalizimi dhe alternativat e burgosjes”.

<sup>26</sup> Gordana Buzharovska, Alternativat e burgut, faqe 47

masa që mund të aplikohen në pjesë të ndryshme të procedurës, duke filluar me policinë dhe prokurorin publik, duke vazhduar në procesin sjelljes së aktgjykimit dhe në procesin e kryerjes së sanksioneve të cilat nuk paraqesin privimin nga liria në mënyrë institucionale, por realizimin e të njëjtëve në liri. E prezantuar përmes krahasimit, kjo do të thotë, në vend të arrestimit- vërejtje ose aktivim të programeve<sup>27</sup>; në vend të akuzës- shtyrje e ndjekjes; në vend të dënimit- restitucion, kufizim i të drejtave, kompensim, dënime me kusht, kufizim të lirisë, punë të gjithëdobishme; në vend të burgut - falje e kushtëzuar ose të ngjashme<sup>28</sup>.

Aktualizimi i humanizmit gjatë dënimit, midis tjerash, rezultoi edhe nga kritikata ekzistuese të politikës ndëshkimore, joefikasitetit të dënimit me burg, kthimit, kushteve në burgje dhe efektet që i bartin me vete. Dënimi, pa izolim ose pa largimin e kryerësve të veprave të caktuara penale nga fusha e dukshme e shoqërisë, është ideja që solli paraqitjen e llojeve alternative të reagimeve ndaj sjelljeve të caktuara kriminale. Aplikimi i sanksioneve alternative, në formën që është e njohur sot, u paraqit në vitet e 50-ta dhe 60-ta të këtij shekulli.

Masat alternative janë sanksione, që do të thotë se ata nuk paraqesin alternativë të dënimit ose, më saktësisht, të ikjes nga dënimi, por një prej llojeve të sanksionimit, me të cilat i iket burgut, si dënim. Më saktë, me ata personi dënohet, përkatësisht sanksionohet, varësisht nga ajo se cila masë alternative do të shqiptohet nga gjykata. Mënyra e këtillë e veprimit do të thotë intervenim dhe në një mënyrë të caktuar, modifikim i mënyrës së dënimit përmes shmangies së burgut, por jo edhe ikjes së obligimeve të tjera, përmbushjes së kushteve të caktuara, abstenimit nga punë të caktuara, disa gjërave që bëjnë ose nuk bëjnë, kontrollit të sjelljes e të ngjashme.<sup>29</sup> Masat alternative ndikojnë në atë mënyrë që personin e lënë në bashkësi, të lirë, ku me ndihmë të caktuar dhe me kontroll mbi sjelljen e tij bëhet përpjekje që ai ta zhvillojë përgjegjësinë e vet dobishmërinë ndaj bashkësisë<sup>30</sup>. Është fjala për përgjegjësi të dyfishtë. Njëra anë është e paraqitur përmes gatishmërisë së personit që ta përmirësojë sjelljen, por nga ana tjetër, është edhe bashkësia dhe përgjegjësia e saj që ti evitojë faktorët, ndikimet që kanë shkaktuar sjelljen e tillë.

Në raste të caktuara burgu, si dënim, paraqet zgjidhje adekuate, megjithatë në raste të shumta ky nuk është reagim adekuat. Masa joburgimi ose masa alternative, në situata të shumta, do të ishte shumë më adekuate që, gjithsesi, varet nga kryerësi i veprës, legjislacioni, por edhe nga njohjet dhe pranueshmëria e dënimeve joburgimi ose masave alternative nga ana e gjykatave dhe organeve të tjera të përfshira në proces.

<sup>27</sup> Edhe pse fjala diversion në gjuhën maqedonase ka edhe kuptim tjetër, megjithatë në këtë kontekst nuk do të ndërhyjmë në mundësitë e saktësisht adekuat terminologjik të këtyre programeve. „Diverzioni ose heqja dorë, janë programe që zbatohen në rastet e veprave të vogla të ndëshkueshme ku në vend të procedurës formale ndëshkimore shkohet kah masat e bashkësisë.“, Gjorgji Marjanoviq, „Në kërkim të alternativave të burgut“, faqe 200; „...programet diverzive janë një lloj alternativ i veprimit që paraqet shmangie nga sistemi klasik legjislativ dhe bartje e sistemit të kontrollit social, përkatësisht aktivitet më i madh i shërbimeve sociale gjatë punës me kryerësit e veprave penale. Sanskionet penale zëvendësohen me masa të kujdesit, ndihmës, masa medicinale etj...“, Oliver Baçanoviq, „Drejtësia restorative me vështrim të veçantë ndaj ndërmjetësimit ndërmjet viktimës dhe kryerësit“, faqe 37, në Eliminimin e pengesave për implementimin praktik të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, 2002, Shkup.

<sup>28</sup> Kongresi i gjashtë i Kombeve të Bashkuara.

<sup>29</sup> Gordana Buzharovska, Alternativa të burgut, faqe 228, 229.

<sup>30</sup> Bishop and Schneider, „Improving the Implementation of the European Rules on Community Sanctions and Measures: Introduction of the new Council of Europe Recommendation“, European journal of Crime and Criminal Justice, vol.9/3, Marthinus Nijhoff, 2001.

Sa i përket personalitetit të kryerësit, që të aplikohen masat alternative duhet të bëhet fjalë për kryerës të veprave penale, që janë më pak të rrezikshëm. Mendohet për ata për të cilët llogaritet se rreziku nga kryerja e serishme e veprës penale është i ulët dhe se në raste të caktuara, me masa të ndihmës dhe asistencës, personi do të kënaq standardet, përgjithësisht të pranuarra, të<sup>31</sup>. Në atë kontekst, për shembull, masat alternative mund të aplikohen për persona, për të cilët, sipas karakteristikave ose profilit të tyre, karakteristikave ose veçorive ligjore të veprës, mund t'u shqiptohet ose u shqiptohet dënim afatshkurtër me burg; të jetë fjalë për ata që kanë kryer për të parën herë delikt<sup>32</sup>; e bëhet fjalë për kryerës të veprave të lehta penale (janë përfshirë vepra penale me rëndësi të vogël, përkatësisht krimi i lehtë dhe ai i vogël (bagatell<sup>33</sup>); të japë pëlqim i dënuari që t'i shqiptohet sanksion i tillë; të japë pëlqim personi i dëmtuar/viktima (në tekstin e mëtejshëm do të përdoret termi viktima, ndonëse zgjidhjet ligjore të vendit e përdorin termin i dëmtuar) që të shqiptohet sanksion i tillë. (Rregulla e Tokios-3.2)..

Gjatë implementimit të këtyre masave, duhet të mbahet llogari, patjetër, për liritë dhe të drejtat e kryerësit, në të vërtetë, ai/a jo ka të drejtë t'i ankohet organeve relevante lidhur me aplikimin e këtyre masave (3.6.); ka të drejtë kompensimi të dëmit në rast të mosrespektimit të ndonjë të drejte ose lirie të garantuar të njeriut (3.7.). Me këtë rregull lidhen drejtpërdrejt edhe rregullat që kanë të bëjnë me ndalimin e kryerjes së eksperimenteve mjekësore, psikologjike e të tjera, respektimin e dinjitetit të kryerësit, respektimin e të drejtës së privatësisë të kryerësit dhe familjes së tij, mbrojtjen e të dhënave që i përmban dokumentacioni (dosja) e personit e të ngjashme.

Instrumentet për realizimin e qëllimit të këtyre masave janë kushtet dhe obligimet që i imponohen personit si dhe mbikëqyrje së cilës i është ekspozuar. Megjithatë, duhet pasur kujdes që para zbatimit të ndonjë mase alternative, është e nevojshme që të merret pëlqim nga kryerësi (rregulla 3.4). Në këtë mënyrë sigurohet supozimi se personi do ta pranojë dhe do të bashkëpunojë për një aplikim më efikas të masës.

Esenca e këtyre masave është korigjimi i kryerësit, eliminimi i pengesave për një mënyrë të sjelljes së mëtejshme produktive dhe të pranueshme nga shoqëria. Prapëseprapë, dënimi paraqet gjithashtu, pjesë të këtyre masave sepse ekziston faji te personi për veprën e kryer, ekziston sanksioni, ekzistojnë detyrime që i imponohen dhe ekziston mbikëqyrje, por edhe masa kujdesi dhe ndihme me të cilat i ndihmohet personit në kryerjen e masave alternative.

<sup>31</sup> „Kryerës të rrezikshëm janë ata për të cilët konsiderohet se rishtazi do të kryejnë vepër penale, përkatësisht, recidivë të supozuar. Për shembull personat që përdorin drogë, më saktësisht vartësit, kanë më shumë gjasa të bëhen recidivë për dallim nga personat që nuk përdorin droga, të cilët për shkak se nuk ekziston vartësi, kanë gjasa më të vogla për këtë (edhe pse nuk janë pa gjasa). Përkrah këtu, rreziku më i madh ose më i vogël nga recidivizmi e formëson sferën e mbikëqyrjes, përkatësisht se si do të jetë ai, a nevojitet një mbikëqyrje më e fortë ose jo. Sipas studimeve të bëra, mbikëqyrja intensive dhe e forcur u tregua se është më e efektive të kategoritë e kryerësve të rrezikshëm të veprave penale, se sa te ata që janë më pak të rrezikshëm. Përkatësisht trajtimi i njëjtë (intensiv), te grupet me rrezik të lartë e ka zvogëluar recidivizmin, kurse trajtimi i tillë i njëjtë, te grupet me rrezik më të vogël gati se edhe nuk e ka zvogëluar, përkatësisht te të njëjtët recidivizmi është shtuar. Mbikëqyrja intensive përmirësuese (kushte burgu) për kryerësit me rrezik të vogël është krejtësisht jo efektive. Ata janë kusht për humbjen e faktorëve me rrezik të vogël që kanë shkaktuar kryerjen e veprës dhe shndërrimin e tyre në faktorë me rrezik më të madh (socializmi me kryerësit e veprave penale, me rrezik të madh, "infektimi kriminal", humbja e vendit të punës, miqve, obligimeve, kurse pritet se pas daljes bashkësia do ta pranojë duarhapur, është shumë pak e besueshme)". Lowenkamp, Latessa, "Understanding the Risk Principle: How and Why Correctional Interventions can Harm Low-Risk Offenders", Topics in Community Corrections, 2004. [www.nicic.org/Library/period266](http://www.nicic.org/Library/period266).

<sup>32</sup> Edhe pse edhe në tekstin tonë ligjor, njëri prej kushteve për shqiptimin e punës së gjithdobishme është që kryerësi për herë të parë të ketë kryer kundërvajtje, megjithatë, jo gjithherë, dënimi paraprak është rrethanë e vërtetë vështirësuese, te vepra e re penale, përkatësisht, nuk do të thotë se vepra paraprake e bën veprën e re penale me formë më të rëndë.

<sup>33</sup> Arnaudovski, Buzharovska, Celvski Nanev, "Strategjia e implementimit të masave alternative", faqe 64, Shkup, 2004

Është e qartë se masat alternative, ndonëse paraqesin njërin aspekt të drejtësisë restorative megjithatë, janë drejtuar më shumë kah kryerësi i veprës se sa kah viktima e veprës. Kjo ndodh me siguri sepse besohet se me një qasje të këfillë, shanset janë më të mëdha për korrësimin e vetë kryerësit, për pengimin e të njëjtit që të kryejë vepra penale si dhe për zvogëlimin e recidivizmit.

Ndonëse masat alternative kryesisht janë drejtuar kah kryerësit e veprave penale, megjithatë teorikisht, nuk e anashkalojnë rolin e viktimës. Këto masa përpunohen thellësisht ta ndryshojnë edhe raportin në mes të kryerësit të veprës dhe viktimës, para së gjithash, përmes vendosjes së komunikimit ndërmjet tyre dhe zgjidhjes së konfliktit të krijuar, nëpërmjet aktivimit të rolit të viktimës në procesin e propozimit dhe shqiptimit të masave alternative, eliminimit të pasojave, zhëmtimit të viktimës dhe sigurimit të mbrojtjes adekuatë. Mbrojtja nuk përdoret vetëm gjatë zhvillimit të procedurës, por edhe pas përfundimit të saj. Bëhet fjalë për mbrojtje, si gjatë procedurës, ashtu edhe nga kryerësi<sup>34</sup>.

Sa u përket organeve për implementimin e masave, përpos prokurorive publike dhe gjykatave, barrën më të madhe e kanë qendrat për mbrojtje sociale. Këtu shihet forma më ndryshe e reagimit dhe kryerjes së masave. Mbikëqyrja dhe kujdesi që i caktohen personit gjatë kryerjes së masave alternativ, janë në kompetencë të organeve speciale të cilat janë më pak represive dhe, para së gjithash, të motivuara dhe orientuara nga aspekte të tjera. Këta shërbime speciale të ne(tani për tani) janë qendrat për punë sociale. Në vende të tjera ekzistojnë të ashtuquajtura shërbime probative, në disa shtete janë përfshirë edhe organe policore e në disa ka vullnetarë të cilët i zbatojnë të njëjtat etj. Kjo tregon se spektri i mundësive që e ofrojnë këto masa është i madh dhe në disa vende tanimë ekziston një praktikë e mirë e rezultateve pozitive nga kryerja e tyre.

Forma deinstitutionale e reagimit shihet edhe në kyçjen e bashkësisë në kryerjen e masave alternativ. Këtu, para së gjithash, i marrim parasysh njësitë e vetëqeverisjes lokale ose komunat dhe banorët e asaj komune. Për shkak të kritikave ndaj retributivitetit në ndëshkimin dhe burgosjen, janë gjithnjë e më të shpeshta mendimet për kontroll social të krimit, si mënyrë e re e ballafaqimit dhe pengimit të krimit në bashkësi<sup>35</sup>. Gjithashtu, duke marrë parasysh faktin se burgjet nuk ofrojnë kushte përkatëse për zhvillim dhe për ndërtimin e shprehive të shëndosha dhe vlerave të shëndosha, por megjithatë janë institucione të cilat prodhojnë qytetarë "të rehabilituar", është e domosdoshme t'u vihet theks bashkësive ku kthehen këta individë. Ekzistojnë mendime në pajtim me të cilat pikërisht bashkësia në plan të parë ka qenë shkaktar i krijimit të rrethanave nga të cilat ka dalë "sjellja" kriminale" e individit, dhe bashkësia është vend ku individit do të kthehet pas rehabilitimit të izoluar në burg<sup>36</sup>. Pikërisht qëndrimi i këfillë është përkrahje e idesë se bashkësia duhet të marrë pjesë në përmirësimin e sjelljes së individit, që të kompensohet dëmi, si i viktimës së drejtpërdrejtë ashtu edhe i vetë bashkësisë dhe në preventivë të krimit. Megjithatë, në të njëjtën kohë kjo nënkupton edhe gatishmërinë e bashkësisë që të marrë pjesë, më saktësisht, të jetë një nga faktorët bartës të risocializimit dhe riintegritit të këtyre individëve- anëtarë pikërisht të kësaj bashkësie lokale.

<sup>34</sup> Arnaudovski, Buzharovska, Celvski Nanev, "Strategjia e implementimit të masave alternative", faqe 35-38.

<sup>35</sup> Gordana Buzharovska, "Alternativat e burgut", faqe 48.

<sup>36</sup> Vesna Nikolić-Ristanović, "Drejtësia restorative, ndëshkimi dhe viktimat", Alternativat e dënimeve me burg, Fondi Shoqëria e hapur, Beograd, 2005; Qëndrimet e këtilla mund të gjenden gjithashtu, edhe në: Tony Marshall, „Restorative Justice: An Overview”, p 5, London: Home Office Research Development and Statistics Directorate, 1999; Howard Zehr, Changing Lenses: A New Focus for Crime and Justice, p 181, Scottsdale, Pennsylvania; Waterloo, Ontario: Herald Press, 1990; Burt Galaway and Joe Hudson, Criminal Justice, Restitution and Reconciliation. Monsey, NY: Criminal Justice Press., 1990.; etc. source: www.restorativejustice.org



## KREU 2

# KORNIZA JURIDIKE E MASAVE ALTERNATIVE

## 2.1. DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE

Korniza ndërkombëtare me të cilën filloi të thellohet dhe , para së gjithash, të formësohet sistemi bashkëkohor i masave alternative, u përforcua në vitin 1980 në kongresin VI të Kombeve të Bashkuara (Karakas) të mbajtur prej prej 15 gusht deri në 5 shtator, kur me Rezolutën e miratuar u afirmua nevoja e sjelljes më aktive, zbatimit dhe zhvillimit më të gjere të formave të reja të këtyre masave. Qëndrimi i këtillë në nivel të KB vazhdoi dhe u dëshmuar edhe në kongreset vijuese, në Kongresin VII të KB në Milano (26 gusht-6 shtator 1985, në Kongresin e VIII të KM në Havanë (27 gusht- 7 shtator 1990). Pikërisht në këtë Kongres të VIII u përcaktuan rregullat themelore, standarde dhe minimale të veprimit, kur është fjala për dënime joburgimi, e të paraqitura nëpërmjet të ashtuquajturve Rregulla të Tokios<sup>37</sup>.

*Rregullat e Tokios* paraqesin pako të parimeve themelore për zbatimin e masave joburgimi<sup>38</sup>. Në këtë pako të parimeve janë përfshirë edhe garancitë minimale dedikuar personave të cilëve u shqiptohen këto masa<sup>39</sup>. Qëllimi i masave joburgimi përkatësisht i alternativave të burgut, është individualizimi më i madh i sanksionit , në përputhje me profilin e personit, që shpie në sistem më adekuat dhe më efikas të sanksionimit. Një prej rregullave shumë të rëndësishme është ndalimi i diskriminimit të personit të dënuar mbi çfarëdo baze<sup>40</sup>, në cilëndo pjesë të procedurës. Në këtë kontekst kërkohet nga shtetet që të sigurojnë kushte për trajtim të njëjtë gjatë zbatimit të masave të joburgimit. Gjithsesi, kjo nuk e shter përmbajtjen e këtyre rregullave. Në pakon e rregullave janë përfshirë dispozita të cilat sigurojnë pjesëmarrje më të madhe të bashkësisë në këtë proces, kërkojnë përgjegjësi më të madhe dhe kyçe të vetë personave që u nënshtrohen këtyre masave në tërë procesin e zbatimit të tyre, mbajnë llogari për të drejtat e viktimave, sigurinë e shoqërisë/bashkësisë dhe të preventivës nga krimi.

Këto masa në pajtim me rregullat mund të zbatohen në faza të ndryshme të procedurës, p. sh. Në procedurën hetimore edhe atë,nga ana e policisë dhe prokurorisë, në fazën e mbajtjes së procedurës nga ana e gjyqit, në fazën e zbatimit të masave ose në fazën e vuajtjes së dënimit me burg në një periudhë të caktuar.

<sup>37</sup> <http://www.un.org/documents/ga/res/45/a45r110.htm>

<sup>38</sup> Termi dënime jo me burg ka të bëjë me ato sanksione që i shqiptohen personit i cili është i dyshuar, i akuzuar ose i dënuar, e nuk përfshijnë privimin nga liria me burg.

<sup>39</sup> Garancitë minimale kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat që duhet t'i gëzojnë këta persona, pavarësisht se në cilën pjesë të procedurës zbatohen masat jo me burg.

<sup>40</sup> Rregulla 2.2. në mënyrë eksplicite i cakton këto baza themelore të diskriminimit: racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën fenë, mendimin politik dhe ndonjë mendim tjetër, prejardhjen nacionale ose sociale, pronësinë, lindjen ose ndonjë status tjetër.

Njëra prej rregullave duket sikur e relativizon obligueshmërinë e tyre kur përcakton se gjatë zbatimit të tyre doemos duhet të mbahet llogari edhe për rrethanat sociale, ekonomike dhe politike në shtete, që në të vërtetë ua lë shteteve të punojnë në realizimin e tyre. Këto rregulla nuk u imponohen shteteve, d.m.th. nuk janë obligative, por nëpërmjet vënies së kornizës së parimeve dhe praktikave të kapshme dhe të mira, ua lënë shteteve organizimin e sistemit të masave të joburgimit dhe ta harmonizojnë legjislacionin e vet me trendet universale.

Aktivitetet në këtë sferë nuk e lanë anësh as Këshillin e Evropës. Kështu, në vitin 1992 Komiteti i Ministrave miratoi Rekomandimin 16 (92) me të cilin u përcaktuan rregullat evropiane në sanksioneve dhe masave alternative të zbatuara në bashkësi dhe në vitin 2000 rekomandimin 22 (2000) për përmirësimin e zbatimit të rregullave evropiane për masat dhe sanksionet e zbatuara në bashkësi<sup>41</sup>.

*Rregullat evropiane* i rregullojnë aspektet më të rëndësishme të zbatimit të sanksioneve dhe masave alternative duke filluar me kornizat juridike të definimit të tyre, zbatimit dhe shqiptimit, garancisë gjyqësore dhe procedurës ankimore, respektimit të të drejtave dhe lirive pa përkufizim, ashtu siç janë paraparë në instrumentet për mbrojtjen e tyre (me përjashtim të atyre përkufizimeve që janë të domosdoshme, por që dalin nga sanksioni ose masa e shqiptuar) dhënies së pëlqimit nga ana e kryerësit, pjesëmarrjes së bashkësisë etj. Rregullat evropiane i vendosin standardet për zbatimin e tyre efikas dhe të drejtë. Rekomandimi i mëvonshëm i vitit 2000 u soll me qëllim që të shqyrtohet roli që e kanë këto sanksione dhe masa në politikën ndëshkimore të vendeve anëtare, të shihet efikasiteti i tyre, përkatësisht të shqyrtohet zbatimi i Rregullave evropiane në vendet anëtare. Ky rekomandim është rezultat i praktikës së vendeve në zbatimin e këtyre masave dhe përmban porosi për tejkalimin e vështirësive me të cilat janë ballafaquar shtetet në zbatimin e të njëjtave. Këto dy dokumente janë dokumente bazë (edhe pse jo të vetmit) në nivelin e Këshillit të Evropës të cilat vendosin minimumin e parimeve standarde dhe parimeve prijëse gjatë koncipimit dhe instrumentalizimit të politikave të shteteve në drejtim të ndërtimit të sistemeve efikase të sanksionimit alternativ (jo me burg).

## 2.2. LEGJISLACIONI I VENDIT

Në pajtim me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, qëllimi themelor i dënimit është pengimi që kryerësi të bëjnë vepra penale, riedukimi i tij si dhe ndikimi edukativ (frikësimi) i të tjerëve që të mos bëjnë vepra penale. Sipas legjislacionit tonë penal<sup>42</sup>, në kuadrin e dënimeve që mund të shqiptohen, janë përfshirë burgimi, dënimi me para, ndalimi për kryerjen e funksionit, ndalimi për të drejtuar automjete motorike, dëbimi i të huajit. Megjithatë, në kudër të sanksioneve, përpos dënimeve ekzistojnë edhe masa sigurie, masa edukative të të miturit dhe masa alternative. Me ndryshimet në Kodin penal në vitin 2004 u plotësua

<sup>41</sup> Përveç këtyre dokumenteve të cilat mund të thuhet se janë dokumente themelore, në nivel të Këshillit të Evropës sollën edhe një varg dokumentesh të tjera të cilat e formësojnë kontekstin që e përfshijnë masat alternative. Përveç tjerash, këtu i përfshijnë këta dokumente: Rezolutën (73) 17 për trajtim afatshkurtër të personave të rritur, Rezolutën (73) 24 për punën në bashkësi dhe punën grupore të personave të dënuar, Rezolutën (76) 10 për disa masa ndëshkuese alternative të burgut, Rekomandimin 1934 (97) për efektet sociale dhe familjare të burgosjes, Rekomandimin (83) 7 për pjesëmarrjen e opinionit në krijimin e politikave kriminale, Rekomandimin (85) 11 për pozitën e viktimës në të drejtën penale dhe në procedurën, Rekomandimi (87) 21 për ndihmë viktimave dhe preventivë nga viktimizimi, Rekomandimin (97) 12 për implementimin e sanksioneve dhe masave, Rekomandimin (99) 19 për ndërmjetësim në materien penale.

<sup>42</sup> Ligji për ndryshime dhe plotësime të Kodit penal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 19/2004.

sistemi i sanksioneve ku si lloj i veçantë u zbatuan masat alternative<sup>43</sup>. Edhe pse nuk është risi e plotë, duke marrë parasysh faktin se disa prej tyre kanë ekzistuar edhe më parë<sup>44</sup>, megjithatë klasifikimi i tyre si masa alternative dhe rritja e numrit të tyre padyshim vë në dukje zbutjen, humanizmin dhe ridefinimin e politikës ndëshkimore dhe afirmimin e konceptit të të drejtave dhe lirive të njeriut në sistemin e sanksioneve në Republikën e Maqedonisë.

Kështu, dënimi i mëparshëm me kusht, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe me vërejtje gjyqësore, ose të ashtuquajturat sanksione me vërejtje<sup>45</sup>, sot janë plotësuar dhe janë përfaqësuar nëpërmjet sistemit të masave alternative në të cilat janë inkuadruar edhe ndërprerja me kusht e procedurës penale, puna e gjithdoshme dhe burgu shtëpiak<sup>46</sup>. Këto masa formojnë pakon e alternativave të burgosjes. Megjithatë, legjislacioni ynë njih edhe lloje tjera të veprimit alternativ. Kështu, përveç në procedurën gjyqësore, kur gjykata mund të vendosë (duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat), ta shtyjë zbatimin, ta shtyjë shqiptimin e dënimit ose të mos shqiptojë asnjë lloj sanksioni, ekzistojnë edhe institute tjera. Me këto ndërlikohen edhe dispozitat për heqjen e dënimit për shkak të mënjanimit të pasojave të dëmshme, për ndërprerjen e procedurës, ndërprerjen e zhvillimit të procedurës, dënimit me të holla, garancisë, premtimit të kryerësit që të mos largohet nga vendbanimi etj.

Mund të thuhet se në legjislacionin tonë penal ekziston edhe një numër i madh institutesh, variantesh dhe formash të dënimit të kryerësve të veprave penale, të cilat edhe pse nuk janë inkuadruar në sistemin e masave alternative, megjithatë, i mbajnë karakteristikat e mënyrës pikërisht të këtyre të reagimit ndaj krimit. Megjithatë, në këtë kontekst do të ndalemi në ato masa alternative të parapara në kreun 4 të Kodit penal.

Në përgjithësi, kur flasim për masat alternative të ne, në të vërtetë është fjala për sanksione zbatimi i të cilave do të zhvillohet në bashkësinë me ndërmjetësim ose më saktë, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të shërbimeve të specializuara, me pjesëmarrjen e bashkësisë, me pëlqimin nga ana e viktimës dhe në pajtim (për masa të caktuara) dhe inkuadrimin aktiv të vetë kryerësit gjatë realizimit të të njëjtëve. Qëllimi i këtyre masave është që në lidhje me kryerësit fajtorë për vepra më të lehta penale, të mos zbatohen dënime, por nëpërmjet masave të ndihmës, kujdesit, vërejtjes dhe kërcënimit me dënim, të ndikohet te personi që ta ndryshojë sjelljen në liri<sup>47</sup>.

Aktor i domosdoshëm në këto skenarë është edhe viktimi, përkatësisht i dëmtuari. Në të vërtetë, në legjislacionin tonë ekzistues janë aplikuar edhe elemente të caktuara të cilat mund ta forcojnë rolin e viktimës dhe të jenë në relacion me standardet ndërkombëtare të pranuar për forcimin e pozitës së viktimës. Nga korpusi i dispozitave të këtyre do të përmendim nenin 145 të Ligjit për procedurë penale (LPP) të pasqyruar nëpërmjet parimit të oportunitetit të prokurorit publik, nenin 468 dhe 469 të LPP kur viktimi mund të kërkojë shqyrtimin e masave alternative, nenin 43-a të Kodit penal, lirim nga dënimi për shkak të mënjanimit të pasojave të dëmshme nga vepra, nenin 58-a të KP- ndërprerje me kusht e zhvillimit të procedurës penale, nenin 91-a të KP kur si një nga rrethanat përmendet edhe pajtimi me të dëmtuarin dhe kërkimi i pëlqimit nga i njëjti për shqiptimin e masës- ndërprerje e zhvillimit të procedurës penale, kësaj radhe kur është fjala për të mitur, nenin 177/2 të.

<sup>43</sup> Kodi penal, neni 4.

<sup>44</sup> Gjorgji Marjanoviq, faqe 300, 301.

<sup>45</sup> Vllado Kambovski, "E drejta ndëshkimore – pjesa e përgjithshme", faqe 820, Kultura, Shkup, 2004..

<sup>46</sup> Me përjashtim të burgut shtëpiak i cili si institut paraqet alternativë e mënyrës së realizimit/zbatimit të burgosjes..

<sup>47</sup> Kodi penal, neni 48.

Megjithatë, duket se te ne këta elemente janë të ndërlidhur edhe me respektimin e të drejtave të viktimës në procedurën penale ose janë të orientuara kah rezultati, përkatësisht kah mënjanimi i pasojave ose kompensimi i dëmit. Por, në të njëjtën kohë kjo nuk do të thotë mbrojtje e viktimës nga viktimizimi, mbajtje e llogarisë së viktima është e kënaqur me procedurën ose rezultatin nga ajo, se satisfaksioni e kënaq drejtësinë, shikuar nga aspekti i viktimës, e jo nga aspekti i gjyqit etj. Në masë të madhe dispozitat lidhur me kërkesat për t'i kërkuar falje viktimës, kompensimin e dëmit, mënjanimin e pasojave, më tepër anojnë kah roli i viktimës se sa kah ato dispozita që janë orientuar kah roli i viktimës.

Mund të përfundohet se theks më i madh i është vënë afirmimit të të drejtave të viktimës në procedurë, si e barabartë ndërmjet palëve, se sa ndaj afirmimit të rolit të saj dhe mbrojtjes nga viktimizimi i mëtejshëm. Nga kjo del se elemente të caktuara janë të domosdoshme në legjislationin tonë që të mund të themi se me të vërtetë ndiqen rrjedhat botërore në inkorporimin e të drejtës restorative në sistemin tonë.

**2.2.1. Dënimi me kusht<sup>48</sup>.** Dënimi me kusht nuk është risi në legjislationin tonë. Ekziston qysh nga ish sistemi penal-juridik. Dënimi me kusht është një prej sanksioneve të zbatuara më shpesh, i cili sot (me ndryshimet në Kodin penal) i takon sistemit të sanksionimit alternativ dhe shmangies së dënimit.

Gjyqi mund ta shqiptojë këtë sanksion në rastet kur është fjala për vepër të kryer penale, për të cilën është caktuar dënim me burg prej 2 vjet ose dënim me të holla<sup>49</sup>. Në këtë rast gjykata konfirmon se personi është fajtor për veprën e kryer, e dënon, që do të thotë i cakton dënim me burg ose me të holla, por e kushtëzon kryerjen e të njëjtit. Kushtëzimi nënkupton kanosjen se, nëse nuk kryen vepër të re penale në periudhë të caktuar kohore, (kjo periudhë nuk mund të jetë më e shkurtër se një vjet e as më e gjatë se pesë vjet), gjyqi nuk do ta shqiptojë dhe dënimi nuk do të kryhet. Gjatë shqiptimit gjykata e sqaron rëndësinë e këtij dënimi dhe kushtet të cilave duhet t'u përmbahet personi<sup>50</sup>.

Në këtë mënyrë, personi i dënuar lehet për tu kontrolluar në bashkësi në liri. Kontrollimi i sjelljes së personit përbëhet prej kontrollit jo vetëm të asaj se a është kryer ose jo vepër penale, por edhe kontrollit të (mos) plotësimit të kushteve/obligimeve, nëse i ka imponuar gjyqi, më saktë: se a është kompensuar dëmi, a është kthyer dobia pronësore etj. Është fjala për përcaktimin e kushtit themelor (moskryerje e të veprës së re penale) dhe kushtit plotësues dhe fakultativ (plotësim të obligimeve tjera).

Nëse personi, pas shqiptimit të sanksionit, derisa është në liri, sillet ashtu si i ka urdhëruar gjyqi, në periudhën kohore për të cilën është paraparë (prej një deri në pesë vjet) dënimi i caktuar nuk do të kryhet. Në të kundërtën, nëse gjyqi vërteton se obligimet e caktuara me aktgjykim nuk janë realizuar, mund ta vazhdojë afatin e plotësimit, mund ta zëvendësojë me obligim tjetër ose ta lirtojë personin nga plotësimi i obligimit, ta zëvendësojë me obligim tjetër ose, si masë e fundit, ta shqiptojë dënimin e caktuar<sup>51</sup>.

Këtu shtrohet pyetja si do të vërtetohet gjykata se a janë realizuar obligimet dhe, në të njëjtën kohë, në përgjithësi, në praktikën tonë gjyqësore, a janë shqiptuar dhe a është mbikëqyrur realizimi i obligimeve të këtylla, gjatë shqiptimit të dënimit me kusht.

<sup>48</sup> Kodi penal, neni 49.

<sup>49</sup> Dënimi me kusht nuk mund t'i shqiptohet të miturit!

<sup>50</sup> Ligji për procedurë penale, neni 346/2, Gazeta zyrtare nr. 74/2004, (teksti integral "Akademik").

<sup>51</sup> Ligji për procedurë penale, neni 494/4.

Nëse gjatë kohës së kontrollimit i dënuari me kusht kryen vepër të re penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me burg mbi dy vjet, gjyqi do ta revokojë dënimin me kusht. Nëse i dënuari me kusht bën vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me burg më pak se dy vjet, varësisht prej rrethanave, gjyqi do të peshojë se a do ta revokojë dënimin me kusht dhe çfarë mase ose dënimi do të shqiptojë për veprën e re<sup>52</sup>. Nëse edhe pas një viti nga kalimi i kohës kontrollim, personi nuk kryen vepër të re penale, i dënuari me kusht shlyhet nga evidenca ndëshkimore dhe konsiderohet si i padënuar.<sup>53</sup>

**2.2.2. Vërejtja gjyqësore<sup>54</sup>.** Gjithashtu, si dënimi me kusht ashtu dhe vërejtja gjyqësore është pjesë e ish legjislacionit. Vërejtja gjyqësore paraqet masë preventive speciale<sup>55</sup> të cilën gjykata mund t'ia kumtojë edhe personit i cili është fajtor për vepër të kryer penale, për të cilën është caktuar dënim me burg deri në një vjet ose dënim me të holla. Gjithashtu, kjo masë mund të shqiptohet edhe në situata të jashtëzakonshme kur është përcaktuar dënim me burg deri në tre vjet<sup>56</sup>.

Këtë masë gjyqi do ta shqiptojë kur është fjala për vepra më të lehta penale (me ç' rast mban llogari për personin, shkallën e përgjegjësisë penale, jetën e tij të mëparshme etj.), ku dënimi është i domosdoshëm, kurse qëllimi i dënimit konsiderohet se do të realizohet edhe me qortim, moslejim ose dënim moral të personit për atë që ka bërë). Gjatë marrjes së vendimit për vërejtje gjyqësore<sup>57</sup>, gjyqi e paralajmëron personin se për vepër penale nuk di t'i shqiptohet dënim sepse pritet që vërejtja gjyqësore të jetë e mjaftueshme që të mos kryejë vepra penale. Vendimi i këtillë mund të përmbajë edhe vendimin për masa sigurie, konfiskim pasurie etj<sup>58</sup>.

**2.2.3. Dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse<sup>59</sup>.** As kjo masë e cila në përputhje me Kodin penal të vitit 2004 është paraparë si masë e mëvetësishme<sup>60</sup>, nuk paraqet risi në legjislacion. Është fjala për masë e cila, në të vërtetë, paraqet formë të gjykimit me kusht, ku qëllimi është risocializimi i personit. Këtë masë gjyqi e shqipton në rastet e njëjta si edhe dënimi me kusht (për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg deri në dy vjet ose dënim me të holla), por kur llogarit se vetëm dënimi me kusht nuk do të jetë i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit. Kështu, ky dënim me kusht është përforcuar me masa të mbikëqyrjes, kujdesit dhe ndihmës gjatë krijimit të kushteve dhe obligimeve të cilat gjyqi ia imponon personit të dënuar. Shkak për këtë është se nuk beson që personi, në mënyrë të pavarur, me forcat e vera, të mund tu rezistojë sprovave. Megjithatë, besohet se me një ndihmë ose kujdes të caktuar, kryerësi do të mund të zbrapset nga kryerja e veprës penale. Obligimet të cilat i imponohen personit, janë theksuar në nenin 56 të Kodit penal dhe përfshijnë më shumë aspekte: rikualifikimin profesional, punësimin, mbajtjen e familjes, shërimin, mosqëndrimi në lokale të caktuara moskonsumimin e alkoolit etj. Në të njëjtën kohë, në periudhën e kontrollit (periudhë e cila

<sup>52</sup> Kodi penal, neni 51.

<sup>53</sup> Kodi penal, neni. 104/2.

<sup>54</sup> Kodi penal, neni 59.

<sup>55</sup> Vllado Kambovski, E drejta ndëshkimore, pjesa e përgjithshme, faqe 957.

<sup>56</sup> Si shembull për veprat për të cilat më shpesh shqiptohet vërejtja gjyqësore mund të përmenden, për shembull, lëndimi trupor, shpifja, fyerja, nënçmimi, nxjerrja e çështjeve personale dhe familjare, etj. Në Përgjigjet e Pyetësorit të UE 0- kriteret politike, faqe 164.

<sup>57</sup> Vërejtja gjyqësore nuk mund t'i shqiptohet të miturit!

<sup>58</sup> Ligji për procedurë penale, neni 432.

<sup>59</sup> Kodi penal, neni 55.

<sup>60</sup> Sa u përket dallimeve në qëndrime për ekzistimin e dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, si sanksion i pavarur ose vetëm si formë e dënimit me kusht. Gordana Buzharovska, Alternativa të burgut, faqe 312, 313..

nuk mund të jetë më e shkurtër se një vjet as më e gjatë se pesë vjet), gjyqi përcakton edhe kohën e zbatimit të mbikëqyrjes mbrojtëse<sup>61</sup>, kur do t'i ofrohet ndihmë, kujdes, mbrojtje por edhe kontroll gjatë realizimit të obligimeve ose sjelljes.

Në rast të mosplotësimit të obligimeve, gjykata si obcion të fundit ka heqjen e dënimit me kusht dhe efektuimin e dënimit të shqiptuar. Megjithatë, para shfrytëzimit të obcionit të fundit (burg) gjykata mund t'ia tërheq vërejtjen, ta marrë parasysht mendimin e organit social dhe të vazhdojë kohën e mbikëqyrjes mbrojtëse, ta zëvendësojë obligimin e shqiptuar me tjetër etj.

Në pajtim me Kodin penal, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, nuk është paraparë si mundësi gjatë shqiptimit të sanksioneve ose masave personave të mitur. Sipas tekstit punues të Ligjit për të drejtat e të miturve<sup>62</sup>, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, mund të shqiptohet kur të miturit i është përcaktuar dënimi me burg për të mitur, deri në tre vjet, ose dënim me të holla. Koha e kontrollit të sjelljes së të miturit ehtë përcaktuar në një afat prej një deri në maksimum tre vjet, periudhë në të cilën nuk guxon të kryejë vepër të re penale/vepra të reja penale, për të cilat mund të shqiptohet dënimi me burg për të mitur më shumë se tre vjet. Gëzon fakti që mendimet janë orientuar pikërisht ndaj përdorimit më të madh të kësaj mase alternative e cila, nëse miratohet, padyshim doemos do të sjellë ndryshime edhe të kodit penal. Megjithatë, nëse edhe ky rast mbetet shkronjë e vetme e ligjit, por jo edhe e praktikës, idetë dhe intencat e këtilla do të mbetën entuziazëm dhe angazhim deklarativ në letër.

#### **2.2.4. Ndërprerja me kusht e zhvillimit të procedurës penale<sup>63</sup>.**

Me nenin 58-a është paraparë masa alternative me të cilën mund të shtyhet zhvillimi i procedurës penale, më së shumti deri në një vjet. Me këtë masë nuk i iket ekzekutimit të dënimit, por i iket/shtyhet shqiptimi i aktgjykimit.

Këtë masë alternative gjyqi mund ta shqiptojë kur është kryer vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg deri në një vjet ose dënim me të holla; nëse profili i kryerësit e mundëson këtë, përkatësisht nëse ekziston pendim i veçantë për veprën e kryer, kërkimi i faljes viktimës, mënjanim i pasojave dhe kompensim i dëmit të shkaktuar me veprën e kryer. Gjithashtu, duhet të ekzistojë pëlqim nga viktimja për zbatimin e kësaj mase.

Edhe me këtë rast ekziston koha e kontrollit (një vjet) të sjelljes së kryerësit, gjatë së cilës ai nuk guxon të kryejë vepër të re penale. Po që se personi nuk kryen vepër të re penale, procedura penale ndërpritet, në të kundërtën, procedura vazhdon deri në shqiptimin e dënimit.

Kur është fjala për të mitur, Kodi penal përcakton se ndërprerja e procedurës me kusht, si masë, mund të zbatohet edhe te këta kryerës të veprave penale<sup>64</sup>. Megjithatë, për të miturit ekzistojnë dispozita të tjera për zbatimin e kësaj mase,. Kështu, me nenin 91-a/1 është paraparë që këtë masë gjyqi të mund ta shqiptojë nëse për veprën e kryer penale është paraparë dënim me burg deri në tre vjet ose dënim me të holla, nëse ekziston pëlqim nga i mituri për zbatimin e kësaj mase, nëse ekziston pendim për veprën e kryer, ose

<sup>61</sup> Kodi penal, neni 55/2

<sup>62</sup> Ligji për drejtësinë e të miturve, tekst punues, projekt i Ministrisë së drejtësisë dhe UNICEF-it , shkurt 2006.

<sup>63</sup> Kodi penal, neni 58-a.

<sup>64</sup> Sipas tekstit punues të Ligjit për drejtësi të të miturve, masat alternative do të mund t'u shqiptohen fëmijëve në rrezik dhe kryerësve të mitur të veprave penale (neni1). Në mënyrë më specifike është përcaktuar në me nenin 26 në përputhje me të cilin, masat alternative mund t'u shqiptohen me përjashtim, edhe atë për të miturit më të mëdhenj.

kompensim të dëmit ose mënjanim i pasojave nga vepra e kryer, nëse janë përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet viktimës dhe kryerësit dhe nëse në periudhë prej dy vjetësh nuk kryen veprë të re penale. Është e qartë se kur është fjala për kryerës të mitur të veprave penale, kushtet për shqiptimin e kësaj mase janë më të gjera se sa të kryerësit madhorë.

Si vërejtje, sipas tekstit punues të Ligjit për të drejtat e të miturve, ndërprerja me kusht e procedurës, mund t'i shqiptohet të miturit me moshë më të madhe, për veprë penale për të cilën është përcaktuar dënim me të holla ose dënim me burg deri në pesë vjet.

**2.2.5. Puna e gjithdobishme<sup>65</sup>.** Për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burg deri në tre vjet ose dënim me të holla, për vepra të kryera nën rrethana të veçanta lehtësuese, kur ekziston pëlqimi i kryerësit, i cili para së gjithash është kryerës i një veprë për herë të parë, gjyqi mund ta shqiptojë këtë masë alternative<sup>66</sup>. Është fjala për kryerjen e një numri të caktuar të punës pa pagesë, në dobi të bashkësisë, përkatësisht gjyqi mund të shqiptojë të paktën 40 orë e më së shumti 240 orë pune pa pagesë (jo më pak se 5 orë në ditë, në një periudhë prej 12 muajsh). Të cilën kryerësi do ta kryejë në kohën e vet të lirë (koha e lirë përfshinë edhe festa shtetërore, të shtuna dhe të diela, kur kryesisht nuk punohet) në organe shtetërore, institucione publike, shoqata humanitare etj.

Gjithashtu, këtë masë gjyqi mund ta shqiptojë edhe atëherë kur për veprën e kryer penale mund të shqiptohet dënim me të holla deri në 90 gjoba ditore ose 1800 euro në kundërvlerë në denarë ose dënim me burg deri në 3 muaj. Por, me kërkesën e të dënuarit, gjyqi mund t'i zëvendësojë me punë të gjithdobishme, kështu që një ditë burg ose një gjobë ditore ose 20 euro zëvendësohen me 3 orë punë pa pagesë në dobi të shoqërisë<sup>67</sup>.

Në rast të mosplotësimit të obligimeve të punës ose plotësimit të tyre në mënyrë jopërkatëse, në rastin kur puna e gjithdobishme është shqiptuar si sanksion i pavarur, gjyqi si obcion të fundit, mund ta zëvendësojë masën me dënimin pasues për veprën penale përkatëse. Megjithatë, para obcionit të fundit, mund të ndërmarrë edhe aktivitete të tjera, d.m.th. t'i tërheqë vërejtjen kryerësit, ta rrisë numrin e orëve të punës, ta vazhdojë zbatimin e masës, kurse nëse masat e këtilla nuk janë efikase, mund të vendosë për obcionin e fundit, përkatësisht të shqiptojë dënim me burg ose dënim me të holla. Nëse puna me dobi të përgjithshme është shqiptuar si dënim zëvendësues, në rastin e mosplotësimit ose plotësimit në mënyrë jopërkatëse, të obligimeve të punës, pason marrja e vendimit për zbatimin e dënimin.

Ashtu si edhe te masa alternative e mëparshme (ndërprerja me kusht e zhvillimit të procedurës penale) edhe puna e gjithdobishme mund t'u shqiptohet të miturve me moshë më të madhe. Për ata, kjo masë alternative paraqet një lloj mase të ndërmjetme në mes të masës disiplinore dhe burgut për të mitur<sup>68</sup>. Kjo masë shqiptohet në rastet kur nevojitet të ndikohet në sjelljen e të miturit<sup>69</sup>.

Në pajtim me tekstin punues të Ligjit për të drejtat e miturve, puna e gjithdobishme mund t'i shqiptohet të miturit me moshë më të madhe i cili ka kryer veprë penale për të cilën mund

<sup>65</sup> Kodi penal, neni 58-á

<sup>66</sup> Në këtë rast, gjyqi këtë masë e shqipton si sanksion të mëvetësishëm.

<sup>67</sup> Në këtë rast puna e gjithdobishme paraqitet si sanksion zëvendësues.

<sup>68</sup> Vllado Kambovski, Edrejta ndëshkimore – pjesa e përgjithshme, faqe 1048.

<sup>69</sup> Kodi penal, neni 91-á/2.

të shqiptohet dënimi me burg deri në tre vjet. Puna e gjithëdobishme mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej 5 deri në 100 orë.

**2.2.6. Burgu shtëpiak<sup>70</sup>.** Për dallim nga masat tjera alternative, burgu shtëpiak nuk paraqet mënyrë për t'i ikur burgut, por mënyrë që të zëvendësohet vetëm institucioni/vendi ku mbahet dënimi, kurse kjo është shtëpia e kryerësit. Domethënë, nuk është fjala për zëvendësimin e burgut, por vetëm zëvendësim i vendit dhe mënyrës së mbajtjes së tij modalitet tjetër i mbajtjes së dënimit me burg, në vend në institucionin ndëshkimor përmirësues kjo të bëhet në shtëpinë e kryerësit.

Ky sanksion mund të shqiptohet për vepër të kryer penale për të cilën është përcaktuar dënimi me të holla ose dënimi me burg deri në një vjet, dhe nëse është fjala për kryerës në moshë, me shëndet të ligë ose të sëmurë rëndë ose për grua shtatzënë. Këtë sanksion gjyqi mund ta shqiptojë nëse është plotësuar edhe një kusht, e ky është ekzistimi i pëlqimit të kryerësit për mënyrën e këtillë të mbajtjes së sanksionit.

Burgun shtëpiak gjyqi do të mund ta shqiptojë edhe si zëvendësim të dënimit me burg, nëse ekzistojnë mjete përkatëse elektronike dhe telekomunikative nëpërmjet të cilave, në të vërtetë, do të mbikëqyret sjellja e personit, domethënë se i njëjti e respekton urdhrin për mos largim nga shtëpia. Është fjala për mjete teknike të cilat duhet të sigurohen në mënyrë që të mund të realizohet mbikëqyrja gjatë zbatimit të masës. Sipas Kodit penal, mbikëqyrjen në zbatimin e masës, e kryen gjyqi i cili mund të kërkojë asistencën e policisë e cila do të ketë për obligim ta informojë gjyqin për të njëjtën. Nëse personi i dënuar e shkel ndalimin e largimit nga shtëpia, kjo masë mund të zëvendësohet në atë mënyrë që masa do të zbatohet në një institucion ndëshkimor përkatës.

## 2.3. ZBATIMI I MASAVE ALTERNATIVE

Me Ligjin e ri për zbatimin e sanksioneve<sup>71</sup> (LZS) u vendosën mënyrat themelore dhe procedura e zbatimit të masave alternative. Në sistemin e masave alternative, ligjvënësi ka futur edhe lirimin me kusht<sup>72</sup>, që sipas Kodit penal nuk i përket pakos së masave alternative. Megjithatë, nëse me procesin e zbatimit të masave alternative e nënkuptojmë edhe aplikimin e sistemit të masave të cilat janë në suazat e mbrojtjes sociale, nëpërmjet punës së qendrave, lëshimi me kusht mund të merret parasysht në njëfarë forme, si masë alternative të një pjese të mbajtjes së dënimit me burg. Aspekti alternativ vërehet në momentin kur personi do të jetë në liri dhe do të caktohet edhe mbikëqyrje mbrojtëse<sup>73</sup>.

Organe themelore për zbatimin e masave alternative janë Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, qendrat për punë sociale dhe gjykatësi për zbatimin e sanksioneve.

**2.3.1. Drejtoria për zbatimin e sanksioneve.** LZS e rregullon sferën e zbatimit të masave alternative në kreun XVIII, ku janë përcaktuar obligimet dhe aktivitetet që i kanë ministria e Drejtësisë, Drejtoria për zbatimin e sanksioneve dhe qendrat për punë

<sup>70</sup> Kodi penal, neni 59-à.

<sup>71</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, gazeta zyrtare nr. 2/06.

<sup>72</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 225.

<sup>73</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 204.



sociale si organe të cilat e formësojnë pjesën institucionale të sistemit për zbatimin /kryerjen e masave alternative.

Në pajtim me këtë ligj, organ kompetent për ekzekutimin e sanksioneve në përgjithësi është Drejtoria për zbatimin e sanksioneve (Drejtoria)<sup>74</sup>. Drejtoria është e regjistruar si person juridik, ka sistematizim dhe organizim të ri, ka marrë leje nga Agjencia për nëpunës shtetëror dhe është organ në përbërje të Ministrisë së drejtësisë<sup>75</sup>. Sipas LZS, Drejtoria është organ kompetent për organizimin, realizimin dhe kryerjen e mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit me burg, burgut për të mitur, masave alternative punë e gjithëdobishme dhe burgut shtëpiak, mbikëqyrjes mbrojtëse të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, lirim të kushtit si dhe të masës edukuese- dërgim në shtëpi ndëshkimore përmirësuese<sup>76</sup>. Me sistematizimin e ri është paraparë që të ketë seksion për zbatimin e masave alternative<sup>77</sup> të cilin do ta përbëjnë 4 të punësuar, midis të cilëve dy këshilltarë dhe një bashkëpunëtor i lartë, në pajtim me Ligjin për nëpunës<sup>78</sup>. Sipas informatës së marrë nga drejtorët<sup>79</sup>, seksioni i këtillë ende nuk është formuar.

Megjithatë, ajo që na interesonte neve, e që ishte temë bisede me z. Kostadinço Efremov, është roli i Drejtorisë në procesin e zbatimit të masave alternative. Sipas informatave të marra (që me siguri janë pjesë e zgjidhjeve ligjore) drejtoria është kompetente për realizimin e disa masave alternative, por jo të gjitha masave. Aktivitetet që do t'i i mbulon Drejtoria kanë të bëjnë me punën e gjithëdobishme, mbikëqyrjen mbrojtëse të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe burgun shtëpiak. Sa u përket masave të tjera alternative, ato gjenden në fushëveprimin e punës së gjykatësve dhe nuk kërkojnë involvim të Drejtorisë në cilëndo fazë të realizimit të tyre.

Sa u përket burgut shtëpiak, u theksua se nevojiten mjete teknike që të mundet Drejtoria ta realizojë këtë masë alternative. Momentalisht nuk ekzistojnë mjete të tilla, por Drejtoria shpreson se nëpërmjet bashkëpunimit me SIDA-n (Agjencia suedeze për zhvillim institucional) pajisja e tillë do të sigurohet. Deri atëherë parashikohet që ndjekja të bëhet në mënyrë vizuale, me vizita që do t'i bëhen të dënuarit nga ana e QPS (Qendrës për punë sociale).

Megjithatë, këtu shtrohen çështjet e bazueshmërisë ligjore, obligimeve, autorizimeve dhe përkufizimeve të cilat do t'i kishte qendra nëse I merr kompetencat e këtyra. Kjo ka rëndësi të veçantë duke pasur parasysh se Kodi Penal dhe LZS parashohin gjëra të ndryshme. Çdo ligj (prej këtyre dy ligjeve) mbikëqyrjen e rregullon me mënyrën e vet. Një dallim i këtillë shkakton konfuzion shtesë dhe është I domosdoshëm harmonizimi I tyre, përkatësisht nevojiten ndryshime të LZS-së pikërisht në saktësimin e mekanizmave mbikëqyrës dhe kontrollues.

<sup>74</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 7/1, neni 8.

<sup>75</sup> Intervistë me z. Kostadinço Efremov, ish drejtor i Drejtorisë, 11.04.2006.

<sup>76</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 14.

<sup>77</sup> Informata e Ministrisë së drejtësisë - [www.pravda.gov.mk](http://www.pravda.gov.mk) – Organizimi- Drejtoria për zbatimin e sanksioneve (organogram).

<sup>78</sup> Gazeta zyrtare, nr 40.59/2000 . i shfrytëzuar teksti i pastruar i publikuar në Gazetën zyrtare nr. 108 të 12.12.2005.

<sup>79</sup> Përveç tekstit ligjor të LZS, informatat janë marrë edhe nga intervista me z. Kostadinço Efremov, ish drejtor i Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve, të zhvilluar më 11.04.2006, dhe nga takimi me drejtoreshën aktuale të Drejtorisë, zonjën Lidija Gavrilloska më 29.11.2006.

<sup>80</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 14/1.

Ajo që është parashikuar me ligj sa u përket masave alternative, është se Drejtoria e organizatave, realizon dhe kryen mbikëqyrjen e realizimit, midis tjerash, edhe të masave alternative<sup>80</sup>. Aktiviteti themelor i Drejtorisë është kryerja e mbikëqyrjes profesionale nga ana e instruktorëve për realizimin e masave. Kjo përfshin aktivitetet të mbikëqyrjes së procedurës së zbatimit, kontrollin e zbatimit ligjor, kontrollin se personat a u përmbahen planeve dhe programeve të miratuara nga qendra. Nga kjo del se seksioni i cili duhet të formohet në suazat e Drejtorisë, do ta kontrollojë punën e qendrave, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë do të jenë kompetente për realizimin e masave.

Drejtoria, ndër të tjera, është kompetente të bëjë licencën<sup>81</sup> e personave përgjegjës për implementimin e drejtpërdrejtë të masave, të lidhë marrëveshje me institucionet, agjencitë, ndërmarrjet publike dhe me organizatat tjera ku do të zbatohet masa e punës së gjithëdobishme. Sa i përket asaj se si do të identifikohen, zgjidhen organizatat, si do të nënshkruhen marrëveshjet të cilat të njëjtat do t'i përmbajnë, kush cilin do ta mbikëqyrë në punë, ende janë çështje të hapura.

Përveç dispozitave parimore të vendosura me ligj, nuk ekziston ndonjë sistem i përpunuar hollësisht, përkatësisht program në pajtim me të cilin do të rregullohej puna, do të përcaktoheshin kompetencat konkrete, do të etablohej koordinimi si i Drejtorisë ashtu edhe i organeve tjera të përfshira në procesin e zbatimit të masave alternative. Përveç teksteve ligjore dhe dispozitave të tyre, të cilat kanë të bëjnë me masat alternative, duke pasur parasysh këtu KP dhe LZS, momentalisht nuk ekziston rregullativë nënligjore. Gjithashtu, edhe në tekstet ligjore duhet të bëhen ndryshime. Në një kohë më të shkurtër kjo duhet të bëhet në Ligjin për mbrojtje sociale. Sa i përket rregullativës nënligjore, kjo do të bëhet së shpejti, ashtu që do të përgatitet një akt i veçantë (rregullore) me të cilën do të rregullohet OKR, do të përcaktohen mënyrat për lidhjen e marrëveshjeve me institucionet si dhe mënyra e zbatimit të vetë masës. Në pajtim me LZS, Drejtoria, në afat prej gjashtë muajsh të hyrjes së ligjit në fuqi, duhet t'i miratojë aktet nënligjore.

Lidhur me këto informacione, por duke pasur parasysh se pikërisht në muajin korrik u bë ndërrimi i Qeverisë, kurse me ndërrimin e Qeverisë është shumë e ditur se bëhet edhe i ashtuquajtur i ndërrimi i menaxherëve të eshlonit të dytë të institucioneve publike, diku në tetor 2006 (deri kur ende nuk ishte miratuar suaza nënligjore), u bë ndryshimi edhe në menaxhimin e këtij institucioni. Kjo padyshim vazhdoi zvarritjen e realizimit të aktivitetëve të filluara paraprakisht. Kjo ngase edhe drejtoresha e re e Drejtorisë, zonja Lidija Gavrilovska, në momentin e mbajtjes së takimit në nëntor 2006, na informoi se suaza nënligjore ende nuk është përgatitur. Kjo padyshim është në kundërshtim me zgjidhjen ligjore e cila përcakton se të gjitha aktet e përgjithshme të ndërlidhura me realizimin e LZS do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit! Të përkujtojmë se LZS hyri në fuqi në janar 2006.

Nuk guxojmë të harrojmë se veprimtaria të cilën e kryen Drejtoria është mjaft e ndjeshme, specifike dhe, para së gjithash, profesionale, dhe nuk guxon të lejojë ndikimin e rrjedhave politike turbulente në Republikën e Maqedonisë. E kundërta, përfundimisht nuk shkon në favor si të zhvillimit të sistemeve institucionale, ashtu edhe në favor të qytetarëve për të cilët ekziston. Ekipet e këtyra të menaxhimit "të përkohshme" për herë do të nisin nga fillimi, pavarësisht se në cilën fazë të zhvillimit ka qenë ndonjë institut, program, projekt, plan i caktuar ose diçka tjetër.

<sup>81</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 226/3.

Duke marrë parasysh faktin se Drejtoria paraqitet si koordinuese e të gjitha aktiviteteve që do të merren me masat alternative, është e domosdoshme të ekzistojë bashkëpunim dhe komunikim i vazhduar me aktorët tjerë. Pikërisht në këtë drejtim, gjatë realizimit të intervistës me drejtorët e Drejtorisë, insistuaam që të vërtetojmë nivelin ekzistues të bashkëpunimit, si një nga kushtet themelore për zbatimin efikas të masave alternative. Kryesisht, menaxhuesit e Drejtorisë deklaruan se kanë një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me aktorët tjerë.

Kështu, sa i përket punës së qendrave, informatat i marrin nga Ministria e punës dhe e politikës sociale. Por, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, e që i dedikohet rolit të Seksionit për masa alternative në kuadër të Drejtorisë do të jetë më se e nevojshme që të ndryshohet relacioni i komunikimit dhe i njëjti të zbresë në një nivel më të ulët, operativ e jo në nivel të menaxherëve.

Sa u përket gjykatave, bashkëpunimi realizohet nëpërmjet Gjykatësit për zbatimin e sanksioneve dhe nuk është në nivelin e kënaqshëm. Sipas mendimit të z. Efremov nevojitet që ky funksion të jetë i pavarur, e jo si deri më tash funksionin e këtyre kryejnë gjykatësit për gjykim. Nevoja për saktësimin e këtyre funksionit të këtij gjykatësi do të jetë e domosdoshme në mënyrë që gjykatësi të mund t'u kushtohet tërësisht obligimeve që do të dalin nga implementimi i marrëveshjeve alternative. Domosdoshmëria për përcaktimin e këtyre gjykatësit për zbatimin e sanksioneve është pikërisht për shkak të situatës së gjertanishme që ky gjykatës të mos ketë kontroll për atë, për shembull, se si zbatohet dënimi me burg.

Bashkëpunimi me komunat, gjithashtu, është në nivel të kënaqshëm. Sipas z. Efremov bashkëpunimi i deritashëm me komunat ka qenë rreth aktiviteteve që kanë të bëjnë me angazhimin e personave të dënuar nga institucioni ndëshkues përmirësues. Deri më tash janë lidhur marrëveshje për punë me atë dallim që personit të dënuar për punën e kryer i është paguar kompensim<sup>82</sup>. Praktika e këtyre, sipas z. Efremov, do të mund të shfrytëzohet edhe për punën e gjithëdobishme, me atë dallim që në këto raste puna do të kryhej pa kompensim për personin e dënuar. Ajo që Drejtoria do ta bëjë në këtë drejtim është që t'u dërgojë shkresa të gjitha komunave në Republikën e Maqedonisë, organizatave humanitare e të tjera, me çka do t'i informojë për nevojat e këtyra. Megjithatë, identifikimi i institucioneve, organizatave, shoqatave të këtyra humanitare, madje edhe angazhimi në suazat e komunave, është çështje që mbetet e parregulluar me ligj.

Si konkluzion, mund të thuhet se Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, në radhë të parë paraqet organ që është kompetent për organizimin dhe koordinimin instrumental të aktiviteteve, për mundësimin e kushteve që masat alternative të mund të zbatohen në mënyrë përkatëse. Gjithashtu, Drejtoria është kompetente edhe për përgatitjen e rregullativës nënligjore e cila duhet të paraqesë mekanizëm për realizimin e ligjit në praktikë, më tutje, Drejtoria gjithashtu është kompetente edhe për sigurimin e instrumenteve të zbatimit si dhe të evaluimit dhe vlerësimit të efikasitetit të zbatimit të sanksioneve në përgjithësi. Megjithatë, saktësimi edhe i rolit të Drejtorisë në tërë sistemin e zbatimit të masave alternative, doemos duhet të përcaktohet, për çka janë të domosdoshme ndryshime në LZS.

<sup>82</sup> "Angazhimi në punë është realizuar në atë mënyrë që i dënuari ka punuar 8 orë kurse pjesën tjetër e ka kaluar në institucionin e mbyllur". Megjithatë, nëse e kemi parasysh zgjidhjen ligjore, atëherë padyshim se dita punuese e personit i cili do të kryejë punë të gjithëdobishme, do të jetë i koncipuar dhe mbushur më ndryshe, duke pasur parasysh faktin se korniza kohore për kryerjen e detyrave të punës, intervali i ndërmarrjes së detyrave të punës dhe mënyra e kryerjes së detyrave, duke të jetë krejtësisht më ndryshe.

**2.3.2. Qendrat për punë sociale.** Qendrat për punë sociale (në tekstin e mëtejshëm Qendrat) janë organe themelore, bartëse në zbatimin e masave alternative, ato, sipas statusit të vet si dhe metodave të punës janë pikërisht ajo që nevojitet për realizimin e qëllimeve të masave alternative. Në të vërtetë, qendrat janë organe jo represive, të profesionalizuara për dhënien e ndihmës, kujdesit dhe mbrojtjes së personave që gjenden në rrezik social<sup>83</sup>. Në Republikën e Maqedonisë ka 27 qendra ndërkomunale për punë sociale, të cilat janë shpërndarë në atë mënyrë që t'i përfshijnë të gjitha<sup>84</sup> komunat<sup>84</sup>. Kjo është e një rëndësie të veçantë veçanërisht me zhvillimin e procesit të decentralizimit me ç' rast komunat në të ardhshmen do të marrin funksionin edhe të mbrojtjes sociale, përkatësisht tanimë është përcaktuar që vetëqeverisja lokale të miratojë programe të mbrojtjes sociale të cilat do t'i pasqyrojnë nevojat e popullatës lokale<sup>85</sup>.

Puna e qendrave bazohet në Ligjin për mbrojtje sociale<sup>86</sup>, megjithatë dispozita të caktuara janë përcaktuar edhe me Kodin penal, me Ligjin e procedurës penale dhe me ligjin për zbatimin e sanksioneve me të cilat vendoset korniza e përgjithshme për zbatimin e masave alternative.

Në përputhje me Ligjin për zbatimin e sanksioneve, masat alternative i zbaton seksioni në qendrën kompetente për punë sociale, sipas vendqëndrimit ose vendbanimit të personit (kryerësit).<sup>87</sup> Pikërisht ky nen mund të shkaktojë hamendje sa i përket ekzistimit të këtij seksioni. Nëse lexohet teksti i ligjit (LZS) del se qendrat për punë sociale duhet të formojnë seksion të këtyre, e nëse shihet organizimi i Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Drejtorisë, atëherë seksion për zbatimin e masave alternative ekziston edhe aty<sup>88</sup>. Risaktësimi i kësaj zgjidhjeje ligjore dhe përcaktimi i saktë i kompetencave të këtyre seksioneve është i domosdoshëm që t'i iket mundësisë së përputhjes së kompetencave.

Megjithatë, padyshim se në strukturën organizative të qendrave duhet të formohet edhe seksion i cili do të jetë kompetent për zbatimin e këtyre masave. Sipas gjendjes momentale, në nivel organizativ në qendra, nuk ekziston strukturë standarde, përkatësisht jo të gjithë kanë kuadër profesional të mjaftueshëm dhe seksione dhe ekupe të diferencuara për problematika të veçanta.<sup>89</sup> Megjithatë, pavarësisht nga gjendja momentale në të cilën gjenden qendrat, ligji parasheh specializimin e seksionit me kuadro profesionale përkatëse, i cili do ta kryejë këtë detyrë. Për zbatimin e këtyre masave, qendrat më saktësisht kuadri që do të punojë në këtë sferë, do të marrë licenca (leje) për zbatim<sup>90</sup>. Licencat e këtyra do t'i ndajë

<sup>83</sup> Me rrezikun social, përveç punëve të tjera, nënkuptohet edhe mosadaptimi në mjedisin social.

<sup>84</sup> Koteska, Samojloska, "Organizimi dhe zhvillimi i qendrave për veprimtari sociale", faqe 9, AP Enti për veprimtari sociale, nëntor 2005, Shkup.

<sup>85</sup> Doracak për kryetarët e komunave dhe këshillat e komunave në Republikën e Maqedonisë, faqe 96, ZELS (BNJVL), janar 2005.

<sup>86</sup> Ligji për mbrojtjen sociale, Gazeta Zyrtare nr. 50/97/00/03.

<sup>87</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 226/2.

<sup>88</sup> Sipas nenit 226 të LZS dhe Informatës së Ministrisë së Drejtësisë - [www.pravda.gov.mk](http://www.pravda.gov.mk) – Organizimi – Drejtoria për zbatimin e sanksioneve (organogram).

<sup>89</sup> Sa i përket vendosjes organizative të qendrave në Republikën e Maqedonisë, mund të thuhet se ekzistojnë tre lloje të strukturave të cilat varen nga numri i banorëve të territorit që e mbulojnë, zhvillimi i funksioneve dhe numri i të punësuarëve. Kështu, përgjithësisht, qendrat përbëhen nga drejtori, dy ose më shumë seksione profesionale dhe seksioni administrativ- teknik, funksionet e të cilit dallojnë prej komune në komunë... Koteska, Samojloska, "Organizimi dhe zhvillimi i qendrave për veprimtari sociale", faqe 16, AP Enti për veprimtari sociale, nëntor 2005, Shkup.

<sup>90</sup> Edhe pse nuk është theksuar në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, me licenca të këtyra do të pajisen edhe disa organizata joqeveritare (OJQ), përkatësisht individë që punojnë në OJQ. (Informata është marrë në mbledhjen e mbajtur në korrik me zonjën Mladica Koteska, drejtoreshë e Entit për zhvillimin e veprimtarive sociale. Edhe pse ka një përparim në kuptim të afrimit të institucioneve të drejtësisë dhe mbrojtjes sociale me shoqërinë civile dhe bashkësinë, që është në interes të veçantë për zbatimin e këtyre masave, megjithatë, mosekzistimi i kornizës ligjore me të cilën do të rregullohej sfera e zbatimit, mund të shpie në veprimin joadekuat gjatë realizimit, që do t'i dekurajojë orvatjet për zhvillimin progresiv të kësaj materie.

Drejtoria. Në bazë të kësaj, por varësisht nga lloji i veprës penale, profili (personaliteti) i kryerësit, gjendja e tij materiale dhe familjare, personat profesionalë do të përgatisin program individual dhe nëse gjyqi përcakton plotësimin e ndonjë farë obligimi, të njëjtat futen në program. Në pajtim me programin e këtyllë dhe planin e përkohshëm për zbatim, masat alternative do të zbatohen.

Roli i qendrave në procesin e zbatimit praktik të masave alternative do të realizohet nëpërmjet punës së seksionit të specializuar ose ekipit të specializuar i cili do të përbëhet nga struktura standarde e punëtorëve, punëtori social, pedagogu, psikologu, juristi, dhe sipas nevojës, edhe nga persona tjerë profesionalë. Ekipi ose seksioni, duke i shfrytëzuar resurset në komunën përkatëse, por në pajtim me nevojat individuale të personit të dënuar, do ta modelojë llojin dhe sasinë e aktiviteteve të cilat do të ndërmerren. Me masat të cilat do të ndërmerren qendrat do të insistojnë të nxisin iniciativën, motivimin e personit, që të informojnë, udhëzojnë, të ndikojnë në ndryshimet në sjellje dhe në qëndrime, të ndikojnë te personat që ta kuptojnë esencën e masës e cila u është shqiptuar, ta zgjojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetërespektit, kreativitetit dhe potencialeve te personat.<sup>91</sup> E gjithë kjo do të inkorporohet në programin individual, në bazë të të cilit, në të vërtetë do të realizohet vendimi gjyqësor me të cilin është shqiptuar masa alternative.

#### **A) Obligimet e qendrave të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.**

Detyrë themelore e qendrave në zbatimin e mbikëqyrjes mbrojtëse janë aktivitetet e drejtuara në dhënien e ndihmës, kujdesit, mbrojtjes dhe kontrollit në realizimin e obligimeve të parapara nga ana e gjyqit. Qendrat, d.m.th. personat me licencë do të kenë obligim që me këshillat profesionale ta ndihmojnë personin, ta nxisin që ta kryejë obligimin si dhe ta kuptojë rëndësinë e masës. Për mënyrën dhe dinamikën e realizimit të mbikëqyrjes mbrojtëse dhe realizimit të obligimeve nga ana e personit të dënuar, qendrat i paraqesin raport gjyqit. Gjithashtu, ekipet profesionale do të kenë edhe rol më aktiv i cili do të shihet në aktivitetet e përgatitjes së masave, përgatitjen e ekspertizave dhe mendimeve për gjyqin dhe prokurorinë. Kështu mund ta propozojnë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes mbrojtëse, i propozojnë gjyqit që t'i zëvendësojë masat me të tjera, t'i vazhdojë, t'i ndërpresë ose t'i zëvendësojë me dënimin e shqiptuar (burgim ose me të holla) etj.<sup>92</sup>

**B) Obligimet e qendrave në punën e gjithëdobishme.** Drejtoria, në bazë të kontratave të nënshkruara me ndërmarrje publike, organe shtetërore, shoqata humanitare, njësi të vetëqeverisjes lokale, ku personat të cilëve u është shqiptuar kjo masë mund ta realizojnë, do t'i informojë gjykatat dhe qendrat për mundësitë e këtylla. Qendrat caktojnë person i cili do të bëjë mbikëqyrje të realizimit të kësaj mase. Ata përgatisin program individual për mënyrën me të cilën do të realizohet marrëveshja, më saktë plani për punën e personit dhe verifikojnë se personi a i ka plotësuar dhe si i ka plotësuar obligimet e punës. Për aktivitetet e ndërmarrja nga ana e personit të dënuar e informojnë gjyqin dhe i propozojnë masa përkatëse të cilat do të mund të shfrytëzoheshin në çdo rast konkret. Gjithashtu, mund të propozojnë rritjen e orëve të punës, vazhdimin e masës (më së shumti deri në 3 muaj), zëvendësimin e masës me dënimin e shqiptuar e të ngjashme<sup>93</sup>.

Përgjithësisht, mbikëqyrjen e realizimit të punës së gjithëdobishme e bën gjyqi<sup>94</sup>, ndonëse nga LZS shihet se, në të vërtetë, të gjitha aktivitetet e mbikëqyrjes i kryejnë qendrat, për

<sup>91</sup> Lubica Çoneva, „Mundësitë e qendrave për punë sociale në kryerjen e masave alternative”, faqe 50-56, në Eliminimin e pengesave për implementimin praktik të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, 2002, Shkup.

<sup>92</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 233.

<sup>93</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 236.

<sup>94</sup> Ky është obligim që, sipas nenit 58-a/4 të Kodit penal, e sipas nenit 235 të Ligjit për zbatimin e sanksioneve mbikëqyrje e drejtpërdrejtë ndaj zbatimit të kësaj mase takon personit nga seksioni kompetent në qendrën për punë sociale.

çka e informojnë gjyqin. Sa i përket punës së qendrave, informatë për punën e tyre qendrat i dërgojnë Drejtorisë, e me siguri seksionit për masa alternative në kuadër të Drejtorisë, e cila do ta kryejë mbikëqyrjen profesionale instruktuese. Këto masa të vendosura me pasaktësi të këtyllë, padyshim nuk do të mund të realizohen ashtu si duhet. Përfundimisht nevojitet të kryhen ndryshime, si të zgjidhjeve ekzistuese ligjore ashtu edhe të rregullativës nënligjore e cila do t'i operacionalizojë dispozitat ligjore të përcaktuara në mënyrë adekuatë.

Duke pasur parasysh se puna e gjithëdobishme mund tu caktohet edhe të miturve, edhe atë, atyre në me moshë më të madhe, mënyra e zbatimit të tyre është e njëjtë si ajo që zbatohet te personat e rritur<sup>95</sup>.

**C) Obligimet te burgu shtëpiak.** Njëra prej karakteristikave themelore që lidhen me këtë sanksion, janë personat të cilëve mund t'u shqiptohet. Në të vërtetë, është fjala për persona të moshuar dhe të ligështuar, persona të sëmurë ose gra shtatzëna, përkatësisht kategori kryerësish, te të cilët llogaritet se qendrat, si organe të specializuara, jorepresive do të mund ta kryejnë këtë funksion në mënyrë më adekuatë. Burgu shtëpiak edhe pse kërkon kushte të veçanta, mjete elektronike dhe mjete tjera telekomunikative për zbatim, megjithatë, sipas LZS është theksuar roli i qendrave të cilat përveç mbikëqyrjes mbi mos largimin nga shtëpia, personit duhet t'i ofrojnë edhe asistencë sipas planit dhe programit individual. LZS parasheh që në raste të veçanta qendrat mund të kërkojnë asistencën e policisë gjatë zbatimit të burgut shtëpiak, por nuk thekson se çfarë do të paraqesë asistencë e tillë, e as që përcakton hollësi të zbatimit të vetë mbikëqyrjes. Raport për punën e vet i paraqet gjyqit dhe jep mendim lidhur me vazhdimin e masës ose zëvendësimin e të njëjtës me dënimin e shqiptuar me burg<sup>96</sup>.

Mjaft i kuptueshëm është roli i qendrës në këtë drejtim, megjithatë sipas Kodit penal obcion i këtyllë nuk është paraparë. Më saktësisht, në pajtim me Kodin penal, ligjvënësi është përcaktuar për formën e burgut shtëpiak nëpërmjet përcjelljes elektronike llojit tjetër telekomunikativ të personit të dënuar dhe, në situatë të jashtëzakonshme, mundësinë e asistencës nga ana e policisë. Por, se qendrat do të jenë organe mbikëqyrëse ose do të zëvendësonin sigurimin policor ose lloj tjetër të sigurimit zyrtar, Kodi penal nuk e parasheh, aq më tepër që, sipas Kodit penal, mbikëqyrjen e zbatimit të burgut shtëpiak e bën gjyqi ose gjyqi mund të kërkojë ndihmë në kryerjen e mbikëqyrjes nga policia. Padyshim se kontradikta e zgjidhjeve ligjore do të sjell konfuzion gjatë zbatimit të masave në përgjithësi<sup>97</sup>, veçanërisht të masës burg shtëpiak.

Sa i përket mbikëqyrjes mbi punën e qendrave, por kur është fjala për kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërisë në zbatimin e masave, kompetent është gjyqi i cili ka shqiptuar masën, më saktësisht gjykatësi për zbatimin e sanksioneve<sup>98</sup>. Ndërkaq mbikëqyrjen mbi elementin profesional-instruktues gjatë zbatimit të masave e kryen Inspektori për zbatimin e sanksioneve në kuadër të Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve në bazë të aktit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë<sup>99</sup>.

<sup>95</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 329/1.

<sup>96</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 237-239.

<sup>97</sup> Rasti i njëjtë është edhe te puna e gjithëdobishme dhe kompetencat për kryerjen e mbikëqyrjes.

<sup>98</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 229/2.4.

<sup>99</sup> Ligji për zbatimin e sanksioneve, neni 229/b.

**2.3.3. Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve.** LZS në nenin 35 përcakton se gjykatës për zbatimin e sanksioneve caktohet në çdo gjykatë themelore. Aktiviteti i gjykatësit për zbatimin e sanksioneve shihet në atë që pas pranimit të vendimit me të cilin është shqiptuar sanksioni për kryerës të caktuar, gjykatësi është i detyruar të fillojë zbatimin me ndërmarrjen e veprimeve dhe të masave të caktuara ligjore, menjëherë pas pranimit të vendimit (neni 7 i LZS). Si kompetenca ligjore sipas nenit 36/2-6 nga i njëjti ligj, është paraparë që ky organ duhet të bashkëpunojë me qendrat kompetente për realizimin e ndihmës postpenale dhe zbatimin e masave alternative. Gjithashtu, në nenin 229 të LZS është paraparë të kryejë mbikëqyrjen dhe të përgatisë procesverbal. Sipas asaj që është theksuar në LZS, roli i gjykatësit sillet në kryerjen e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së zbatimit të masave alternative dhe paraqet medium për komunikim ndërmjet qendrave dhe gjyqit. Dispozitat tjera të cilat do ta rregullonin funksionin e këtij gjykatësi, nuk ekzistojnë as në Ligjin për gjykatat<sup>100</sup>, i cili hyri në fuqi para do kohe.

**2.3.4. Bashkësia lokale – komuna.** Korniza themelore gjyqësore prej nga nxirren bazat e vetadministrimit lokal është Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë<sup>101</sup>, ku e njëjta paraqet vlerë themelore bazë dhe, më hollësisht, Ligji për vetadministrimin lokal<sup>102</sup>, i cili rregullon vetë vetadministrimin lokal. Ligjet me të cilat rregullohen masat alternative, saktësisht Kodi penal dhe Ligji për zbatimin e sanksioneve, nuk e përmendin në mënyrë decime bashkësinë lokale/komunën por bashkësinë në përgjithësi. Kjo supozon se dispozitat me të cilat do t'u parashihej kompetencë e caktuar njësisë të vetadministrimit lokal/komunave nuk ekziston, por mund të kuptohet me intuitë. Kështu KP përmend “mjedisin ku jeton personi” (neni 55/1), deri sa LZS “sipas vendbanimit ose vendqëndrimit të personit të dënuar” (226/2). Përveç këtyre dy dispozitave ku është shtruar në mënyrë të përgjithësuar, në asnjë ligj tjetër komuna nuk përmendet për kryerjen e kompetencave të caktuara në këtë sferë.

Edhe pse në suazat e kompetencave të qendrave, të vendosura në mënyrë të përgjithshme, në pajtim me Ligjin për vetadministrim lokal<sup>103</sup> mund të detektohen lidhje të caktuara të cilat udhëzojnë në atë se mund të gjendet hapësirë që kompetenca të caktuara nga procesi i zbatimit të masave alternative të inkuadrohen në kornizën juridike, megjithatë, qasja e tillë është larg të nevojshmes dhe janë të domosdoshme ndryshime edhe në këtë sferë.

## 2.4. POLITIKAT E SHTETIT LIDHUR ME MASAT ALTERNATIVE

Sa u përket politikave të shtetit lidhur me krijimit e sistemit për zbatimin e masave alternative dhe sigurimin e kushteve për zbatimin e tyre, lirisht mund të themi se nuk ekzistojnë. Nuk ekziston as politikë sa i përket çrrenjosjes së krimit, përveç në rastet ad-hok, siç janë temat aktuale – “lufta kundër terrorizmit”, dhe “krimi i organizuar” dhe nën

<sup>100</sup> Ligji për gjykatat, Gazeta zyrtare nr. 58/06.

<sup>101</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, nr. 08-4642/1 prej 17.11.1991 i ndryshuar me amendamentet e viteve 1992, 1998, 2001 dhe 2005, vlerat themelore, neni 8.

<sup>102</sup> Ligji i vetadministrimit lokal, Gazeta zyrtare nr. 5/2002.

<sup>103</sup> Ligji i vetadministrimit lokal, neni 22, “Kompetencat e komunave: planifikimi urbanistik (urban dhe rural), mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyrës, zhvillimi ekonomik lokal, veprimtaritë komunale, kultura, sporti dhe rekreimi, mbrojtja sociale, dhe mbrojtja e fëmijëve, arsimit, mbrojtja shëndetësore, realizimi i përgatitjeve dhe masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të shkaktuara prej tyre”.

presionin e organizatave ndërkombëtare dhe të bashkësisë ndërkombëtare për çështje të caktuara.

Qëndrimi i këtyre del nëse shihen disa dokumente strategjike të shtetit, për shembull “përgjigjet për pyetëtorin e UE”<sup>104</sup>, Programet për realizimin e mbrojtjes sociale të Ministrisë së punës dhe politikës sociale dhe ngjashëm. Kështu në Përgjigjet për pyetëtorin e UE, përveç në pjesën “kriteret politike”, ku Qeveria në mënyrë mjaft të varfër u përgjigjet pyetjeve lidhur me ekzistimin dhe zbatimin e masave alternative, në ndonjë pjesë tjetër nuk janë përmendur aspak. Lidhur me masat alternative dhe çka është arritur me to, Qeveria është përgjigjur nëpërmjet mënyrës, me të cilën të njëjtat janë koncipuar në tekstin ligjor, pa kurrfarë sqarimesh plotësuese, statistika, praktika, tendenca të zhvillimit, më saktë, strategji, iniciativa ose politika në këtë drejtim. Aq më tepër është edhe qëndrimi i Qeverisë se ndryshimet në Kodin Penal të vitit 2004 me të cilat janë zbatuar masat alternative, duke se i ka bërë për shkak të Rekomandimit (92) të Këshillit të Evropës<sup>105</sup>, e jo për shkak të vlerësimit të nevojave të shtetit, politikës ndëshkimore që e zhvillon, gjendjes me burgjet, gjykatat, efikasitetin si të dënimeve dhe sanksioneve të shqiptuara e ngjashëm. Të kuptuarit e këtyre të punëve dhe të thuhet arsyetim i aktiviteteve, definitivisht përkrah qëndrimin që risi të caktuara që janë treguar si të dobishme, e të cilat si praktikë vijnë nga jashtë, të ndihen si të imponuara dhe të përkrahen jo për shkak të dobishmërisë së tyre dhe mirëkuptimit të nevojës për to, por si obligim i imponuar i cili doemos duhet të kryhet. Më tutje, edhe tentimi i Qeverisë që të jap të dhëna statistikore lidhur me dënimet e zbatuara me burg dënimet me kusht (sot masa alternative) vë në dukje një problem delikat. Në të vërtetë, Qeveria ka llogaritur se “në vitin 2003 janë dënuar me dënim me burg 5796 persona, prej të cilëve dënim me kusht u është shqiptuar 2831 personi, kurse vërejtje gjyqësore 183 personave, kështu që përqindja e sanksioneve penale të shqiptuara si dënim me kusht dhe vërejtje gjyqësore (të cilat sipas Kodit të ri penal janë masa alternative) në raport me dënimet me burg, është 52%”. Ky përfaqësim në përqindje i dënimit me kusht është llogaritur si rezultat i pjesëmarrjes së dënimit me kusht në dënimet e shqiptuara me burg, që është gabim, sepse përqindja do të duhej të dilte nga pjesëmarrja e dënimeve me burg dhe dënimit me kusht, në numrin e përgjithshëm të sanksioneve të shqiptuara në këtë periudhë. Kjo, ose është gabim ose mosnjohje ose prezantim i gabueshëm i gjendjeve.

Më tutje, në të njëjtin dokument<sup>106</sup> në kapitull tjetër, masat alternative janë përmendur në një kontekst jo të rëndomtë. Në të vërtetë, thuhet se “...organet e ndjekjes janë përfshirë në zbatimin e masave për risocializimin e personave që janë të varur nga drogat nëpërmjet zbatimit të vazhdueshëm të masave alternative të sanksionimit”. Kjo gati se duket mjaft interesante për shkak të faktit që organet e obliguara të ndjekin (që me siguri mendohet për policinë edhe pse nuk është përmendur në mënyrë decime), në mënyrë të vazhdueshme i zbatojnë masat alternative. Si është e mundur kjo kur masat e këtyra deri më tash, përkatësisht mënyra e këtyre të sanksionimit nuk është zbatuar, përkatësisht masat e këtyra nuk janë shqiptuar nga organi relevant.(?)

<sup>104</sup> Mund të gjendet në veb faqen e Agjencisë për integritet evropian - [www.sie.gov.mk](http://www.sie.gov.mk)

<sup>105</sup> „Republika e Maqedonisë, masat alternative, në përputhje me Rekomandimin nr. 92(1992) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 19.10.1992, i inkorporoi në legjislacionin e vendit me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 19/04) të datës 30.03.2004”, Përgjigje të pyetësorit të UE – kriteret politike, faqe 160.

<sup>106</sup> Përgjigje në pyetëtorin e UE – Drejtësia dhe punët e brendshme, faqe 240.



Gjithashtu determinimi i Qeverisë lidhur me ndërmarrjen e inisiativave dhe të aktiviteteve përkatëse në këtë drejtim shihet edhe në organizimin të bile dy ngjarjeve. Në të vërtetë, në kuadrin e programit për edukimin e përfaqësuesve të jurisprudencës janë organizuar: seminar treditör në vitin 2001 me temë “Alternativat e të drejtës së të miturve në politikën për të rinjtë”<sup>107</sup>, dedikuar për gjykatësit dhe këshillimi treditör në vitin 2004 me temë “Mundësitë për marrëveshje në legjislacionin penal dhe masat alternative në kodin penal të Republikës së Maqedonisë” dedikur prokurorëve dhe gjykatësve<sup>108</sup>. Pikërisht në kontekst të seminarit të parë të përmendur do të duhet theksuar se prej vitit 2001 kur është folur për masat alternative të të miturit, deri më sot, Ligji për të drejtat e të miturve ende nuk është nxjerrë (sipas informatës së fundit, Propozimligji për të drejtat e të miturve është në procedurë qeveritare).<sup>109</sup>

Në nivel të Ministrisë së punës dhe politikës sociale (në tekstin e mëtejshëm MPPS), duke marrë parasysh se bartësit e drejtpërdrejtë gjatë zbatimit të masave do të jenë pikërisht organet e kësaj ministrie, përkatësisht qendrat për politikë sociale, gjithashtu nuk ka të dhëna të afërta lidhur me planifikimin strategjik dhe politik në këtë drejtim. Kështu, në veb faqen e MPPS (www.mtsp.gov.mk) mund të haset një dokument i shkurtër i titulluar si “reforma” ku një paragraf përmendet se ministria do të ndërmarrë ndonjë lloj aktiviteti për zbatimin e masave alternative pa mos paraqitur me këtë rast, ndonjë informatë plotësuese për të njëjtën. Më tutje, në pajtim me Programin për realizimin e mbrojtjes sociale për vitin 2005, në dy paragrafë përmenden masat alternative edhe atë, nga aspekti se MPPS ka marrë pjesë në ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal (në pjesën e zbatimit të masave alternative), dhe se do të forcohen kapacitetet e qendrave dhe do të shtohen programet për realizimin e masave alternative. Plotësisht e njëjta është përmendur edhe në Programin për realizimin e mbrojtjes sociale për vitin 2006. Programi i sivjetmë është plotësuar vetëm me informatën se do të përgatiten udhëzimet metodologjike dhe do të mbahen stërvitje për të gjithë implementuesit e të njëjtave.

Duke marrë parasysh faktin se masat alternative nuk janë shqiptuar në mënyrë përkatëse por edhe nuk janë zbatuar nga ana e qendrave, është e qartë se qëllimet programore të MPPS nuk janë realizuar (me ç’ rast nuk mund të anashkalohej fakti se edhe kushtet objektive nuk e kanë lejuar të njëjtën). E vetmja gjë që mund të përmendet është aktiviteti i paradokohshëm i Entit për veprimtari sociale (më tutje në tekst Enti) i cili në nëntor të vitit 2005 ka përgatitur një analizë të gjendjes në qendra, në pajtim me riorganizimin, decentralizimin dhe deinstitutionalizimin reformues që mund të paraqesë bazë fillestare për analiza dhe hulumtime të mëtejshme edhe në kontekstin e masave alternative. Gjithashtu, Enti ka përgatitur “doracak për realizimin e zbatimit të masave alternative në qendrat për politikë në RM në pajtim me ndryshimet aktuale në dispozitat penale- juridike”<sup>110</sup> (i cili u është shpërndarë drejtorëve të qendrave). Për fat të keq Doracak paraqet parafrzim të zgjidhjeve ligjore të cilat parimisht i formësojnë masat alternative dhe është larg asaj që të jetë doracak për zbatimin e këtyre masave. Prandaj, ky dokument do të duhej të kuptohej si informatë se zgjidhje përkatëse- aktuale- ligjore ekzistojnë, se sa të paraqesë Doracak për zbatimin e masave që do t’i shqiptojë gjykata dhe i cili do të duhej që me metodologjitë, metodat, mjetet dhe njohuritë përkatëse të zbatohen. Pikërisht edhe në paragrafin e fundit, në hyrjen e këtij dokumenti qëndron se “ky material është për njohjen e të punësuarve

<sup>107</sup> Përgjigje në pyetësorin e UE – Kriteret politike, faqe 182

<sup>108</sup> Përgjigje në pyetësorin e UE – Kriteret politike, faqe 185.

<sup>109</sup> Ligji për drejtësinë e të miturve, teksti punues, projekt i Ministrisë së drejtësisë dhe UNICEF-it shkurt 2006.

<sup>110</sup> Doracak për realizimin e kryerjes së masave alternative në qendrat për punë sociale në RM në përputhje me ndryshimet aktuale në dispozitat penale- juridike, AP Enti për veprimtari sociale, shkurt 2006.

nëpër qendra me risitë të cilat do të zbatohen lidhur me masat alternative...”. Si aktivitet në këtë drejtim është edhe këshillimi i mbajtur në Strugë, në korrik të vitit 2006, dedikuar drejtorëve të qendrave. Nuk është për tu anashkuar fakti se në nivelin e entit , janë të dukshme aktivitetet dhe orientimi drejt fillimit përfundimtar të formimit të sistemit ose përgatitjes në vendosjen e bazës mbi të cilën më vonë do të ndërtohen mekanizmat dhe do të zbatohen masat alternative. Por, aktivizimi ose iniciimi veç e veç, shpresojmë se nuk do të çojë drejt introvertitetit, gjatë krijimit të politikave ose orientimit strategjik në nivel të shtetit, pa transparencë dhe informim të organeve të tjera implementuese dhe , para së gjithash, të opinionit, të cilët deri më tash nuk janë njoftuar e as janë informuar për këtë.

## KREU 3

## REZULTATE NGA HULUMTIMI NË TERREN ANALIZA E PYETËSORËVE

### 3.1. ANALIZA E PYETËSORËVE DEDIKUAR PROKURORIVE THEMELORË PUBLIKE

**Pasqyrë e shkurtër nga rregullativa ligjore.** Si organ i ndjekjes penale, prokurori publik, i cili po qe se vëren se janë plotësuar elementet themelore, përkatësisht se janë plotësuar karakteristikat e veprës penale, ngre propozimakuze në gjyq. Më saktësisht, në bazë të materialit dëshmuës të marrë gjatë procedurës parapenale dhe hetimore bën kualifikimin juridik të veprës dhe e vë nën inkriminim të caktuar sipas Kodit penal. Në kudër të propozimakuzës, përveç të dhënave për personin, përshkrimit të veprës, vlerësimi se është fjala për kryerës fajtor, kualifikimit juridik, prokurori publik kërkon nga gjykata që personin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit. Prokurori publik mund të kërkojë nga gjyqi shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ose dënimit me kusht<sup>111</sup>. Kur zhvillohet procedurë e shkurtuar, e kjo ndodh në rastet kur është fjala për vepra të kryera penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me burg deri në tre vjet, prokurori publik mund të propozojë shqiptimin e ndonjërës nga masat alternative (punë e gjithdoshme, ndërprerje me kusht e zhvillimit të procedurës penale ose burg shtëpiak)<sup>112</sup>.

Gjithashtu, dispozitë tejet e rëndësishme nga legjislacioni ynë është edhe ajo e cila e rregullon parimin e oportunitetit të prokurorit publik<sup>113</sup>. Sipas këtij parimi, prokurori publik mund edhe ta shtyjë ose të heq dorë nga ndjekja nëse konsideron se zhvillimi i procedurës nuk është e përshtatshme dhe nëse janë plotësuar kushtet e parapara ligjore. Është fjala për kushte të cilat përcaktojnë se është kryer veprë penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me burg deri në 3 vjet ose dënim me të holla, të ekzistojë pëlqimi i të dëmtuarit, kryerësit (ose ende të dyshuarit në këtë fazë), të jetë në pajtim me urdhërat e prokurorit publik, të mënjanojen pasojat e dëmshme, të kompensohet dëmi dhe të realizohen obligimet tjera. Në kuadër të këtyre “obligime të tjera” Ligji përmend disa: pagesën e shumës së caktuar në dobi të buxhetit të shtetit ose të ndonjë institucioni tjetër ose, madje, për qëllime humanitare, plotësimin e obligimeve të mbajtjes e të ngjashme. Prokurori publik mund të heqë dorë nga ndjekja edhe në rastet kur do të vlerësohet se ekziston pendim i vërtetë, kryerësi ka penguar krijimin e pasojave të dëmshme, ka kompensuar dëmin ose, nëse për shkak të ekzistimit të rrethanave tjera të ngjashme, konstaton se sanksioni penal nuk do të ishte adekuat për rastin konkret.<sup>114</sup> Me rëndësi të veçantë, në këto raste, është që prokurori publik e merr parasysh edhe dëshirën e viktimës (të të dëmtuarit), përkatësisht kërkon pëlqim nga ai që të ndërmarrë ndonjërën nga këto masa (neni 145/1). Pikërisht kjo është në

<sup>111</sup> Ligji për procedurë penale, neni 358.

<sup>112</sup> Ligji për procedurë penale, neni 468, 469.

<sup>113</sup> Ligji për procedurë penale, neni 145.

<sup>114</sup> Ligji për procedurë penale, neni 146.

korrelacion me qëllimin e ligjvënësimit që gradualisht të përfshijë elemente të drejtësisë restorative, me ç' rast theksohet roli i viktimës. Kjo që u tha paraprakisht, në një farë mënyre paraqet ndërmjetësim që si mundësi ligjore për zgjidhje jashtëgjyqësore të kontesteve, ekziston në legjislacionet tjera, por jo edhe te ne, kur është fjala për materien penale. Në rastin konkret, PP ka rolin e arbitrit/ndërmjetësuesit, i cili paraqet propozimin dhe verifikon marrëveshjen të cilën do ta lidhin dhe nënshkruajnë, në praninë e tij, kryerësi dhe i dëmtuari. Kjo mundësi ligjore ekziston edhe pas ngritjes së aktakuzës dhe si risi quhet ndërprerje me kusht e procedurës penale.

**Rezultate nga hulumtimi.** Prej gjithsej 22 prokurori themelore publike në Republikën e Maqedonisë, ishin realizuar 20 intervista. Intervistat qenë realizuar me përfaqësues të prokurorive themelore publike në Gjevgjeli, Strumicë, Koçan, Kërçovë, Dibër Kumanovë, Ohër, Veles, Shtip, Kriva Pallankë, Radovish, Sveti Nikole, Resnjë, Prilep, Tetovë, Gostivar, Berovë, Kavadar dhe Shkup.

Pyetjet të cilave iu përgjigjën prokurorët, në aspektin tematik mund t'i ndajmë në disa pjesë, në të vërtetë, sipas praktikës momentale në propozimin e masave alternative, informimi i prokurorëve publikë themelor me masat alternative, kushtet dhe mangësitë të cilat ekzistojnë sipas PTHP, e të cilat paraqiten si shkak për moszbatimin e masave, bashkëpunimi ndërmjet organeve implementues, çështja e punës së gjithdobishme si masë e re alternative në legjislacionin tonë dhe sipas rolit të opinionit ose bashkësisë në procesin e implementimit të masave..

**3.1.1. Propozimi i masave alternative.** Sipas analizës së përgjigjeve të prokurorëve themelorë publikë, e në kontekst të praktikës së propozimit të masave alternative, lirisht mund të themi se e njëjta nuk ekziston. Duke pasur parasysh mundësitë që i jepen prokurorit publik në pajtim me LPP (neni 468 dhe 469) për të cilat folëm më lart në tekst, prokurorët publikë në propozim nuk propozojnë llojin e sanksionit penal, por propozojnë që personi të gjykohej dhe të dënohej në mënyrë përkatëse. Kjo do të thotë se prokurori publik është kryesisht pasiv sa i përket marrjes së iniciativës së këtyllë. Megjithatë, një pakicë e prokurorëve publikë dhe zëvendësve të tyre të anketuar, deklaruan se në dy raste është propozuar gjykimi dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe në një rast, puna e gjithdobishme. Sipas përgjigjeve, shkaqet ishin detektuar në mosekzistimin e kushteve teknike e materiale për zbatimin e suksesshëm të masave, posaçërisht të burgut shtëpiak. Megjithatë, shtrohet pyetja se në përgjithësi prokurorët publikë a e kanë parasysh materien e masave alternative në përgatitjet e tyre për paraqitjen e propozimaktuzës, prandaj, sipas kësaj, shkakun e veprimit të tyre inert duhet ta kërkojmë në mosnjohjen e materies, në praktikën joekzistuese ose në mosekzistimin e mjeteve teknike për implementimin e masave.

Ishte befasi e dhëna që **puna e gjithdobishme** është propozuar në një rast për vepër penale të kryer- vjedhje. Në të vërtetë PTHP në aktakuzë ka propozuar që personi i akuzuar të punojë 40 orë punë të gjithdobishme, duke mos saktësuar se ku do të kryehet ajo. Me këtë rast gjykata kompetente ka pranuar masën e propozuar, ma sjellë aktgjykim dhe ka shqiptuar masë alternative<sup>115</sup>.

<sup>115</sup> Megjithatë, në aktgjykim përpos numri të orëve, gjykatësi nuk ka konkretizuar se në cilin shërbim publik duhet të dërgohet personi i dënuar. Mosekzistimi i shërbimeve publike konkrete, mënyra, ende jo e përpunuar në mënyrë precize, zbatimit të masës të përmendur dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve të tjera kompetente të cilat duhet të përfshihen në procesin e realizimit të saj, janë pengesa të cilat pengojnë implementimin e kësaj mase në praktikë, përkatësisht aktgjykimin e bëjnë të papërshtatshëm për realizim.

Sa i përket masës **dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse**, përveç dy të anketuarve të cilët pyetjes i janë përgjigjur pozitivisht, përfaqësuesit tjerë shkakët për mospropozimin e tij i shikojnë në mosekzistimin e lëndës së përshtatshme penale, përkatësisht nevojën e shqiptimit të një mase të këfillë. Shkakët për mospropozimin e masave alternative nga ana PTHP për një numër të caktuar të të anketuarve, ishin në mosekzistimin e institucioneve ose kapaciteteve kompetente, para së gjithash, në qendrën për punë sociale për kryerjen e mbikëqyrjes së dënimit me kusht. Duke marrë parasysh se nuk ka mundësi për realizim, ata nuk e propozojnë masën.

Sa u përket **ndërprerjes me kusht të zhvillimit të procedurës penale**, në bazë të një pjese të përgjigjeve të marra është fituar përshtypje se një pjesë e vogël e të anketuarëve nuk bëjnë dallim të qartë ndërmjet shtyrjes, përkatësisht heqjes dorë nga ndjekja penale (sipas parimit të oportunitetit), nga njëra anë, dhe ndërprerjes me kusht të zhvillimit të procedurës penale, nga ana tjetër, sepse të dy institutet mund të zbatohen nga të njëjtat shkaqe: pëlqimi i të dëmtuarit, kryerësit, kompensimit të dëmit dhe mënjanimi të pasojave të dëmshme, por në fazë të ndryshme të tërë procesit. Kështu, një pjesë e të anketuarëve shfrytëzojnë parimin e oportunitetit, përkatësisht nëse ekziston pëlqim nga ana e të dëmtuarit, si dhe gatishmëri që i akuzuari ta kompensojë dëmin<sup>116</sup>, aspak nuk paraqesin aktakuzë. Në të vërtetë, i akuzuari obligohet (që ka qenë kriter i gjithëpranueshëm) të paguajë kompensim të caktuar me para<sup>117</sup> në dobi të shtetit ose të institucioneve të caktuara shëndetësore<sup>118</sup>.

Duke i pranuar pengesat objektive të cilat ekzistojnë në sistemin tonë juridik në periudhën e realizimit të procesit të hulumtimit, për implementimin me sukses të masave të reja alternative, pyetja: nëse ekzistojnë kushtet për shqiptim, *sollën masë alternative do ta propozonit?*- kishte për qëllim që të shihet se sa PTHP-të janë të njoftuar dhe të përgatitur që të kontribuojnë për zbatimin e tyre më të shpeshtë. Edhe përpos mundësisë ligjore, numri më i madh i të anketuarve përmendën dënimin me kusht dhe vërejtjen gjyqësore, si alternativa të mundshme.

Në këtë drejtim, e duke pasur parasysh mundësinë e PTHP që të paraqesë ankesë për aktgjykimin dhe aktvendimin për vërejtje gjyqësore, për shkak të vendimit për sanksionet penale (neni 380 i LPP), si në dobi, ashtu edhe në dëm të të akuzuarit, të anketuarit u pyetën se për shkak të mospajtit të tyre me sanksionin e shqiptuar a kanë **ankimuar** një lloj të tillë aktgjykimi. Sipas përgjigjeve, një numër i vogël i të anketuarve, të pakënaqur me dënimin e shqiptuar me kusht, kanë paraqitur ankesë për zëvendësimin e tij me dënim me burg. Nga kjo mund të konkludohet se PTHP aspak ose rrallëherë e shfrytëzojnë të drejtën të paraqesin mjet të rregullt juridik në dobi të të akuzuarit me të cilin hedhet poshtë aktgjykimi në pjesën të sanksioni i shqiptuar.

**3.1.2. Njohja dhe praktika.** Edhe përpos qëndrimeve relativisht të ndryshme të numri më i madh i pyetjeve, në mesin e prokurorëve publikë, ekziston vetëm pëlqimi se masat alternative janë zëvendësim i mirë i dënimit me burg dhe të njëjtat mund ta realizojnë

<sup>116</sup> Megjithatë, kishte edhe mendime, thënë më saktësisht qëndrim, se në shumë raste, qysh para ngritjes së propozimaktuzës, kryerësi i veprës penale dhe viktimia (i dëmtuari) merren vesh ndërmjet veti (në Gostivar në 90% të rasteve për të cilat mund të shqiptohet dënimi me burg deri në tre vjet, e më shpesh për fatkeqësi komunikacioni ku ka lëndime trupore, vdekje ose dëme materiale), kështu që PTHP gjatë analizimit të punës dhe marrjes në pyetje të viktimës edhe nuk e marrin parasysh në mënyrë serioze qëndrimin e saj, sepse prapëseprapë bëhet fjalë për organ shtetëror, kompetent për të bërë ndjekjen dhe, para së gjithash për dënimin e personit të akuzuar, kurse viktimia, në shumë raste, e pengon dhe nuk e ndihmon zgjidhjen.

<sup>117</sup> Më shpesh 10.000,00 denarë.

<sup>118</sup> "Majcin dom" ose ndonjë organizatë tjetër humanitare.

qëllimin e vet nëse i janë shqiptuar personit përkatës dhe se janë realizuar të gjitha parakushtet e domosdoshme për implementimin e tyre edhe pse nga ajo që u tha më lartë, ata nuk i zbatojnë.

Sa i përket njohjes së prokurorëve publikë për ekzistimin e strategjisë ose të iniciativës qeveritare për implementimin me sukses të masave alternative, sipas përgjigjeve të përmendura, thuaja se gjysma e të anketuarve, nuk janë të njoftuar, as të informuar për çfarëdo qoftë iniciativash ose aktiviteteve. Të anketuarit tjerë deklaruan në mënyrë kategorike se deri më tash një strategji qeveritare në këtë temë, as nuk është përgatitur as nuk është miratuar.

Duke marrë parasysh faktin se personaliteti i kryerësit ka rëndësi të madhe me rastin e propozimit të masës alternative, si lloji i sanksionit penal, e duke pasur parasysh përgjigjet se masat alternative janë zëvendësim i mirë për dënimin me burg dhe mund ta arrijnë qëllimin e sanksionimit, por edhe mosekzistimin e praktikës për propozimin e tyre, në kontekst të verifikimit të një pasqyre më të tërësishme për njohjen e prokurorëve publikë me masat alternative, ata u vunë në pozitë që t'i përgjigjen pyetjes se çfarë njohurish u nevojiten për personalitetin e kryerësit dhe veprën e kryer, që të propozojnë masa alternative. Sa i përket kësaj, të anketuarit i përmendën rrethanat të cilat merren parasysh në përgjithësi gjatë matjes së dënimit, e të cilat janë përfshira në KP, edhe atë: jeta e mëparshme e personit, gjendja familjare dhe materiale, (mos)dënimi paraprak, sjellja gjatë kohëzgjatjes dhe pas kryerjes së veprës, sjellja gjatë kohëzgjatjes dhe pas përfundimit të procedurës penale, pesha e veprës si dhe mënyra e kryerjes së saj dhe ngjashëm. Personaliteti i kryerësit, përkatësisht vetitë karakteristike dhe aftësia e tij që ta pranojë dhe t'i përshtatet masës së shqiptuar si dhe pendimi i shprehur për veprën e kryer, janë përmendur nga ana e 80% të të anketuarve. Është karakteristike dhe e vlefshme për ta përmendur në mënyrë të veçantë, përgjigja sipas së cilës, sjellja e kryerësit ndaj viktimës, duhet të merret parasysh gjatë propozimit të masës.

Pikërisht sa i përket ndikimit të cilin duhet ta ketë viktimja në marrjen e vendimit për propozimin e masës konkrete alternative, pjesa më e madhe e të anketuarve, konsiderojnë se viktimja duhet të ketë rol të caktuar. Roli i viktimës, sipas PTHP shihet në rrethanat vijuese: a e ka kompensuar dëmin i akuzuarit, a i ka kërkuar falje viktimës, a ia ka falur viktimja, si dhe raporti ekzistues ndërmjet të akuzuarit dhe viktimës (nëse janë në marrëdhënie të afërta fqinjësore).

**3.1.3. Kushtet dhe mangësitë.** Të anketuarit japin përgjigje të njëjta edhe në pyetjen vijuese e cila kërkon të theksohen mangësitë ekzistuese për implementim të suksesshëm të masave alternative. Përgjithësisht, ndonëse një pjesë e tyre distancohen nga dhënia e përgjigjeve, para së gjithash, për shkak të mungesës së praktikës që të mund të shihen realisht mangësitë, te pjesa më e madhe e përgjigjeve janë identifikuar mangësitë vijuese: mungesa e mjeteve materiale, mungesa e kornizës ligjore, mungesa e vendosjes institucionale, kuadri jo i edukuar.

**3.1.3.a. Kapacitetet.** Përherë, kur bëhet fjalë për aktivitete të reja të caktuara, për zbatimin e veprimeve të caktuara dhe bartjen e përgjegjësive, është i domosdoshëm ekzistimi i mjeteve (edhe atë jo vetëm të natyrës financiare) që të mund të realizohen qëllimet e parapara. Pikërisht sa i përket ekzistimit të kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe materiale për implementimin e suksesshëm të masave alternative, ndërmjet prokurorëve publikë nuk ekziston mendim i njëzëshëm se janë ndërtuar kapacitete përkatëse për implementimin e masave alternative. Për një numër të madh të anketuarish ekzistojnë kapacitete për implementimin e tyre. Kështu, përderisa një pjesë konsideron se nuk ka kapacitet të mjaftueshëm njerëzor, përkatësisht kuadër kompetent për zbatimin e masave

alternative, një pjesë tjetër mungesën e shikon në mosedukimin dhe joprofesionalizimin për zbatimin e masave alternative. Dhe, gjithsesi, më të shumta janë mendimet të cilat pengesën kryesore për mosfunksionimin e deritashëm të masave alternative e gjejnë në bazën financiare. Sa i përket kësaj, buxhetet e prokurorive publike nuk kanë zëre të veçanta që do t'u dedikoheshin masave alternative. Gjithashtu, mendim i njëzëshëm ishte edhe qëndrimi se nuk ekziston zë i tillë buxhetor sepse PTHP nuk është kompetente në zbatimin e masave alternative. Së këndejmi, financimi duhet t'i bartet gjykatës.

Nga përgjigjet e këtilla mund të vërehet se mangësitë shihen, d.m.th. detektohen në organet tjera, te ata kompetente për zbatim por jo edhe në suazat e kompetencave të veta. Kjo nga ana tjetër çon në konkluzionin se prokurorët publikë nuk e shohin veten në mekanizmin e praktikumit të masave alternative.

**3.1.3.b. Bashkëpunimi.** Sipas përgjigjeve, mund të vërehet se bashkëpunimi ndërmjet prokurorëve publikë dhe gjykatësve për zbatimin e sanksioneve, qendrave për punë sociale, bashkësisë lokale, nuk ekziston ose, atje ku ekziston, ai është në minimum. Megjithatë, nuk guxon të anashkalohet fakti se përgjigjet negative janë rezultat i moszbatimit të masave të reja alternative, por kur është fjala për dënimin me kusht ose, madje, për vërejtjen gjyqësore, nuk ekziston kurrfarë koordinimi. Përmendet vetëm qendra për punë sociale, kur është fjala për procedurë kundër të miturve, por ky është obligim ligjor, sepse PTHP, sipas mendimit të marrë paraprakisht nga Qendra për personalitetin e personit të mitur, vendos se a do të ngrejë aktakuzë ose jo. Involvimi, koordinimi i ndërsjellë, bashkëpunimi, ndihma ose pjesëmarrja në aktivitetet e përbashkëta, nuk ekzistojnë. Kjo vë në dukje faktin se edhe komunikimi bazë paraqet problem.

**3.1.3.c. Edukimi.** Kur është fjala për implementimin e suksesshëm të masave alternative, përveç vendosjes materiale dhe normative, përkatësisht institucionale, është theksuar edhe edukimi dhe profesionalizimi plotësues i kuadrit, si një nga parakushtet plotësuese të cilat duhet të përmbushen. Pikërisht në këtë drejtim PTHP theksuan nevojën e *trajnit*. Edhe pse në një numër më të vogël, megjithatë gjashtë nga të anketuarit konsiderojnë se PTHP-ve nuk u nevojitet trajnim plotësues me arsyetim se ata nuk kanë ingerenca të rëndësishme në këtë sferë. Gjithashtu, katër prej tyre konsiderojnë se edhe institucioneve tjera nuk u nevojitet trajnimi, përveç mjeteve materiale/kushteve. Megjithatë, pjesa më e madhe pajtohet se nevojitet trajnim plotësues, i përbashkët për të gjitha institucionet kompetente, duke inkuadruar gjykata, MPB, qendrat për punë sociale, i cili duhet të përfshijë: shembuj të suksesshëm nga praktika e vendit dhe e huaj, ndarjen decime të detyrave dhe të përgjegjësiave të institucionet kompetente, vendosjen e mekanizmave për zbatim. Njëri nga të anketuarit konsideron se nevojitet edukimi i cili do të orientohet kah mësimi i metodave për vlerësimin e përshtatshmërisë së personalitetit të kryerësit, si kriter subjektiv i cili duhet të merret parasysh gjatë propozimit dhe shqiptimit të masës alternative.

**3.1.4. Puna e gjithdobishme.** Përkundër pajtimit se nuk ekzistojnë baza/ parakushte për implementimin e suksesshëm të punës së gjithdobishme, e cila kryhet në bashkësinë ku personi i dënuar ka vendbanim, përkatësisht vendqëndrim të përhershëm, të anketuarit kanë mendime të ndryshme për parakushtet të cilat duhet të plotësohen që të fillojë zbatimi i kësaj mase alternative.

Kështu, përgjigjet e të anketuarve mund t'i klasifikojmë në disa grupe:

**A.** Kushtet lidhur me mosekzistimin e rregullativës nënligjore, me çka më së afërmi do të rregullohej mënyra e zbatimit dhe të konkretizoheshin dhe ndaheshin kompetencat dhe përgjegjësitë ndërmjet institucioneve kompetente;

- B.** Kushtet lidhur me mbikëqyrjen, përkatësisht “pasivitetin” e qendrave për punë sociale të cilat duhet të jenë aktorët kryesorë në procesin e zbatimit;
- C.** Kushtet lidhur me mosidentifikimin e institucioneve publike dhe shërbimeve publike të cilat do t'i pranonin personat e dënuar si edhe nevojat e paidentifikuara për kryerjen e punës së gjithdobishme;
- Ç.** Kushtet që janë të lidhura me mentalitetin e qytetarëve, përkatësisht vetëdijen dhe mosinformimin e tyre;

Gjatë propozimit dhe shqiptimit të masave alternative, kriteret objektive dhe subjektive lidhur me kryerësin dhe veprën penale, janë paraparë me ligj. Kjo do të thotë se plotësimi i tyre është imperativ. Kështu, përderisa plotësimi i kriterëve objektive (personi i akuzuar të jetë për herë të parë kundërvajtës dhe lartësia e dënimit të veprës së kryer të jetë deri në tre vjet) është i pakontestueshëm, shtrohet pyetja se në çfarë mënyre bëhet vlerësimi i personalitetit të personit të dënuar, si kriter subjektiv, gjatë përcaktimit të përshtatshmërisë së tij, që t'i shqiptohet masa punë e gjithdobishme.

**3.1.4.1. Personaliteti i kryerësit.** Lidhur me njohuritë me të cilat disponojnë PTHP gjatë njohjes së personalitetit të kryerësve të veprave penale, qëllimi ishte që të shqyrtohet se a bie në kontakt dhe PTHP me personin (në cilën pjesë të procedurës penale). Kështu, sipas përgjigjeve të ofruara, burimet e njohurive mund të ndahen në burime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta:

- ✓ Në *burime të tërthorta* numërohen fletëparaqitja penale, evidenca ndëshkimore e gjykatave, raportet e qendrave për punë sociale, por vetëm kur është fjala për kryerës të mitur të veprave penale.
- ✓ Si *burime të drejtpërdrejta* për të fituar njohuri për personalitetin e personit të akuzuar përmenden: deklaratat e vetë personit të akuzuar, të dëshmitarëve dhe të personit të dëmtuar.

Është e qartë se njohuritë e pakta që i disponon PTHP, mungesa e komunikimit me organe të tjera për të marrë informata dhe profilimin e personalitetit të kryerësit (personit të akuzuar), posaçërisht (mos)bashkëpunimi me qendrat për punë sociale edhe në rrethana të tjera (përveçse për të mitur) për të marrë këshilla profesionale dhe informata, gjatë vlerësimit të profilit të personit, flasin padyshim se PTHP aspak nuk i ka ndryshuar mënyrën dhe metodat e punës, në përputhje me ndryshimet që i imponojnë masat alternative dhe legjislacioni ekzistues. Hendikepi i këtillë është vetëm vërtetim se PTHP as që mundën, me një mënyrë të këtillë të punës, të marrin pjesë në propozimin e masave alternative sepse me këtë nënkuptohet një rol më aktiv i PTHP në vlerësimin e rasteve kur, për cilin kryerës dhe për çfarë veprë, cilën masë alternative t'ia propozojë gjyqit

**3.1.5. Ndërgjegjja publike.** Përgjigje interesante janë dhënë në pyetjen si e shohin PTHP-të rolin e bashkësisë në zbatimin e punës së gjithdobishme. Kështu, përderisa një pjesë e të anketuarve shfaqin mosbesim dhe skepticizëm në pranimin dhe në dhënien e përkrahjes nga bashkësia, posaçërisht nga mjedisi primar, të tjerët mendojnë se bashkësia ka rol primar në risocializimin e personit si qëllim kryesor i sanksioneve penale dhe posaçërisht e theksojnë ndikimin e saj primar në këtë proces. Megjithatë, një pjesë distancohen duke theksuar se për shkak të mosimplementimit të tyre, vështirë që mund të flitet për vetë masat alternative si dhe të parashikohet qëndrimi i bashkësisë gjatë zbatimit të tyre.



Pikërisht lidhur me atë që u tha më lartë, në të shumtën e rasteve PTHP deklaruan se nevojitet të rritet ndërgjegjja publike te qytetarët, të njoftohen me qëllimet, me mënyrat e zbatimit dhe me rolin që e ka bashkësia në implementimin e suksesshëm të masave alternative. Vetëm në dy raste ishte theksuar se qytetarët nuk duhet të njoftohen me masat alternative, duke argumentuar se ndërgjegjja publike vështirë ndryshohet, përkatësisht se ato masa (veçanërisht puna e gjithëdobishme) më shumë do t'i stigmatizojë personat të cilët e zbatojnë, pikërisht për shkak të raportit të popullatës ndaj tij.<sup>119</sup>

Derisa numri më i madh i të anketuarve konsiderojnë se mediumet elektronike, para së gjithash nëpërmjet emisioneve edukative, janë mënyrë/mjet kryesor për t'i njoftuar dhe informuar qytetarët, pjesa tjetër si burime për ngritjen e ndërgjegjes publike i numërojnë edhe materialet e shtypura, broshurat si dhe tribunat publike. Si plotësim ishte theksuar se do të ishte shumë më profesionale dhe më e dobishme po qe se edukimin dhe informimin e popullatës e bëjnë persona profesionale, të përfshirë drejtpërdrejtë në procesin e implementimit. Kjo rrjedh nga fakti që disa nga të anketuarit nuk i besojnë saktësisë së asaj që paraqitet nëpërmjet medimeve.

## KONKLUZIONI

Ndonëse në mënyrë joformale e ndoshta edhe me “pavetëdije”, megjithatë, prokurorët marrin pjesë në krijimin e politikës dhe ndërtimin e praktikës në zbatimin e mënyrave alternative të veprimit, qëllimi i të cilave është që t'i iket burgosjes, shkaktimit të dëmit shtesë dhe izolimit të kryerësve të caktuar të veprave penale. Pikërisht nëpërmjet zbatimit të parimit të oportunitetit, roli i prokurorëve publikë, deri diku është ndryshuar. Kjo shihet edhe në faktin që, në raste të këtilla, prokurorët publikë në një farë mënyre “gjykojnë” dhe me këtë i shmangen ose e shtyjnë zhvillimin e procedurës penale ose “dënojnë” dhe caktojnë që kryerësi i veprës penale të paguajë një shumë të caktuar të hollash në interes të ndonjë organizate shëndetësore ose humanitare. Ngjashëm me këtë të fundit është edhe “dënimi” i kryerësit të veprës penale nëpërmjet kompensimit ose restituitit të viktimës. Nga kjo mund të thuhet se prokurori publik në njëfarë forma ka funksionin e gjykatësit.

Ndërkaq, sa i përket zbatimit të masave alternative gjatë procedurës, aktiviteti i prokurorëve publikë është vënë në nivel të palakueshëm, përkatësisht, në të vërtetë nuk mund të thuhet se në këto situata prokurorët publikë kanë ndonjë rol. Kjo del nga ajo se prokurorët publikë (përpos në situata të jashtëzakonshme kur kanë propozuar dënim me kusht) gjatë paraqitjes së propozimkuzës, nuk propozojnë ndonjë lloj sanksioni penal. Me këtë rast, nuk bëhet vlerësimi i personit (të akuzuar për vepër penale) nënkuptim të vlerësimit të profilit të personit, për të cilin do të ishte e mundshme, nëse propozojnë, që gjykata të shqiptojë masë alternative. Gjithashtu, rëndom ndodh që ata të mos dorëzojnë ankesë reth aktgjykimit, në rastet kur kanë propozuar masë alternative, kurse gjykata ka

<sup>119</sup> Në këtë kontekst do të vëmë në pah edhe qëndrimin (ndonëse e marrim si përjashtim) njohja e masave alternative supozon edhe njohje e të dhënave personave të dënuar përkatësisht nevojën që ato të shpallen publikisht sepse në atë mënyrë do të veprohet në mënyrë preventive. Kjo në masë të madhe flet për të menduarit se shkaktimi i turpit është mjet preventiv që as për së largu nuk është rrethanë e afërt e masave alternative dhe që tentohet të arrihet më to.

Shqiptuar dënim. Nga kjo del edhe roli tradicional i prokurorit që të akuzojë dhe të përpiqet që gjykata ta dënojë personin. Në shumë pak raste mbajnë llogari për nevojat e vërteta të viktimit. Përveç rolit themelor të paraparë në ligj, nevojat e viktimit nuk janë reflektuar nëpërmjet aktiviteteve të prokurorëve publikë, gjatë formimit të pasqyrës së plotë, në rastin e propozimit të masës alternative.

Përveç praktikës joekzistuese sa i përket propozimit të masave alternative, ndonëse ky organ duhet të ketë rol të rëndësishëm në sistemin e implementimit të masave alternative, nuk ka njohuri për rolin e vet dhe aktivitetet konkrete. Prokurorët publikë nuk janë të informuar as për aktivitetet që i ndërmarrin qeveria, ministritë dhe institucionet përkatëse, që tregojnë se nuk ekziston komunikim dhe këmbim informatash dhe bashkëpunim e cila do të jetë e domosdoshme në të ardhshmen. Pikërisht sa i përket bashkëpunimit, prokurorët publikë, përpos me qendrat për punë sociale dhe shfrytëzimit të shërbimeve të tyre ( dhe kjo vetëm në rastet me të miturit), nuk kanë bashkëpunim me institucione të tjera, ndonëse kanë mundësi ligjore që t'i shfrytëzojnë shërbimet e tyre.

### 3.2. ANALIZË PYETËSORËVE DEDIKUAR GJYKATAVE THEMELORE

**Pasqyrë e shkurtër nga rregullativa ligjore.** Përpos rolit veçanërisht të rëndësishëm të prokurorit publik, në fushën e aktiviteteve që do të thoshin deinstitutionalizim dhe shmangie e procedurës ose burgosjes në kontekst të mënyrave alternative të veprimit, gjykatës e ka sfidën dhe përgjegjësinë gjatë sanksionimit. Në këtë rol të vetin, gjykata orvatet që përmes sanksioneve të kënaqë shumë kushte të tjera, përkatësisht, të dënojë për veprën e kryer, të burgosë, të bëjë vërejtje, të rehabilitojë ose risocializojë, të mbajë llogari si për kryerësin ashtu edhe për të dëmtuarin, për ngadhënjimin e drejtësisë e të ngjashme.

Përveç përcaktimit themelor se kryerësve të veprave penale u shqiptohet dënimi i përcaktuar me ligj, në raste të veçanta gjykata dënimin e përcaktuar me ligj mund ta zbusë.<sup>120</sup> Gjatë matjes së dënimit gjykata merr parasysh rrethana të ndryshme, përkatësisht, karakteristika, për shembull, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra, jetën e mëparshme të kryerësit, gjendjen e tij familjare dhe materiale/pronësore, peshën e veprës penale, shkëlqjen e bërë, pasojat nga kryerja e veprës ndaj kryerësit, se si ndikojnë të njëjtat te ai, nevojat për risocializimin e tij e ngjashëm<sup>121</sup>. Sipas kësaj, edhe nëse ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese, gjykata mund të shqiptojë edhe dënim më të ulët se ajo që është paraparë me ligj.<sup>122</sup> Megjithatë, edhe në këto raste ligji parasheh garanci lidhur me atë se cili dënim, në çfarë mase, mund të zbutet<sup>123</sup>, madje edhe kryerësin ta lirojë nga dënimi. Të tilla janë situatat kur gjykata mund ta lirojë nga dënimi personin deri në përfundimin e procedurës penale nëse është fjala për vepra për të cilat ligji parasheh shqiptimin e dënimit me të holla ose dënimit me burg deri në tre vjet, kur personi do t'i kompensojë pasojat e dëmshme, dhe me rëndësi të veçantë është që të ekzistojë pëlqim i të dëmtuarit.<sup>124</sup>

<sup>120</sup> Kodi penal, neni 34.

<sup>121</sup> Kodi penal, neni 39.

<sup>122</sup> Kodi penal, neni 40.

<sup>123</sup> Kodi penal, neni 41.

<sup>124</sup> Kodi penal, neni 43-à.

Me Kodin penal janë përcaktuar rregullat e veprimit të gjykatës në rastin e shqiptimit të ndonjëres nga masat alternative. Megjithatë, me Ligjin për procedurë penale është përcaktuar se ndaj propozimit të paraqitur të prokurorit publik (paditësit të autorizuar) për shqiptimin e masës alternative (neni 468 i LPP), gjykata mund të marrë vendim për të njëjtat pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor me ç' rast kuptohet se, doemos të ruhen kriteret kur merret aktgjykimi, pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Me këtë rast gjykatësi, nëse prokurori pajtohet me mënyrën e këtillë të zhvillimit të procedurës dhe marrjen e vendimit të këtillë, gjykata do të sjellë aktgjykim me të cilin do të shqiptojë masë alternative.

**Rezultatet e hulumtimit.** Prej gjithsej 27 gjykatave themelore në Republikën e Maqedonisë, u realizuan 24 intervista me përfaqësuesit e gjykatave themelore të Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Shkupit 1 dhe Shkupit 2, Resnjës, Ohrit, Krushevës, Velesit, Vinicës, Gjevgjelijës, Dellçevës, Kavadarit, Koçanit, Kratovës, Kriva Pallankës, Kumanovës, Negotinës, Radovishit, Sveti Nikoles, Strumicës dhe Berovës. Nga përfaqësuesit e intervistuar, 8 ishin kryetarë të gjykatave themelore dhe 16 ishin gjykatës penalë.

Sipas analizës së intervistave të bëra, gjendja momentale me zbatimin e masës alternative punë e gjithdobishme dhe dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, vë në dukje faktin se, edhe pse të pazbatuara, mund të thuhet se gjykatësit kanë njohuri të përgjithshme për të njëjtat dhe përgjithësisht kanë vullnet t'i zbatojnë edhe pse ekzistojnë mangësi të mëdha dhe nuk janë plotësuar një numër i madh parakushtesh, të cilat do t'i vështrojmë më poshtë në tekst.

Në shqiptimin e masave alternative ekziston praktikë për dënimin me kusht dhe vërejtjen gjyqësore. Shkak për zbatimin e vetëm këtyre masave është se nuk kërkojnë angazhime plotësuese të organeve tjera, nuk kërkojnë aktivitete të bashkësisë, nuk kanë mekanizma mbikëqyrës ose mekanizma të kontrollit, edhe pse do të duhej të ekzistonte e gjithë ajo që u tha qëparë. Kjo shpie në qëndrimin se proceset e risocializimit ose të përmirësimit të sjelljes vështirë mund të shihen/vërtetohen, pavarësisht se ekziston ose nuk ekziston përmirësim i sjelljes, të kuptuarit e veprës së kryer që e ka shkaktuar ajo e ngjashëm. Përkatësisht, nuk ka informatë kthyesë në gjykatë për atë se vendimi përkatës është efikas ose jo. Befasi ishte njohuria se nga repertori i masave alternative, në Gjykatën themelore të Prilepit dy masa të punës së gjithdobishme<sup>125</sup>, në Gjykatën themelore të Kriva Pallankës një dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse<sup>126</sup> dhe në Gjykatën themelore Shkup 1 në një rast është shqiptuar masa ndërprerje me kusht e zhvillimit të procedurës penale.

Nga pyetjet të cilave u janë përgjigjur gjykatësit, u koncipuan disa aspekte edhe atë, u përcaktuan kushtet për shkak të të cilave nuk zbatohen masat alternative dhe mangësive të cilat, sipas gjykatësve, ekzistojnë për moszbatimin e tyre. Në vazhdim, pyetje të posaçme u kushtuan punës së gjithdobishme dhe dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.

**3.2.1. Kushtet dhe mangësitë.** Prapavija e praktikës joekzistuese të shqiptimit, e me këtë edhe të zbatimit të masave alternative, gjykatësit e shohin në mosekzistimin e kushteve, mjeteve, mekanizmave të organizimit, profesionalizimit dhe aftësisht për zbatimin e tyre dhe të mosekzistimit të mbikëqyrjes së zbatimit. Thonë se shumë lehtë është të shqiptohen, por çfarë efekti do të ketë shqiptimi kur i njëjti nuk ka mundësi të zbatohet.

<sup>125</sup> Që të dyja masat u shqiptuan në vitin 2006.

<sup>126</sup> Në vitin 1995 prej gjithsej 2463 aktgjykimeve vetëm në 4 ka qenë e shqiptuar mbikëqyrja mbrojtëse, në vitin 1998 prej gjithsej 2347 dënimeve me kusht vetëm në 4 raste ka qenë i shqiptuar dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, në vitin 1999 prej gjithsej 2648, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse ka qenë i shqiptuar në 3 raste, kurse në vitin 2000 prej gjithsej 2440 dënimeve me kusht, në 5 raste ka qenë i shqiptuar dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Dragi Celevski, "Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse", - Eliminimi i pengesave për implementimin praktik të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, Qendra ndërkombëtare për aktivitete preventive dhe zgjidhjen e konflikteve, faqe 34, Shkup, 2002.

Rezultatet tregojnë se momentalisht nuk ekzistojnë kushte për implementimin e masave alternative. Sa u përket kushteve, sipas përgjigjeve të dhëna nga gjykatësit, të njëjtat mund të ndahen në disa nivele: në nivelin e rregullativës nënligjore, në nivelin e vendosjes organizative, në nivelin e kapaciteteve dhe në nivelin e njohjeve dhe pranimit të masave alternative.

Pikërisht këtu ne do të shtonim se është e domosdoshme të ndryshohet roli i gjykatësit dhe metoda e punës së tij. Në të vërtetë, masat alternative kërkojnë një qëndrim shumë aktiv të gjykatësit në tërë rrjedhën e procedurës, si gjatë shqiptimit, ashtu edhe në procesin e zbatimit. Flasim për masa për të cilat nevojitet përkushtim, profesionalizëm, aktivitet dhe kreativitet i madh, nëse insistojmë të zbatojmë një sistem i cili do të qëndrojë në bazë solide, kurse këtë e shohim pikërisht në vendosjen dhe rolin (dhe pse jo vetëm në atë) e gjykatësit/gjykatëses.

**3.2.1.a. Rregullativa nënligjore.** Edhe pse masat alternative me ligj janë rregulluar në Kdin penal dhe në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, megjithatë, si një nga kushtet më të rëndësishme, të domosdoshëm për zbatimin efikas të masave alternative, është ekzistimi i rregullativës nënligjore. Përkatësisht nevojitet ekzistimi i udhëzimeve, rregulloreve dhe doracakëve të tjerë me çka do të rrumbullakohet korniza e cila do ta bënte të mundshëm zbatimin praktik të masave të këtylla. Në të vërtetë, të gjithë gjykatësit e intervistuar<sup>127</sup> deklaruan pa përjashtim se nuk ekziston rregullativë nënligjore, nuk dinë se a janë ose nuk janë të informuar, se Qeveria përgatit ndonjë strategji ose se, në përgjithësi, a ekziston ndonjë iniciativë e cila do ta aktualizonte dhe rregullonte në mënyrë të hollësishme këtë materie<sup>128</sup>.

**3.2.1.b. (Mos)vendosja organizative.** Gjithashtu, u theksua vendosja momentalisht jo përkatëse, përkatësisht mosekzistimi i vendosjes organizative. Në të vërtetë, sipas përgjigjeve të gjykatësve, në suazat e qendrave për punë sociale nuk ekzistojnë seksione të cilat do të jenë kompetente dhe të trajnuara për zbatimin e masave, edhe pse me Ligjin<sup>129</sup> është përcaktuar se seksione të këtylla duhet të formohen. Seksionet dhe kuadrot e këtylla janë të domosdoshëm për zbatimin e masave në praktikë.

Me rëndësi të veçantë u theksua problemi me mekanizmat e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të cilat do të duhej të ekzistonin pikërisht në suazat e këtij organi. Në të vërtetë, për gjykatësit përgjigja që mungon i dedikohet pyetjes se cili është organi kompetent që do ta zbatojë dhe si do të zbatohet kjo mbikëqyrje, cili kujt do t'i përgjigjet dhe kush cilin do ta informojë për punën e vet. Edhe pse sipas KP është përcaktuar në mënyrë të qartë se cili është organ mbikëqyrës për masën konkrete, megjithatë, mekanizmi i zbatimit të mbikëqyrjes, por edhe i informimit të organeve të tjera, si dhe ndërmarrja e masave në këtë kontekst, nuk është i njohur dhe u shtrua si moment brengosës. Më saktë, gjykatësit në pjesën më të madhe e theksuan këtë problem si shkak se pse ata nuk i shqiptojnë këto masa. Disa gjykatës konsideruan se , edhe pse nuk ekziston një mekanizëm i zhvilluar për zbatim, prapëseprapë,

<sup>127</sup> Vetëm në një përgjigje që theksuar se QPS kanë rregullativën e vet, më saktë se kanë rregullore, por informata më të hollësishme nuk ishin dhënë. Kjo përgjigje më shumë dukej si supozim se një deklaratë e sigurt.

<sup>128</sup> Në këtë kontekst ishte edhe deklarata e një gjykatësi se ligjet miratohen pa mos i informuar, e para së gjitha, pa mos i konsultuar vetë praktikuesit- gjykatësit. Kritika e këtyllë i drejtohet mu ligjvënësit, jo vetëm për mungesën e komunikimit gjatë hartimit të kornizës juridike për masat alternative, por në përgjithësi gjatë nxjerrjes së ligjeve.

<sup>129</sup> Gjykatësit flitnin për nenin 226 të ligjit për zbatimin e sanksioneve (LZS) sipas të cilit duhet të formohet organi/ seksioni i tillë.

doemos duhet të fillohet me shqiptimin e tyre. Kjo do të sjellë rritjen e numrit të tyre në atë masë sa që do të jetë e domosdoshme që shteti përfundimisht, të krijojë kushte për zbatimin e tyre. Është e qartë se për këta gjykatës nevojitet t'i bëhet presion shtetit që të ndërmarrë masa, të fillojë t'i plotësojë obligimet e marra me ligj, të cilat i kanë nxjerrë vetë, me qëllim që gjykatësit të mund ta kryejnë funksionin e vet. Në këtë mënyrë do të mund të ndikohet që politika ndëshkimore ta kalojë prapë dhe ta zgjerojë repertorin e sanksioneve të përdorshme ( e jo vetëm të shkruara) dhe të mund të realizohen qëllimet të cilat me këto masa mundet dhe duhet të realizohen<sup>130</sup>.

Nga përgjigjet e gjykatësve vërehet se ata kanë aluduar në një mekanizëm jashtë gjykatës, më saktë, i theksuan qendrat si bartëse themelore të këtij funksioni që mungon dhe si një nga shkaqet më të rëndësishme për mosshqiptim. Qëndrimi për hedhjen e përgjegjësisë ndonjë organi tjetër është zgjidhje përkatësisht arsyetim shumë e lehtë, kurse lidhur me këtë menjëherë shtrohet pyetja se çka ndodhë me gjykatësin për zbatimin e sanksioneve. Në të vërtetë, në shumicën e gjykatave themelore janë emëruar/caktuar gjykatës për zbatimin e sanksioneve. Në disa gjykata këta janë gjykatës të veçantë, në disa këta janë gjykatës të cilët përveç funksionit klasik të gjykatësit e kanë edhe këtë- funksion të gjykatësit për zbatimin e sanksioneve (kjo veçanërisht ka të bëjë me gjykatat më të vogla themelore), në disa ky funksion është në fushën e punës së kryetarit të gjykatës themelore. Nga kjo del se në një numër më të madh gjykatash, gjykatësi për zbatimin e sanksioneve, si funksion i veçantë, nuk ekziston, por është i kombinuar me funksionin e gjykatësit. Megjithatë, edhe atje ku ekziston, i njëjti nuk është përpunuar. Nga kjo del se, shikuar formalisht, në gjykata ka organ i cikli do të duhej të ishte kompetent për zbatimin e një pjese të masave alternative, por funksioni i tij nuk është diferencuar ende në mënyrë të qartë, e kështu edhe i padobishëm në këtë drejtim. Në pajtim me LZS është paraparë që gjykatësi për zbatimin e sanksioneve të bashkëpunojë me QPS gjatë zbatimit të masave alternative.

**3.2.1.c. Kapacitetet.** Është e kuptueshme se nëse masat alternative sendërtohen në praktikë, do të nevojiten mjete plotësuese për efektimin e tyre. Nga përgjigjet e gjykatësve u vërejt se kur është fjala për mjetet, mendohet për mjete financiare. Megjithatë, ky është vetëm një aspekt i cili u mor parasysh. Këtu bëjnë pjesë edhe resurset njerëzore, institucionale, materiale dhe financiare. Konkluzion i përgjithshëm i cili mund të nxirret nga përgjigjet, është se kryesisht, gjykatat disponojnë një numër të mjaftueshëm resurcesh njerëzore dhe nuk mungojnë resurset institucionale. Por, sa u përket resurseve materiale, përkatësisht financiare, gati të gjitha përgjigjet vunë në pah atë se momentalisht ato nuk ekzistojnë edhe pse janë të domosdoshme për zbatimin e drejtë të këtyre masave. Në të vërtetë, përveç financave, gjykatësve nuk u mungon ndonjë gjë tjetër. Në disa nga përgjigjet u paraqitën edhe mendime se ekzistimi i kapaciteteve është çështje politike dhe se qeveria duhet të sigurojë kushte dhe mjete, përkatësisht instrumente që të ndryshojë gjendja. Krahas momentit të financave, gjykatësit u përgjigjën se buxhetet gjyqësore nuk ndajnë mjete për masat alternative. Vetëm në një rast, përkatësisht vetëm një gjykatës theksoi se ndarja e mjeteve nga buxheti gjyqësor për masat alternative, nuk është e nevojshme, duke marrë parasysh se gjykatat vetë i shqiptojnë masat si edhe të gjitha sanksionet tjera. Kjo aludon në faktin se çështja financiare do të duhej të kërkohej te organet tjera, përkatësisht te ato që janë kompetente për zbatim.

<sup>130</sup> Një iniciativë e këtillë ka ekzistuar edhe te gjykatësi nga Gjykata themelore Pril, i cili ka shqiptuar masën punë e gjithëdobishme, duke ditur se momentalisht nuk ekzistojnë kushte e as organe për implementimin e tyre..

Nga kjo që u tha më lartë, del se e vetmja gjë që mungon, në kuadër të gjykatës, janë mjetet financiare, edhe pse është e paqartë pikërisht pyetja se në çfarë drejtimi do të shfrytëzoheshin këta mjete.

**3.2.1.ç. Bashkëpunimi.** Sa i përket gjendjes momentale të bashkëpunimit ndërmjet organeve (gjykatësit për zbatimin e sanksioneve, Qendrave, Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve dhe vetadministrimit lokal) në temën e masave alternative, gjykatësit deklaruan se nuk ka bashkëpunim, duke marrë parasysh faktin se nuk janë shqiptuar. Por, në përgjithësi, lidhur me bashkëpunimin, gjykatësit kishin qëndrime mjaft të ndryshme. Kështu, në rajone të caktuara gjyqësore, 75% të të anketuarve konsideronin se bashkëpunimi ekziston, kurse për 25% të të anketuarve bashkëpunimi mungon krejtësisht. Madje edhe ata të anketuar, të cilët deklaruan se ka bashkëpunim, 20% e tyre vunë në dukje se i njëjti nuk është në nivel të kënaqshëm. Në 26% të përgjigjeve të dhëna pohuese sipas të cilave bashkëpunimi u klasifikua si i mirë, gjykatësit saktësuan se megjithatë, i njëjti ka të bëjë me çështjen e të miturve, e personave të rritur që kanë problem me alkoolin, drogën dhe për rastet e dhunës familjare, që do të thotë se bashkëpunimi u dedikohet kategorive të caktuara dhe sipas nevojës, por nuk paraqet praktikë.

Duke marrë parasysh faktin se deri më tash nuk janë shqiptuar masa alternative, është gjë normale që në këtë sferë të mungojë bashkëpunimi tërësisht. Nga kjo del se nevojitet përpjekje plotësuese që bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy organeve, pavarësisht sa është i mirë, të përparojë. Duke marrë parasysh se në një të ardhme të afërt do të fillojë zbatimi edhe i këtyre masave, bashkëpunimi i tyre doemos të forcohet, përkatësisht të zhvillohen komunikimi dhe bashkëpunimi.

Sa i përket bashkëpunimit me vetadministrimin lokal, gjykatësit deklaruan se nuk ekziston bashkëpunim në asnjë nivel. Pasqyra e përgjithshme vë në dukje se vetadministrimi lokal është plotësisht i përjashtuar nga puna e gjyqësisë (përveç kur paraqitet si palë të kontest, që është jashtë fushës së kësaj teme) dhe, me siguri, plotësisht i painformuar për praktikën gjyqësore dhe për politikën ndëshkimore, për të priturat dhe për rolin e tij që duhej ta kishte ose, thënë më mirë, që duhet ta ketë në të ardhmen, pikërisht në kontekst të masave alternative. Gjithashtu, në një rast u paraqit qëndrimi se vetadministrimi lokal është krejtësisht indiferent ndaj punës së gjykatës.

Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet gjykatësve dhe Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve, në numrin më të madh të rasteve (55% të të anketuarve) u tha se nuk ekziston bashkëpunim. Sipas të tjerëve, bashkëpunimi zhvillohet pa probleme, por në 15% të përgjigjeve, bashkëpunimi nuk realizohet në nivelin e drejtpërdrejtë me gjykatësin gjyqësor, por në nivel të kryetarit të gjykatës-Drejtori ose gjykatësit për zbatimin e sanksioneve- Drejtori. Nga aspekti i masave alternative, duke marrë parasysh se deri më tash nuk janë shqiptuar, e as që është e mundshme që të ekzistojë bashkëpunim. Është interesante e dhëna që sipas praktikës së deritashme, gjykatësi gjyqësor nuk kontakton drejtpërdrejtë me Drejtorinë, por ka ndërmjetës që në kontekst të masave alternative mund të vë në dukje mekanizmin ekzistues (raportin gjykatës gjyqësor - gjykatës për zbatimin e sanksioneve - Drejtori), që duhet të përpunohet rishtazi.

**3.2.1.d. Njohja dhe pranimi i masave.** Sa u përket njohjeve për masat alternative dhe informimit të gjykatësve për të njëjtat, përveç dispozitave ligjore (KP, LPP dhe LZS) dhe disa këshillimeve atyre nuk u është dërguar asgjë, nuk janë informuar për të njëjtat, e as që ka pasur ndonjë aktivitet në drejtim të edukimit, informimit dhe trajnimit. Megjithatë, nga përgjigjet e gjykatësve mund të fitohet një pasqyrë se ekzistojnë njohuri të përgjithshme, veçanërisht kur është fjala për llojet e veprave penale, për të cilat, masat e këtilla mund të

shqiptohen. Në të vërtetë, sipas përgjigjeve, sa i përket llojit të veprës penale, duket të bëhet fjalë për vepra penale më të lehta, për vepra të cilat mbahet procedurë e shkurtër, për shembull “rrahje, ndeshje komunikacioni, vjedhje, për vepra për të cilat shqiptohet dënime burg deri në tre vjet”. Sa u përket kryerësve, ata duhet të jenë kundërvajtes për herë të parë<sup>131</sup>. Sa i përket as se a do të shqiptonin masë alternative, si sanksion të pavar, ose do ta kombinonin edhe me dënime të tjera, përgjigjet ishin të ndryshme. Për disa gjykatës, këto masa do të mund të shqiptoheshin vetëm si sanksione unike, për të tjerët mund të kombinohen, megjithatë, për shumicën e gjykatësve vendimi se a do të shqiptohen si unike ose do të kombinohen me masa dhe dënime të tjera, varet nga rrethanat përkatësisht nga çdo rast i veçantë.

Në kuadër të pyetësorit dedikuar gjykatësve, u shtrua edhe pyetja se a do të shqiptonin masë alternative, në rastin kur prokurori publik do të propozonte lloj tjetër të sanksionit. Sipas përgjigjeve, është qëndrim i përgjithshëm se gjykatësit kanë liri të plotë të vendosin edhe atë, në mënyrë plotësisht të pavarur lidhur me llojin e sanksionit. Përgjigjet ishin të tipit “ne jemi të lirë dhe të pavarur krejtësisht në vlerësim”, “PTHP mund të kërkojë, por unë vendos”, “PTHP nuk guxon të përzihet”, “PTHP nuk më obligon”. Përgjigjet e këtilla dukeshin mjaft defanzive, sikur çështja ta prekte pavarësinë dhe sovranitetin e gjykatësit. Megjithatë, kishte edhe disa përgjigje sipas të cilave gjykatësit e marrin parasysh edhe kërkesën e PTHP, e peshojnë dhe atëherë vendosin dhe nëse shohin se kërkesa e PTHP është me bazë, ata e pranojnë. Disa përgjigje kishin të bënin me atë që PTHP në të vërtetë, nuk propozojnë llojin e sanksionit (ose kjo ndodh shumë rrallë), por kërkojnë që i akuzuari të dënohet<sup>132</sup>, me çka lënë mundësinë e lirisë së plotë që gjykatësi të vendosë për llojin e sanksionit. Sipas një mendimi të vetmuar, do të ishte e dobishme që PTHP të fillojë të praktikojë zgjidhjen ligjore më shpesh dhe gjykatës t'i propozojnë edhe llojin e masës alternative, me çka do të përfshihej në procesin e ndërtimit ose të zhvillimit të sistemit të zbatimit të masave alternative dhe të procedurës jashtëgjyqësore.

Ishin mjaft interesante përgjigjet në pyetjen se a kanë nevojë për ndonjë trajnim në këtë drejtim. Përgjigjet lëviznin prej atyre pohuese, me ç' rast ekzistonte nevoja e takime koordinuese për sinkronizimin e aktiviteteve të të gjitha organeve relevante, të involvuara në zbatimin e masave alternative dhe identifikimin dhe precizimin e kompetencave, deri te mospasja e nevojës për trajnim. Për një numër të vogël gjykatësish nevojiten trajnime edukative, të cilat kenë rëndësinë e kuptimit të nevojës së këtyre masave, qëllimit të tyre, marrjes edhe të përvojave të tjera/të huaja dhe praktikës së mirë, saktësismit të mënyrave dhe rrethanave të shqiptimit, si dhe mënyrave të zbatimit e ngjashëm. Të gjithë gjykatësit e intervistuar vunë në pah nevojën e mbajtjes së trajnimeve edukative për organet tjera (QPS dhe MPB) të përfshirë në sistemin e zbatimit të masave.

Sa i përket *pranimit të masave*, ndonëse në masë më të madhe për gjykatësit masat janë të pranueshme, megjithatë, për një numër të caktuar ende vlejné rregullat, si për shembull “detyrimi te ne ende është efikas”. Një dozë relative e skepsës, që ekziston te disa gjykatës lidhur me masat alternative, rrjedh nga mosnjohja e koncepteve për të cilat angazhohen të njëjtët. Kështu për shembull, sipas të gjithë gjykatësve të intervistuar, ndonëse masat alternative janë zëvendësimit i mirë i dënimit me burg dhe mund ta arrijnë qëllimin e vet, aplikimi i punës së gjithdobishme, për një pjesë të tyre (30% e të intervistuarve<sup>133</sup>) paraqet

<sup>131</sup> Lidhur me pyetjen për ata që për herë të parë kanë kryer delikt, p. 1.3. ose fusnota nr.32.

<sup>132</sup> Thuhet se PTHP akuzon dhe angazhohet që të dënojë, por gjykatësi peshon e pastaj vendos.

<sup>133</sup> Vërejtje: duke marrë parasysh përqindjen, doemos duhet theksuar se përgjigjet e këtilla ishin dhënë disa herë të gjykatës të njëjtë, përfaqësues të 6 gjykatave themelore..

“marrje e punësimit të personave të tjerë”, “paguarja e mëkatit”, “më mirë të fshijnë/pastrojnë se sa t’u paguhet vendosja hoteliere në burg”, “le të pastrojnë, fshijnë, e jo ta ushqejmë kriminelin”, “duhet të mbajnë uniforma, për shembull, të gjelbra që të duhet se ata vuajnë dënimin”, “më mirë të mbledhin copa letre nëpër stacione të autobusëve” e ngjashëm. Terminologjia e tillë lë nënkupton që mirëkuptimi për masat alternative nuk është në nivelin që do të mundësonte zbatim praktik dhe efekt adekuat nga zbatimi. Në të vërtetë, përgjigjet e theksuara më lart, vënë në pah se disa gjykatës nuk e kuptojnë thelbin e masave alternative, edhe pse thonë se ato mund ta arrijnë qëllimin e vet. Po qe se ndonjërin e vëmë në plehërishte që të pastrojë ose e quajmë kriminel që ne të tjerët e ushqejmë, ose ta uniformojmë në të gjelbër, e tërë kjo do të thoshte poshtërim, degradim të personalitetit, ngjallje të turpit dhe stigmatizim, veçim nga i ashtuquajti „mainstr5am“, përkatësisht nga pjesa e pranueshme e shoqërisë. E gjithë kjo është opozita e masave alternative dhe e paraqet atë kundër së cilës luftojnë masat alternative.

Më tutje, gjykatës të caktuar arsyen e mosshqiptimit e shohin në atë që në praktikë nuk janë paraqitur raste ku këto masa do të mund të zbatoheshin, përkatësisht nuk ka pasur nevojë që të shqiptohen. Kjo tregon ose mosnjohjen e rregullativës ligjore dhe dispozitave që flasin ku, kur dhe si mund të zbatohen masat alternative ose mosnjohjen e gjendjeve me sanksionet e shqiptuara, posaçërisht të atyre të krimit të lehtë dhe dënimeve me burg afatshkurtër, për të cilat folëm në kreun e më sipërm dhe efekteve nga zbatimi i tyre. Deklarata e tillë mund të paraqesë proteksionizëm të funksionit të gjykatësit dhe mbrojtje të “imazhit” të gjykatësve (përkatësisht, kjo nuk varet prej nesh por prej rrethanave, ata nuk janë adekuate për zbatimin e masave alternative!).

**3.2.2. Puna e gjithdoshme.** Përcaktimi ligjor i punës së gjithdoshme (në tekstin e mëtejshëm PGJD) determinon që kjo masë alternative mund të shqiptohet për persona që kanë bërë kundërvajtje për herë të parë<sup>134</sup>, për vepër të kryer penale, për të cilën mund të shqiptohet dënim me të holla ose dënim me burg deri në 3 vjet, me ç’ rast është posaçërisht i rëndësishëm personaliteti i kryerësit<sup>135</sup>.

**3.2.2.a. Personaliteti i kryerësit.** Siç u përmend më parë, kur është fjala për zbatimin e ndonjë mase alternative, posaçërisht për punën e gjithdoshme, një nga çështjet më të rëndësishme është personaliteti i kryerësit, përkatësisht përcaktimi i profilit dhe vlerësimi se a është e dobishme për këtë personalitet që t’i shqiptohet masë e këtillë, duke marrë parasysh edhe kushte tjera ligjore. Përkatësisht, nga vetë personaliteti, jeta e mëparshme, shprehitë, mundësitë, aftësitë psikofizike, kushtet sociale, familjare dhe materiale e ngjashëm, varet çfarë mase, çfarë obligimesh, ndalesash ose çfarë ndihme nevojitet të shqiptohet, që të mund të realizohen qëllimet e sanksionimit.

Burim themelor i informatave që i marrin gjykatësit gjatë formimit të profilit të personit, është evidenca ndëshkimore<sup>136</sup>. Në këtë mënyrë vërtetohet se a është dënuar ose jo më parë personi, sepse kjo është e nevojshme për kontrollimin e kushtit që personi të jetë kundërvajtës për herë të parë. Burim tjetër i përdorur më shpesh, është sjellja e personit para procedurës dhe gjatë procedurës, të cilën gjykatësi e saktëson drejtpërdrejtë gjatë

<sup>134</sup> Shih fusnotën nr. 32

<sup>135</sup> Termi kryerës është përdorur si fakt i gatshëm pasi që këta masa u shqiptohen kryerësve fajtorë të veprave penale, ku ekziston dhe pajtueshmëri për shqiptimin e tyre, pikërisht nga personi.

<sup>136</sup> Në të vërtetë, të dhënat nga evidenca ndëshkimore gjykatat i marrin nga Ministria e punëve të brendshme.

<sup>137</sup> Kjo, gjithashtu, është e diskutueshme, dhe nuk do të ndërhyjm në atë se çka supozon “sjellje gjatë procedurës”, meqë është fjala për gjendje të përditshme, e cila mund të çojë në sjellje jo të përditshme, por kjo është temë për ndonjë shqyrtim tjetër.



kohës së procedurës<sup>137</sup>. Disa gjykatës (edhe pse rrallëherë) shkojnë edhe më tutje, përkatësisht shfrytëzojnë edhe burime të tjera të të dhënash, për shembull nga punëdhënësit, nga endi i punësimi, shkollat, spitalet e ngjashëm. Disa gjykatës (21% të të anketuarve) marrin informata prej QPS. Megjithatë, numri më i madh thekson faktin se momentalisht informatat nga QPS mund të merren kur është fjala për të mitur, por jo, ose mjaft rrallë edhe për persona të rritur (përveç për rastet të lidhura me drogën dhe alkoolin). Në të njëjtën kohë disa nga të anketuarit theksuan edhe nevojën dhe domosdoshmërinë e marrjes së informatave nga QPS, por edhe nga institucione të tjera, shërbimet e të cilave nuk i shfrytëzojnë aspak. Më tutje, në vendet më të vogla ku gati të gjithë banorët njihen, gjykatësit mjaft lehtë vijnë të informatat edhe me një shëtitje të rëndomtë nëpër qytet ose në bisedë me banorët. Disa nga gjykatësit deklaruan se të dhënat për personalitetin e kryerësit duhet të sigurohen nga gjykatësi hetues.

Përveç vlerësimit se a është fjala për kundërvajtës për herë të parë, gjatë formimit të pasqyrës/profilin të kryerësit merren parasysh këto elemente: mosha, gjendja materiale, jeta familjare, motivet për kryerjen e veprës, mënyra e kryerjes së veprës, sjellja nga kryerja e veprës deri në momentin e vendosjes, prirja për kryerjen e veprave penale, pendimi për shkak të kryerjes së veprës, sa fuqishëm e prek vepra të cilën e ka bërë, a ekziston pranim ose jo, kryerësi a ka tentuar t'i mënjanojë pasojat, a ka kërkuar falje e të ngjashme. Në një rast, si element plotësues të cilin gjykatësi do ta kishte marrë parasysh është ai se në atë moment a zhvillohet procedurë tjetër për të njëjtin person. Pyetja lidhur me këtë është se çka do të thotë kjo për gjykatësin gjykues, se nëse mbahet procedurë tjetër, a do të ishte kjo rrethanë vështirësuese? Nëse është rrethanë vështirësuese, padyshim kjo atëherë paraqet cenim të prezumpcionit të pafajësisë dhe i një varg dispozitash të vendit dhe ndërkombëtare.

Në një rast tjetër u deklarua se nuk ekziston analizë profesionale gjatë “profilizimit” të personit, por “aty për aty” formohet pasqyra për të njëjtin person. Kjo brengos veçmas sepse në këtë mënyrë “aty për aty” vendoset për fatin e dikujt, “aty për aty” krijohet praktika gjyqësore, “Aty për aty” bëhen reforma në gjyqësi<sup>138</sup>! Pikërisht në kontekst të qëndrimit se “profilizimi” i personave nuk është standardizuar, një gjykatës tjetër në njërin nga përgjigjet në një pyetje krejtësisht tjetër përmend se ndoshta nevojitet të formohet ekip profesional në kuadër të gjykatës, i cili do të obligohet për përgatitjen e analizës për profilin e personit ose, madje gjykatësit të trajnohen për këtë.

Padyshim, lëshime ka veçanërisht nëse merret parasysh fakti se vlerësimin për profilin e kryerësve nuk e bëjnë persona profesionale (psikologë, pedagogë, sociologë), por juristë/gjykatës të cilët kohë pas kohe kërkojnë të dhëna prej institucioneve tjera për kategori të caktuar personash, që në praktikën e deritashme lidhen vetëm me kushtet ligjore dhe me elementet për vlerësimin e personave.

Sa i përket moshës së kryerësit, më saktë kur është fjala për të mitur, gjykatësit ishin mjaft të kujdesshëm. Në pyetjen se PGJD a duhet tu shqiptohet edhe të miturve, ekzistonte një pasiguri dhe rezervim më i madh. Është e qartë se praktika dhe puna ekzistuese me të miturit sollin në atë që gjykatësit për këtë pyetje të mendojnë posaçërisht, para se të japin përgjigje. Nga përgjigjet vërehet se PGJD gati të gjithë gjykatësit do t'u shqiptonin të miturve, prej të cilëve gjysma, në mënyrë eksplicite përmendin se është fjala për të mitur me moshë

<sup>138</sup> Qëndrimin e këtillë do ta marrim si rast të izoluar, i cili nuk guxon të anashkalohej, ngase është faktorë vendimtar për gjendjet me masat alternative në rajonin përkatës, ku ky gjykatës do të sanksionojë, e ku kryerës potencialë janë të gjithë banorët e rajonit, përkatësisht bashkëqytetarët e tij.

më të madhe (me 16 vjet të mbushur, por më të rinj se 18 vjeç). Megjithatë, në të njëjtën kohë vunë në dukje nevojën e kujdesit të posaçëm gjatë zgjedhjes së punës, rrethit në të cilin do të punojë dhe ndikimit që e njëjta do ta ketë te i mituri.

**3.2.2.b. Viktima dhe roli i saj.** Sipas përgjigjeve të dhëna në pyetjen se a ka viktima e veprës së kryer penale ndonjë rol në procesin e marrjes së vendimit për masë alternative, marrë në përgjithësi del se viktima nuk ka ndonjë rol të veçantë. Përveç praktikës tashmë të vendosur lidhur me atë se a do ta ndjekë ose jo kryerësin e veprës penale, se a janë pajtuar dhe se a kërkon kompensimin e dëmit, nuk ekziston ndonjë qëndrim tjetër te gjykatësit, sa i përket viktimës. Shkalla e këtyre e kujdesit që i kushtojnë viktimës gjykatësit dhe deklaratat e llojit “viktima ka të drejtë, por jo me rëndësi të posaçme”, “gjykatësi në asnjë rast nuk e merr parasysh mendimin e viktimës sa i përket asaj se a do të shqiptojë ose jo masë alternative, “viktima nuk ka ndikim”, të cilat janë përfaqësuar te 20% të të anketuarve, vë në dukje rolin e parëndësishëm që e ka viktima në procedurën.

Gjykatësit duhet të kenë njohuri më të mëdha për pozitën e viktimës veçanërisht nga aspekti i standardeve ndërkombëtare të miratuara ose të proklamuar dhe duhet t'i kushtojnë vëmendje më të madhe sa i përket interesave të saj dhe të sigurojnë mbrojtje adekuate, kujdes dhe ndihmë.

**3.2.2.c. Organizatat ku do të kryhet PGJD.** Numri i caktuar i orëve të punës pa pagesë në dobi të bashkësisë, që do ta bëjë kryerësi, do të jetë nëpër ndërmarrje publike, institucione, shoqata joqeveritare e të ngjashme (në tekstin e mëtejme: organizata). Ligji për zbatimin e sanksioneve (neni 234) përcakton vetëm se kush do të lidh kontratat me organizatat për kryerjen e PGJD, por jo edhe cili organ është kompetent për identifikimin e tyre.

Sipas përgjigjeve të gjykatësve, momentalisht nuk ekzistojnë organizata ku do të kryhej veprimi i tillë, përkatësisht se ku ata do të mund t'i dërgonin personat të cilëve do t'ua shqiptonin masën e tillë. Në këtë kontekst gjykatësit dhanë përgjigje shumë të ndryshme për atë se në kompetencë të kujt do të ishte obligimi për identifikimin e organizatave të tilla. Kështu përgjigjet përmendin Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë publike, Ministrinë e punëve të brendshme, gjykatat, vetadministrimin lokal, qendrat për punë sociale. Në disa raste edhe kombinim, përkatësisht më shumë organe në bashkëpunim do të ishin kompetentë për këtë<sup>139</sup>. Gjithashtu, vihet në pah fakti se, në mjedise të caktuara, nuk ekzistojnë ndërmarrje publike (përveç ndërmarrjes komunale), që mund të shkaktojnë vështirësi në realizimin e punës së gjithdoshme po që se nuk gjenden zgjidhje alternative edhe në këtë drejtim.

Pikërisht në këtë kontekst, vlen të përmendet se gjykatësi i cili ka shqiptuar punën e gjithdoshme, në aktgjykim nuk ka definuar se sa orë dhe ku (në cilën organizatë) do të realizohet masa alternative. Edhe pse mbeten pezull në ajër disa pyetje sa i përket përshtatshmërisë së aktgjykimit për zbatimin dhe mënyrën e zbatimit të masës, megjithatë është për tu përsëritur guximi dhe iniciativa e gjykatësit. Kjo aq më tepër, duke pasur parasysh se edhe vetë gjykatësit përmendën disa herë se “megjithatë dëshirojnë që të kryejnë punë të sigurt dhe të kontrolluar” dhe aspak nuk ia nisin që t'i shfrytëzojnë risitë e ligjit.

<sup>139</sup> Lidhur me këtë, disa gjykatës e ofruan edhe këtë: Vetadministrimi lokal do të identifikojë institucione të tilla (Shoqata të personave me nevoja të veçanta, NP Komunale e të ngjashme); Ministria e drejtësisë me Ministrinë e bujqësisë, Ministrinë e shëndetësisë do të duhet t'i identifikojnë institucionet e tilla e të ngjashme.

**3.2.2.ç. Revokimi i PGJD.** Në rastet kur personi, të cilit i është shqiptuar PGJD, nuk kryen detyrat e punës ashtu si duhet, refuzon t'i kryejë ose ngjashëm, mund të ndonjë revokimi i PGJD dhe zëvendësimi i masës alternative me dënim. Lidhur me gjendjen e këtyllë, përkatësisht cilat rrethana merren parasysh që të mundet gjykatësi të vendosë për revokim të masës, gjykatësit nuk dhanë përgjigje, por dhanë përgjigje tejet të ndryshme lidhur me atë se çfarë shkakton mospërbushjen e obligimeve. Të shumtat e përgjigjeve ishin se gjatë mospërbushjes së obligimeve menjëherë pason zëvendësimi dhe shqiptimi i dënimit me burg (53% të përgjigjeve). Në raste të caktuara arsyetimi është se prandaj edhe ekziston kanosja (përkatësisht dënimi me burg)- mospërbushja e obligimit çon në shqiptimin e dënimit me burg. Prapëseprapë, gëzon fakti që në numër jo i vogël i gjykatësve kishin mirëkuptim më të madh për atë që duhet të arrihet me këtë masë, kështu që disa do të provonin ta zëvendësonin me masë tjetër ose do t'i peshonin arsyet e mospërbushjes, do ta merrnin parasysh, para së gjithash analizën e qendrave, do të jepnin afat plotësues e të ngjashme.<sup>140</sup>

**3.2.2.d. Roli i bashkësisë në zbatimin e PGJD.** Sa i përket rolit të bashkësisë<sup>141</sup> në zbatimin e PGJD, gjykatësit në masë të madhe ishin të rezervuar, ndonëse dëshironin që bashkësia të ketë një rol më aktiv dhe pozitiv. Rezervimi kryesisht del nga mosekzistimi i praktikës në këtë fushë, por edhe për shkak të mosbashkëpunimit të deritashëm dhe pasivitetit të bashkësisë lokale si dhe mentalitetit të qytetarëve. Dëshirat ose ajo që do të donin ta shohin gjykatësit, është bashkësia aktive, e cila do t'u ofrojë përkrahje personave, do të jetë e vetëdijshme për dobinë që do ta kenë si personi, i cili e zbaton masën, ashtu edhe vetë bashkësia. Gjatë analizës së përgjigjeve, hetohet edhe mosbesim te disa të anketuar se bashkësia do të pranojë persona të tillë. Kështu, veçuan disa përgjigje që vijojnë: “bashkësia është indiferente lidhur me punën e gjykatës”, “do të sillen si ndaj personave të kategorisë së dytë”, “nëse mbledh letra në stacion të autobusëve kjo do të ketë efekt të risocializimit, përkatësisht, do të ketë turp”, “ne kemi nivel të ulët të ndërgjegjes”, “mentaliteti i popullatës nuk është i tillë që t'i pranojë”, e të ngjashme. .

Zgjidhja e turpit si mënyrë që të parandalohet kryerja e ardhme e veprave penale ose ose si mënyrë që të dënohet personi është asociacioni i cili shpesh herë përjetohet si arsyetim i masës. Në këtë kontekst atëherë PGJD (por edhe masat e tjera alternative) nuk do të paraqiste masë por dënim me element tejet retributiv. Sa i përket turpit që do të shkaktohet te personi, vlen të theksohet se pikërisht e kundërta është intencja e masave alternative. Në të vërtetë, tentohet që të mbrohet dinjiteti njerëzorë jo e kundërta. Tentohet të evitohet e jo të forcohet stigma. Tentohet që të mos nënçmohet, por përkundrazi, të zhvillohen, ose thënë më mirë, të zgjohen cilësitë te njeriu, e jo i njëjti të vihet në përbuzje ose në tallje dhe të mbetet përsëri në margjinat e shoqërisë

Duhet konstatuar patjetër se indiferenca e bashkësisë ndaj punës së gjykatës, nuk do të thotë se edhe gjykata, nga ana e vet, dëshiron të bashkëpunojë në këtë drejtim. Shtrihet pyetja: Kur gjykata ka iniciuar ndonjë aksion të caktuar për aktivitetin e bashkëpunimit me bashkësinë?, ose: Kur gjykata e ka informuar bashkësinë ose komunën për punën e vet, për aktivitetet që dëshiron t'i realizojë, për politikën ndëshkimore ose për sanksionet e shqiptuara për vepra përkatëse penale në një komunë të caktuar? Kjo nuk do të thotë se përgjegjësia i hidhet gjykatës por megjithatë, do të thotë se pasiviteti nuk është e njëanshme, përkatësisht vetiniciativa nuk ekziston edhe në të dyja palët.

<sup>140</sup> Po qe se qëllimi i shqiptimit të masave alternative është që t'i iket burgosjes, nuk ka arsyetim nëse cenimi i kushteve ose obligimeve automatikisht shpie kah shqiptimi i dënimit me burg. Gordana Buzharovska, Alternativa të burgut, faqe 235.

<sup>141</sup> Kur flitet për bashkësi, mendohet si për komunën, ashtu edhe për banorët e asaj komune, sepse personi do ta kryejë masën alternative, sipas vendit ku jeton.

**3.2.3. Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.** Dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse mund të shqiptohet në rastin kur është fjala për vepër të kryer penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej 2 vjet ose dënim me të holla. Njëherësh, gjykatësi cakton kohë kontrollimi në të cilën organi i specializuar do të kujdeset, do të japë ndihmë dhe do të mbikëqyrë sjelljen e personit, se a i ka përmbushur obligimet që ia ka imponuar gjykata, që do të thotë se elementet themelore të kësaj mase janë mbikëqyrja mbrojtëse dhe obligimet që i janë imponuar kryerësit<sup>142</sup>.

**3.2.3.a.** Kur është fjala për dënimin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, mbikëqyrja është ajo që i intereson gjykatësit. Në të vërtetë, shqiptimi i dënimeve me kusht nuk është edhe aq problematike sepse ekziston praktikë, por te kjo masë alternative, mungesa e mbikëqyrjes mbrojtëse është arsyeja e mosshqiptimit.

Një problem është mosekzistimi i mbikëqyrjes mbrojtëse, por problemi tjetër ka të bëjë me organin kompetent për mbikëqyrje mbrojtëse. Për afro gjysmën e gjykatësve (40% të të anketuarve) ato janë qendrat, të cilat për punën e vet, përkatësisht për mbikëqyrjen që do ta bënin, duhet ta informojnë gjykatën. Për të tjerët kjo është vetë gjykata, me ç' rast shtrohet pyetja kush është drejtpërdrejtë kompetent në gjykatë, a është ai vallë, gjykatësi për zbatimin e sanksioneve ose gjykatësi i cili e shqipton masën? Më tutje, sipas disa prej përgjigjeve, organ kompetent mbikëqyrës janë inspektorët në Drejtorinë për zbatimin e sanksioneve të cilët e njoftojnë gjykatën për punën e vet; për disa ky është seksioni ekzekutiv i gjykatës i cili e informon Ministrinë e drejtësisë, bile edhe Gjykatën Supreme dhe Këshillin gjyqësor republikan; për disa ky është, për shembull, institucioni ku është shëruar personi ose kanë qenë nën terapi (nëse masa ka qenë e tillë); për disa është vetadministrimi lokal; e disa gjykatës nuk dinin se kush është organi kompetent.

Në këtë det të organeve kompetente vërehet (mos)njohja e esencës së kësaj mase alternative, e cila teorikisht nuk është risi në legjislacionin tonë, megjithatë praktikisht është e panjohur.

**3.2.3.b.** Gjatë shqiptimit të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, gjykata imponon obligime të caktuara të cilat personi duhet t'i kryejë në një periudhë të caktuar. Pikërisht këtu shihet edhe thelbi i mbikëqyrjes mbrojtëse.

Gjykatësit, nëmashtë madhe, i përfshinë/identifikuan elementet e mbikëqyrjes mbrojtëse dhe sipas kësaj obligimet që i imponohen personit janë: mosqëndrimi në lokale të caktuara, ndalimi i shoqërimit me persona të caktuar, pranimi i punësimit, mbajtja e familjes, ndalimi i konsumimit të alkoolit, pagesa e mirëmbajtjes etj. Sa i përket organit i cili është kompetent për caktimin e masave, gjykatësit i zgjedhën ose gjykatën ose qendrat, që parimisht nuk e ndryshon përmbajtjen e asaj që është caktuar me ligj. Obligimet e theksuara njëherësh janë edhe drejtimit e përgjithshme që i parashihet ligji, kreativiteti i gjykatësit shihet pikërisht në mundësitë që përmes drejtimeve të përgjithshme mund të zhvillohen, e që do të jetë një përparim tejet i madh në individualizimin e dënimit. Përgjigjet e këtilla e nxjerrin pasqyrën e përgjithshme që ekziston edhe për gjykatësit në këtë fushë, e ajo është lidhshmëria përpiktë e gjykatësit me ligjin. Intenca e këtij përfundimi nuk është që të bëjë një orientim drejt daljes nga suazat ligjore, por për interpretimin e tij thelbësor dhe për zbatimin, duke marrë parasysh se për persona të ndryshëm nuk është e mundshme që ligji t'i parashohë të gjitha zgjidhjet e mundshme (mjetet), por duhet në mënyrë individuale të bëhet matja dhe kombinimi i tyre<sup>143</sup>.

<sup>142</sup> Sa i përket profilin të personit, shih më lartë, kreu 2, p. 2.2.5. Puna e gjithëdobishme.

<sup>143</sup> <http://www.cnn.com/2004/LAW/01/24/cnna.standley/index.html> "Yoga sentence judge: Each case is different".

**3.2.4. Informimi i bashkësisë.** Duke pasur parasysh faktin që sipas ligjit, personi të cilit do t'i shqiptohet masa alternative, të njëjtën do ta realizojë në vendbanimin e tij/saj, në liri, roli i bashkësisë është tejet i rëndësishëm. Informimi dhe njoftimi i opinionit me qëllimet e masave alternative dhe me mënyrat e zbatimit të tyre është diçka rreth të cilave janë pajtuar të gjithë gjykatësit se është i domosdoshëm, veçanërisht për shkak të mendimit, sipas të cilit, mentaliteti i popullatës lë rezerva se implementimi do të mund të zhvillohet pa probleme, të paktën nga ai aspekt, me një përfundim sipas të cilit mjafton nxjerra dhe shpallja e ligjit që të llogaritet se qytetarët janë të informuar. Ndonëse është risi, opinioni doemos të jetë i informuar që të mund të realizohet qëllimi i masave. Që theksuar se ndoshta që në fillim nuk do të mund të pranohen menjëherë, prapëseprapë shqiptimi i tyre i shpeshtë me kalimin e kohës, do ta bëjë të pranueshme te opinionit. Mënyrat më të shpeshta të informimit të opinionit janë ato klasike: mediumet e të gjitha llojeve, edhe të shtypura edhe elektronike, nëpërmjet emisioneve debative, tribunave, me pjesëmarrjen e aktorëve relevantë. Lidhur me atë se cilat organe duhet ta bëjnë informimin, për një numër të madh gjykatësish ato janë të gjitha organet tjera (përveç gjykatësve) e këtu i përfshinë: QPS, vetadministrimin lokal, institucionet tjera e para së gjithash shoqatat e qytetarëve.

## K O N K L U Z I O N E

Nga praktika e deritashme e gjykatësve të gjykatave themelore në Republikën e Maqedonisë, mund të përfundohet se përveç dënimit me kusht dhe vërejtjes gjyqësore, masat tjera alternative nuk praktikohen. Ndonëse nga ky qëndrim i përgjithshëm bëjnë përjashtim të dyja masat e shqiptuara për punë të gjithëdobishme, njëra –dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse dhe tjetra – ndërprerje e kushtëzuar e procedurës penale, megjithatë kjo mund mjafton që të mund të thuhet se ekziston praktikë e shqiptimit të masave. Shkaqe themelore se pse gjykatësit nuk i aplikojnë masat alternative, që njëherësh janë edhe mangësi të cilat tanimë një kohë të gjatë janë të pranishme dhe qëndrojnë në praktikë, janë:

- ❖ Mungesa e rregullativës nënligjore plotësuese, përveç asaj ekzistuese të paraparë në Kodin penal dhe në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, e cila megjithatë është e plotë, ka shumë kundërthënie dhe nuk jep pasqyrë të hollësishme për implementimin e masave alternative.
- ❖ Mosinformimi i plotë i gjykatësve për ekzistimin e iniciativave të qeverisë për implementimin e masave alternative, ose edhe të organeve të tjera në drejtim të pikërisht kësaj materie;
- ❖ Mosekzistimi i strukturës organizative dedikuar në mënyrë specifike për zhvillimin e masave alternative në kuadër të organeve implementuese;
- ❖ Mosekzistimi i mekanizmave mbikëqyrëse, institucione të pidentifikuara, organizata e të ngjashme;
- ❖ Roli i padefinuar i gjykatësit për kryerjen e sanksioneve, si pjesë e atij organizmi për zbatimin e masave alternative; nuk ekziston sistem standard në të gjitha gjykatat themelore lidhur me diferencimin dhe organizimin e funksionit unik dhe të pavarur të këtij gjykatësi, që do të sillte përkushtim në këtë punë;
- ❖ Mosekzistimi i mekanizmit për informim ndërmjet organeve që do ta zbatojnë mbikëqyrjen dhe gjykatësit që e ka shqiptuar masën, përkatësisht, mosekzistimi i mekanizmit se kush kujt do t'i përgjigjet për punën e kryer;

- ❖ Niveli i pakënaqshëm, e diku edhe joekzistues i bashkëpunimit ndërmjet gjykatës dhe organeve tjera implementuese të masave alternative (nivel i pakënaqshëm i bashkëpunimit ndërmjet gjykatës dhe qendrave për punë sociale; mungesë e plotë e komunikimit ndërmjet gjykatës dhe vetadministrimit lokal dhe komunikim ose koordinim jo i kënaqshëm ndërmjet gjykatësit gjykues, gjykatësit për zbatimin e sanksioneve dhe Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve);
- ❖ Mungesa e mjeteve financiare mbi mbulimin e shpenzimeve që do nevojiteshin për zbatimin e tyre;
- ❖ Njohja jo e mjaftueshme e përmbajtjes, rëndësisë, qëllimeve të masave alternative. Gjykatësit kanë njohuri të përgjithshme për masat alternative të cilat kryesisht dalin nga teksti ligjor. Në këtë kontekst mund të thuhet lirisht se njohuritë themelore, mungesa e informatave për tendencat zhvillimore të kësaj materie, qëllimet, mënyrat (modalitet) e realizimit, nuk janë përfaqësuar as teorikisht në suazat e njohurive të gjykatësit. Nënkuptohe me përjashtime të vogla që i paraqitën gjatë realizimit të intervistës;
- ❖ Roli pasiv i prokurorëve themelorë publikë në procesin e propozimit të masave.

Përveç mangësive që kanë të bëjnë me definimin organizativ dhe struktural të sistemit ose politikave për masat alternative, këto mënyra të sanksionimit kërkojnë një raport më ndryshe si ndaj të akuzuarit ashtu edhe ndaj viktimës nga vepra penale. Meqë zbatimi i këtyre masave kërkon një përcaktim më të qartë të personalitetit të kryerësit që të mund të vlerësohet se a është e dobishme për profilin e tillë të personit të shqiptohen masa alternative ose dënim ose është e nevojshme të shqiptohet ndonjë masë tjetër alternative, gjykatat nuk i shfrytëzojnë shërbimet tjera, institucionet ose entet si burim të dhënash për formimin e profilin të kryerësit. Pikërisht në këtë relacion është fakti që gjykatat, përpos në rastet kur është fjala për kundërvajtje të të miturve, shumë familjare, rastet lidhur me drogën dhe alkoolin, për kryerësit tjerë të rritur të veprave penale nuk e shfrytëzojnë ekspertizën e ekipeve profesionale nga qendrat për punë sociale. Për këtë arsye, për vlerësimin e profilin psikologjik të personit në praktikë të ne vendos gjykatësi, me ç' rast nuk ekzistojnë procedura standarde, mekanizma dhe metoda adekuate për përcaktimin e profilin të personave.

Gjithashtu, me rëndësi të veçantë në zbatimin e masave alternative është roli i viktimës, me ç' rast mund të thuhet përgjithësisht, se gjykatësit e marrin parasysh viktimën në rolin e saj bazik gjatë formimit të pasqyrës për zbatimin ose moszbatimin e masave alternative të një kryerësi i caktuar. Nënkuptohe, praktika e këtyre e plotëson rolin formal procesual të viktimës në kontestin, por kjo është larg asaj se si duhet të jetë roli i viktimës që të themi se elementet e drejtësisë restorative vërtet gjejnë zbatim në praktikën e gjykatave.

Mangësi shtesë në zbatimin e punës së gjithdobishme është ajo që momentalisht nuk janë identifikuar institucionet, agjencitë, organizatat humanitare ose organizatat joqeveritare ku do të mund të zhvillohej puna e gjithdobishme. Gjithashtu edhe ligji nuk e përmend organin i cili është kompetent për identifikimin e tyre Përveç mosekzistimit të institucioneve për zbatimin e masës punë e gjithdobishme si kusht për praktikumin e saj, në të shumtën e rasteve gjykatësit do ta zëvendësonin menjëherë punën e gjithdobishme me dënimin me burg, për shembull, nëse personi nuk i kryen detyrat e punës. Kjo nxjerr në pah leximin rigoroz dhe jo fleksibil të ligjit, e së këndejmi edhe veprimin jofleksibil të gjykatësve qysh para aplikimit të masave. Në të vërtetë, pikërisht qëllimi i kësaj mase është t'i iket burgimit, kurse kreativiteti dhe fleksibiliteti i gjykatësit do të vinte në shprehje mu në gjetjen e mënyrave se si personi të korrigjohet, e të mos zbatohet burgu. Me këtë ndërlihet edhe pyetja për obligimet të cilat gjykata ia cakton personit gjatë shqiptimit të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Përkatesisht, gjykatësish në përgjithësi i marrin parasysh elementet e parapara

me ligj pa çfarëdo iniciativash dhe kreative dhe eksperimentale, të cilat, prapëseprapë do të ishin në suazat e ligjit. Kjo vjen nga fakti se nuk janë të njëjtë të gjithë kryerësit e veprave penale dhe nuk do të jetë e mundshme që të gjitha obligimet e përcaktuara me ligj, tu përgjigjen të gjitha profileve të ndryshme të kryerësve.

### 3.3. ANALIZË PYETËSORËVE DEDIKUAR QENDRAVE PËR PUNË SOCIALE

Organet bartëse për aplikimin përkatësisht zbatimin e masave alternative dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, punë të gjithdoshme, dhe burg shtëpiak janë qendrat për punë sociale. Më konkretisht, kompetente janë qendrat në vendin e banimit të personit (të dënuarit) të cilit i është shqiptuar ndonjëra prej masave alternative.<sup>144</sup>

Prej gjithsej 30 qendrave për punë sociale, u realizuan 26 intervista, 13 prej të cilave u bënë me drejtorët e qendrave dhe 13 të anketuar ishin përfaqësues të ekipeve profesionale (punëtorë socialë, psikologë dhe juristë) Intervistat u realizuan me përfaqësues të qendrave në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Krushevë, Manastir, Prilep, Resnjë, Ohër Kumanovë, Kriva Pallankë, Probishtip, Sveti Nikole, Vinivë, Veles, Shtip, Kratovë, Koçan, Berovë, Dellçevë, Radovish, Negotinë, KavADAR, Gjevgjeli, Vallandovë dhe Shkup.

**3.3.1. Kushtet dhe mangësitë.** Përfaqësuesit e qendrave, përgjithësisht, ishin të vetëdijshëm për mangësitë e shumta të cilat realisht ekzistojnë, për ç' arsye masat alternative nuk sendërtohen në praktikë. Në mesin e shkaqeve të mosuksesit të gjertanishëm në zbatimin e këtyre masave, disa të anketuar përmendën pakënaqësinë që ekziston lidhur me statusin dhe autoritetin e rolit të punëtorit social (është interesante që deklarata ka të bëjë lidhur me pamundësinë që në disa raste, punëtori social të hyjë në shtëpi dhe t'i realizojë aktivitetet, për çka, në të vërtetë ka ingerenca ose mosveprimin e gjykatave, sipas mendimit të qendrave, përkatësisht veprimin e kundërt me mendimin e tyre, dhe së këndejmi, sipas tyre, roli që e kanë është vetëm një formalitet i zhveshur).

Sipas përgjigjeve të të anketuarve, përgjithësisht, mangësitë mund të karakterizohen në disa nivele: në nivel të mungesës së rregullativës për caktimin më të hollësishëm të mënyrave të zbatimit, mekanizmave të bashkëpunimit, në nivel të paaftësisë organizative që qendrat të përballen me obligimet vijuese dhe me vështirësitë në vendosjen organizative të një sistemi për realizimin e masave, rrjedhimisht kësaj, u vunë në pah kapacitetet e dobëta, përkatësisht kapacitetet e mjaftueshme institucionale, resurset njerëzore dhe financat, pakënaqësia nga bashkëpunimi me institucionet tjera dhe nevoja e përmirësimit të tij, si dhe shpërndarjen joadekuate të informatave, mosinformimin e qendrave pikërisht sa u përket masave alternative.

**3.3.1.a. Rregullativa.** Sipas KP dhe LZS, sfera e zbatimit të masave alternative është rregulluar parimisht. Megjithatë, është e domosdoshme rregullativa nënligjore, për saktësimin, ripërpunimin dhe definimin e kompetencave, obligimeve, aktiviteteve koordinuese e të ngjashme., si në vetë qendrat ashtu edhe me organet tjera relevante. Mu për domosdoshmërinë e rregullativës, të anketuarit në një përqindje tejte të lartë (88%) deklaruan se nuk ekzistojnë akte (ose të anketuarit nuk janë informuar për këtë, të nevojshme për realizimin praktik të masave. Vetëm në 3 raste të anketuarit deklaruan se ekziston Udhëzim prej nëntorit të vitit 2004, me të cilin janë përfshirë masat alternative (dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse,

<sup>144</sup> Për vendosjen organizative dhe kompetencat e Qendrave për veprimtari sociale, të përcaktuara me ligjet ekzistuese, shih kreun 2, p.2.3.2. Qendrat për punë sociale..

puna e gjithëdobishme dhe burgu shtëpiak) dhe se ekzistojnë Instruksione/Rekomandime/Rregullore<sup>145</sup> të dërguar nga Enti për punë sociale në vitin 2005/2006.

Lidhur me të theksuarën më lartë, të anketuarit shtuan se nuk kanë qenë të informuar as për atë se a përgatitet ose ekziston në nivel të qeverisë ndonjë strategji ose iniciativë për vendosjen e mekanizmave për implementimin e masave alternative. Më saktësisht, vetëm 26% të të anketuarve pohuan se ekzistojnë disa aktivitete në nivel më të lartë, që u pasqyrua në të dy seminarët/takimet e mbajtura në këtë temë.

**3.3.1.b. Organizimi.** Sa i përket vendosjes organizative të qendrave, me ligj është paraparë formimi një seksioni të veçantë në kuadër të qendrave, që do të jetë kompetent për zbatimin e masave alternative. Mënyerisht asnjë qendër nuk ka formuar seksion të veçantë për këtë qëllim. Sipas përgjigjeve të të anketuarve të gjithë e dinë parimisht se seksioni i tillë duhet të formohet. Por, vërejtjet e theksuara pikërisht në këtë drejtim, kishin të bëjnë me (pa)mundësitë reale që i kanë qendrat. Përkatësisht, përgjigjet ishin të ndara në drejtim të formimit të seksioneve të veçanta (në qendrat më të mëdha) për çka ishin përgjigjur vetëm 7% të të anketuarve, dhe të formimit të ekipit profesional (në qendrat më të vogla), siç u përgjigjën 68% të të anketuarve. Numri optimal i anëtarëve të ekipit profesional ose seksionit të veçantë, do të përbëhet nga struktura standarde e të punësuarve nëpër qendra. Ekipi profesional do të numëronte 4-5 anëtarë dhe do të përbëhet nga punëtori social, juristi, pedagogu dhe psikologu. Në qendra të caktuara (19%) nuk do të jetë i mundshëm formimi i seksionit të veçantë e as i ekipit të veçantë, por do të emëroheshin një ose dy persona të cilët do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtyre masave..

**3.3.1.c. Kapacitetet.** Arsyet kryesore për gjendjen e këtyre, përkatësisht pamundësinë që të formohet seksion i veçantë, i specializuar për zbatimin e masave alternative, qëndrojnë përgjithësisht në kushtet e pavolitshme të punës së qendrave, mungesën e kuadrit të mjaftueshëm profesional dhe adekuat. Për disa të anketuar numri i pamjaftueshëm i kuadrit profesional është rezultat i rritjes së numrit të personelit administrativ-teknik, mosekzistimit të disa prej degëve themelore disa qendra, si për shembull, psikolog ose pedagog, mosekzistimit të kuadrit adekuat të stërvitur për masat alternative, ngarkesës së tepërt të ekipeve ekzistuese të cilat punojnë në të gjitha lëmenjtë e mbrojtjes sociale, inkuadrimit të ekipit profesional në punën administrative, mungesës së lokaleve përkatëse të punës etj.

Sipas gjendjes momentale në të cilën gjenden qendrat, posaçërisht sa i përket ekzistimit të kapaciteteve institucionale, resurseve njerëzore, mjeteve materiale, përfundimi i përgjithshëm nga përgjigjet e dhëna, është se ekziston një dozë e madhe pesimizmi se vendosja e këtyre përkon me aktivitetet që i ndërmarrin. Asnjë i anketuar nuk jep vlerësim pozitiv për gjendjen në të cilën janë qendrat të cilat i përfaqësojnë. Si elemente të përbashkëta lidhur me mangësitë dhe nevojat që ekzistojnë, ishin theksuar këta që vijojnë:

- \* Kuadri i pamjaftueshëm profesional dhe nevoja e riekipimit përkatës profesional;
- \* Inkuadrimi i anëtarëve të jashtëm në ekipet profesionale;
- \* Vendosje jo adekuate organizative dhe nevoja e reformave në nivelin organizativ;

<sup>145</sup> Terminologjia e ndryshme me siguri ka të bëjë me një dokument të njëjtë- "Doracak për realizimin e zbatimit të masave alternative në qendrat për punë sociale në RM, në pajtim me ndryshimet aktuale në dispozitat penale-juridike", shkurt 2006, që Enti për veprimtari sociale ua ka shpërndarë drejtorëve të qendrave.



- \* Plotësimi financiar i buxheteve (të cilat në vitin 2006 kanë qenë të zvogëluara për 30-40% në krahasim me vitin paraprak) veçanërisht për mjetet themelore si, automjete terreni kompjuterë dhe për afarizmin material por edhe për stimulimin/motivimin financiar të të punësuarve;
- \* Nevoja e përgatitjes së planeve dhe programeve detale financiare.

Megjithatë, përkundër mungesave materiale/financiarerreth 60% të të anketuarve brengosjen më të madhe e shfaqën rreth nevojës së kuadrit plotësues profesional, me çka do tu lehtësohej puna dhe do të orientoheshin kah puna profesionale, që është edhe funksioni i tyre themelor.

**3.3.1.ç. Bashkëpunimi.** Duke marrë parasysh faktin se masa alternative puna e gjithëdobishme dhe dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse deri më tani nuk janë shqiptuar është normal konkludimi se nuk ekziston bashkëpunim ndërmjet organeve, në këtë nivel. Megjithatë, nga përgjigjet e përfaqësuesve të qendrave, mund të vërehet shkalla e bashkëpunimit themelor të qendrave me organet tjera, si dhe pakënaqësia te ata të intervistuar, nga ai bashkëpunim i cili tanimë ekziston ndërmjet disa prej tyre. Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin e qendrave me organet tjera, përgjigjet, kryesisht, përputhen.

Kështu, sa i përket bashkëpunimit me gjykatësin për zbatimin e sanksioneve, përfaqësuesit e qendrave, në 61% u deklaruan se ai nuk ekziston, kurse vetëm 7% u përgjigjën se bashkëpunimi ekziston<sup>146</sup>. Një pjesë e të intervistuarve të cilët deklaruan se nuk ka bashkëpunim me gjykatësin për zbatimin e sanksioneve, theksuan se i njëjti mungon për arsye se deri më tash nuk janë shqiptuar masa alternative. Të intervistuarit tjerë nuk iu përgjigjën pyetjes.

Ndërkaq, përqindja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve dhe qendrave, është zero<sup>147</sup>, përkatësisht asnjë i intervistuar nuk u përgjigj se ekziston bashkëpunim. Vetëm në një përgjigje ishte precizuar se komunikimi do të thoshte marrëdhënie me burgjet kur është fjala për personat të cilët lëshohen nga burgju, atëherë Qendra marrin njoftim për këtë, por prej burgjeve e jo prej Drejtorisë.

Për dallim nga të mëparshmet, bashkëpunimi ndërmjet qendrave dhe gjykatësve gjykues në të gjitha rastet ekziston, por më së shpeshti rreth punës me të miturit, për çështje familjare e të ngjashme., por edhe për persona të rritur. Në një rast ishte përmendur se roli i qendrave duhet të ekzistojë që në vetë fillimin, para se gjykatësi ta shqiptojë masën, e jo vetëm në procesin e zbatimit të masës së shqiptuar. Megjithatë, në 15% të përgjigjeve vërehej pakënaqësia nga bashkëpunimi me gjykatësit gjykues. Pakënaqësia e tillë manifestohej me kritikën se gjykatës të caktuar nuk i pranojnë mendimet që ua dërgojnë qendrat dhe vendosin në kundërshtim me mendimin e tyre.

Një nivel i caktuar i bashkëpunimit mund të thuhet se ekziston ndërmjet qendrave dhe bashkësisë lokale/komunës. Në të vërtetë bashkëpunimi ekziston për disa çështje, siç janë për shembull, angazhimi në punë i personave që pranojnë ndihmë sociale. Lidhur me këtë çështje, bashkëpunimi ekziston dhe ai është në nivel të kënaqshëm, por për çështje të tjera, deri më tash. Nuk kanë pasur bashkëpunim. Në një përgjigje që theksuar se

<sup>146</sup> Në disa prej këtyre përgjigjeve mund të kuptohet se i anketuari mendon për gjykatësin gjykues e jo për gjykatësin për zbatimin e sanksioneve.

<sup>147</sup> Në disa prej këtyre përgjigjeve theksohet se nuk ka bashkëpunim edhe pse duhet të ketë.

bashkëpunimi është në nivel tejet të ulët, bile mund të thuhet se nuk ekziston përkundër përpjekjeve që të mbahen takime, të cilat, megjithatë, kanë qenë pa sukses. Në një përgjigje tjetër është theksuar se Qendra i ka dërguar raport për punën e vet bashkësisë lokale, por asnjë herë nuk kanë marrë përgjigje kthyesë në formë të komentit, kritikës ose të ngjashme.

**3.3.1.d. Njohuritë.** Meqë intervistat ishin bërë me përfaqësues të ndryshëm të qendrave, përkatësisht me drejtorë (50% të të anketuarve), me punëtorë socialë (31%), me psikologë (11%), pedagogë (8%), njohuritë që i kanë lidhur me masat alternative, ishin në nivele të ndryshme. Përfundimi i nxjerrë nga përgjigjet ishte se drejtorët, kryesisht, kanë njohuri më të mëdha se të punësuarit tjerë nëpër qendra, megjithatë edhe njohuritë e tilla janë të nivelit të përgjithshëm. Përkitazi me këtë, ka pasur një këshillim që është mbajtur në dritën e miratimit të ndryshimeve në Kodin penal në vitin 2004, kurse takimi i ardhshëm është mbajtur, në nivel të njëjtë, në vitin 2006<sup>148</sup>, dedikuar gjithashtu drejtorëve të qendrave. Megjithatë, edhe sa u përket njohurive që i kanë menaxhuesit, përkatësisht drejtorët e qendrave, përgjigjet e të gjithë të anketuarve janë drejtuar kah i vetmi përfundim, se kanë njohuri të përgjithshme të cilat jo gjithëherë janë fituar nga informimi nga ana e organeve kompetente. Informata më të hollësishme, trajnime, këshillime dhe profesionalizime të të punësuarve ose implementuesve konkretë të masave alternative, nuk ekzistojnë kështu që, edhe njohuritë ekzistuese janë në të vërtetë të pjesërishe.

**3.3.1.dh. Trajnime.** Në këtë drejtim edhe pyetja për trajnimin plotësues dhe profesionalizimin e kuadrit i cili do të jetë kompetent për implementimin e këtyre masave. Sipas të gjithë të të anketuarve, pa përjashtim, e duke marrë parasysh se masat alternative, megjithatë, janë risi dhe nuk ka përvojë praktike në aplikimin e të njëjtave, nevoja e trajnimit si për kuadrin e qendrave, ashtu edhe për organet tjera të involvuara, ishte potencuar. Që theksuar nevoja e kategorive vijuese të trajnimit:

- \* Edukative (për natyrën, qëllimet dhe detyrat e masave alternative);
- \* Për mënyrat e propozimit dhe zbatimit të tyre;
- \* Për përcaktimin dhe përpunimin e kompetencave, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet organeve;
- \* Për zhvillimin e shkathtësive të komunikimit (posaçërisht te gjykatat);
- \* Për këmbimin e përvojave me komuna dhe vende të tjera; prezantimi i shembujve pozitivë
- \* Për nënshkrimin e memorandumit për bashkëpunim (që do të sigurojë komunikim të përhershëm edhe në rast të ndërrimit të kuadrove dhe personave që punojnë në institucionet përkatëse);
- \* Mbajtje e trajnimeve të përbashkëta për të gjitha organet, implementuese të masave.

**3.3.2. Puna e gjithëdobishme.** Sa i përket kësaj mase, të anketuarit u përgjigjën në mënyrë relativisht identike që arsyeton tezën se përveç dy këshillimeve dedikuar drejtorëve të qendrave, të punësuarit tjerë formalisht nuk janë të njoftuar me punën e gjithëdobishme. Praktikantët kanë njohuri të përgjithshme parimore për këtë masë, të fituara nga iniciativat

<sup>148</sup> I fundit është mbajtur në Strugë (17.06.2006) dhe ka qenë e dedikuar për drejtorët e qendrave. Ky takim ka qenë i organizuar nga Enti për zhvillimin e veprimtarive sociale.

personale, nga emisionet televizive, por trajnim formal, informim ose njohuri, nuk kanë fituar. Nga numri i përgjithshëm i drejtorëve të intervistuar të qendrave 70%deklaruan se kanë njohuri për masat, kurse të tjerët - praktikuesit (punëtorë socialë, psikologë, pedagogë ose juristë) në 31% të përgjigjeve kanë deklaruar se kanë ndonjë lloj njohurish.

Sa i përket mënyrës sipas së cilës mendojnë se do të kryhet puna e gjithëdobishme, të anketuarit kishin përgjigje shumë të ndryshme, pavarësisht a kanë deklaruar në pyetjen paraprake se kanë njohuri. Njohuritë, kryesisht, kishin të bëjnë me informatën se puna e gjithëdobishme do të thotë angazhimi punues pa pagesë i personave të dënuarën institucione të caktuara. Një pjesë e madhe e të anketuarve deklaruan se nuk kanë njohuri ngase nuk ka pasur shqiptim të një mase të këtillë, që përkon, në njëfarë mase, me deklaratat e llojit se kanë njohuri parimore, të përgjithshme dhe të pjesërishtme për këtë masë. Të gjitha deklaratat se një masë e këtillë nuk është zbatuar deri më tash, por se diçka e ngjashme është bërë me personat që pranojnë ndihmë sociale dhe angazhimi i tyre në punë, pikërisht nga nevoja që të jenë në dobi të bashkësisë.

Si mangësi, për shkak të të cilave të anketuarit konsiderojnë se nuk kryhet puna e gjithëdobishme, qenë theksuar me sa vijon:

- \* Mosshqiptimi i masës nga ana e gjykatave;
- \* Mungesa e rregullativës nënligjore;
- \* Mungesa e njohurive për këtë masë për ç' arsye nevojiten trajnime dhe edukim;
- \* Nuk ekzistojnë kushte kadrovike në suaza të qendrave ;
- \* Nuk ekziston vendosje adekuate organizative;
- \* Ekipe profesionale të ngarkuara shumë;
- \* Mungesa e mjeteve materiale;
- \* Nuk ekziston koordinim në mes të organeve kompetente;
- \* Mosinvolmimi i bashkësisë lokale;
- \* Mungesa e institucioneve përkatëse ku do të kryhet puna<sup>149</sup>;

Duke pasur parasysh faktin se të gjithë të anketuarit e dinin që puna e gjithëdobishme do të kryhet në institucione, ndërmarrje, shoqata humanitare dhe joqeveritare të caktuara, lidhur me obligimin për identifikimin e tyre, përgjigjet nuk ishin të njëjta. Përkatësisht, të anketuarit i përmendën thuaja të gjitha organet implementuese si kompetente për identifikimin e institucioneve. Megjithatë, më shumë ishte përmendur drejtoria për zbatimin e sanksioneve, pastaj vetadministrimi lokal, qendrat dhe në fund gjykatat. Është interesante që në asnjë kontekst nuk u përmend Ministria e punës dhe e politikës sociale si kompetente në cilindo aspekt. Ndoshta kjo del nga fakti që edhe aktivitetet që ishin marrë nga Enti i veprimtarive sociale lidhnin se Ministria merr pjesë duke pasur parasysh atë se edhe qendrat edhe Enti

<sup>149</sup> Në komuna të caktuara, përveç ndërmarrjes publike komunale, nuk funksionojnë institucione të tjera ku do të mund të kryhej puna e gjithëdobishme. Sa i përket biznesit privat, disa të anketuar konsideronin se ai nuk do të jetë i interesuar për përfshirjen në programin e këtillë sepse nuk do të ketë dobi nga kjo.

janë pjesë e Ministrisë së punës dhe politikës sociale. Sa i përket përzgjedhjes së organizatave joqeveritare, u theksua shqetësimi të disa të anketuar se qendrat duhet ti lejojnë organizatat joqeveritare për shkak të përvojës praktike që e kanë me disa prej tyre. Propozimi i tillë doli nga njohuria se një numër i madh OJQ nuk punojnë në mënyrë adekuate. Gjithashtu, u ritheksua se sektori i biznesit privat nuk do ta paraqesë me vetiniciativë interesin e vepër përfshirjen e veprimtarisë së këtyllë.

Ndonëse mund të vërehej një disponim pozitiv i të anketuarve për leverdinë e kësaj mase (të gjithë të anketuarit theksuan se masa është e mirë dhe mund ta arrijë qëllimin e vet), por edhe skepsa për implementimin praktik të së njëjtës, megjithatë, numri më i madh i të anketuarve u përgjigjeshin pyetjeve, duke pasur parasysh se është fjala për persona të rritur. Sa u përket të miturve dhe shqiptimit të masës punë e gjithëdobishme për ta, të anketuarit në masë të madhe e përkrahin idenë e tillë, por një numër i konsiderueshëm i tyre (34% të atyre që u deklaruan pozitivisht)specifikuan se masa mund të shqiptohet por për të mitur me moshë më të madhe (persona me moshë 16 vjeçare, por më të rinj se 18 vjeç).Arsyetimet e atyre të anketuarve të cilët konsideronin se kjo masë nuk duhet shqiptuar të miturve, theksuan se ndaj të miturve duhet pasur një qëndrim të vëmendshëm. Në përmasa të brengosjes, gjithashtu u theksua mendimi se mund të keqpërdoret puna e tyre, disa të mitur nuk do të mund ta kuptojnë esencën e kësaj mase e të ngjashme. Por, kryesisht mund të nxirren përfundimi se për numrin më të madh të të anketuarve masa e këtyllë mund të jetë e dobishme.

**3.3.3. Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.** Përveç përgjigjeve të theksuara më lartë dhe pikëpamjeve për çështje të caktuara praktike të cilat çojnë në realizimin e pasuksesshëm të masave alternative, përfaqësuesit e intervistuar të qendrave vunë në pah disa aspekte të cilat, gjithashtu, janë arsye e moszbatimit të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse. Aspektet për të cilat u përgjigjën të anketuarit mbuluan mbikëqyrjen mbrojtëse edhe atë në kuptimin të organizimit dhe të përmbajtjes së mbikëqyrjes që aplikohet ose do të aplikohet me aktivizimin e kësaj mase.

**3.3.3.a. Ekipi për zbatimin e mbikëqyrjes mbrojtëse.** Sipas përgjigjeve, momentalisht në suazat e strukturës organizative të qendrave, nuk ekziston ndonjë person i cili konkretisht do të kishte kompetencë për zbatimin e mbikëqyrjes që e përfshinë kjo masë. Në një numër të madh përgjigjesh, anëtarët e ekipit profesional nëpër qendra punojnë në të gjitha problematikat dhe nuk kanë ekipe të specializuara. Nëse paraqitet nevoja e kryerjes së mbikëqyrjes së tillë, përkatësisht nëse gjykata shqipton një masë të tillë, qendrat pa problem do të emërojnë person i cili do ta kryejë mbikëqyrjen<sup>150</sup>. Sipas të anketuarve, edhe pse nuk ekziston një trup ose person i tillë i specializuar, megjithatë, mbikëqyrja e tillë do të ishte e zbatueshme për faktin që qendrat janë të trajnuara, për shembull, ta zbatojnë mbikëqyrjen mbrojtëse te të miturit.

**3.3.3.b. Përmbajtja e mbikëqyrjes mbrojtëse.** Kur flasim për dënimin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, mbikëqyrja mbrojtëse nuk do të thotë vetëm kryerje e mbikëqyrjes që nënkupton kontrollimin e sjelljes së personit, por përfshin edhe masa të ndihmës dhe kujdesit. Marrë në përgjithësi, kur qendrat kryejnë mbikëqyrje (e kjo ndodh në rastet me të miturit), përgatitet program individual në të cilin hollësisht është përpunuar mënyra e mbikëqyrjes dhe kontrollit që do të kryhet.<sup>151</sup> Këtu janë përfshirë kontaktet me personin dhe familjen, takime me punëdhënësit ose shkollat e të ngjashme. Mbi këtë bazë

<sup>150</sup> Megjithatë, për vendosje organizative, për koordinim, obligime të përcaktuara dhe për përgjegjësitë nuk bëhet fjalë. Duket se kriteri formal do të plotësohej, por për cilësinë do të bisedonin kur do të lindin problemet.

<sup>151</sup> Vlen të përmendet se ekziston dallim i madh ndërmjet llojit të mbikëqyrjes që aplikohet ose do të aplikohet te personat e mitur dhe ata të rritur.

punëtori social përgatit raport dhe e njofton gjykatën në afat prej 3 muajsh, por edhe më shpesh nëse nevojitet. Prapëseprapë, siç qe përmendur paraprakisht, kur është fjala për persona të rritur, mund të thuhet se qendrat edhe nuk kanë ndonjë përvojë të pasur. Kështu, për shembull, kur bëhet fjalë për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe dhënien e ndihmës profesionale personave që kanë dalë nga burgu, përveç ndihmës së njëhershme me të holla<sup>152</sup> mund të thuhet se ndihma profesionale nuk u ofrohet gjithëherë. Kështu, në rreth 45% të rasteve të anketuarit deklaruan se takime dhe ndihmë të tillë ka por në gjysmën e këtyre rasteve qe theksuar se ndihma e tillë ofrohet ose me iniciativë të personit ose nuk është e rregullt ose zbatohet herë pas here. Është e qartë se ndjekja e vazhdueshme e situatës së këtyre personave nuk realizohet por edhe cilësia e ndihmës profesionale është vënë në pyetje. Kjo e fundit është pikërisht në relacion me përgjigjet paraprake për mbingarkesën e ekipeve profesionale dhe punën e tyre në të gjitha fushat, bile edhe kryerje të punëve administrative.<sup>153</sup>

Përveç punës mbikëqyrëse për të cilën ekziston praktikë, personave të cilëve u është shqiptuar kjo masë, u imponohen edhe obligime të caktuara. Pikërisht nëpërmjet të imponimit të obligimeve dhe organizimit të aktiviteteve do të tentohet që të sigurohet risocializim dhe riintegrim i këtyre personave. Në numrin më të madh të përgjigjeve u theksuan forma themelore të caktuara angazhimit të personave të cilët mund të kategorizohen në obligime edukative dhe punuese. Në suazat e angazhimit punues mund të hetohet skepsa të këta praktikues sa i përket kërkimit të punësimit. Përkatësisht, skepsa ishte sa i përket sektorit të biznesit privat ku, nëse nuk ekzistojnë benificione të caktuara<sup>154</sup>, vështirë se mund të jenë në dobi, në këtë drejtim. Megjithatë, mundësia ekziston, kurse në interes të shtetit është që ta motivojë këtë sektor i cili padyshim do t'i kontribuojë përmirësimit të mënyrave të riintegrimit të personave në shoqëri. Si plotësim, ishin cekur obligime të caktuara përkufizuese, si përkufizimi i qarkullimit, mosqëndrimi nëpër lokale, moskonsumimi i alkoolit ose substancave të tjera, mosshoqërimi me njerëz ose shoqëri të caktuara, por edhe obligime të llojeve më banale – përgatitja e drekës ose shpërndarja e buxhetit shtëpiak.

Në përgjithësi, praktika e këtyre bën të mendohet se personit i imponohen obligime të caktuara ose ndalesa, kurse qendra bën mbikëqyrjen e asaj që e bën personi dhe si sille. Konkretisht nuk ishte precizuar cilat janë detyrimet e qendrave nga aspekti i ndihmës dhe kujdesit gjatë zbatimit të asaj që i është urdhëruar personit. Ndoshta kjo nënkuptohet por konkretisht nuk ishte theksuar nga asnjë i anketuar.

E tëra kjo, pak a shumë është identike me atë që në mënyrë të thukët e radhit ligji. Megjithatë, sa u përket dispozitave që e rregullojnë këtë materie, sa i përket asaj se kush i përcakton ose ku janë të përcaktuara obligimet të cilat mund t'u imponohen personave, është i dukshëm një mosharmonizim në përgjigjet e dhëna. Kështu, për 40% të të anketuarve këto ishin programet individuale të cilat i përgatisin qendrat, kurse për 30% të të anketuarve ky është Ligji për mbrojtje sociale, për të tjerët kjo është theksuar në aktgjykimin me të cilin shqiptohet masa. Gjysma e të anketuarve u deklaruan se kur obligimet i cakton gjykata, këtë e bën në bazë të mendimeve të qendrave.

<sup>152</sup> Kjo ndihmë ndahet me kërkesën/iniciativën e personit, e jo me automatizëm.

<sup>153</sup> „Nga analiza e gjertanishme e punës së qendrave (viti 2001)... vetëm 13,9% nga rastet e zgjidhura nëpër qendrat ... paraqesin kompetenca profesionale“, Donevska, Dimitrijovska, „Organizimi dhe zhvillimi i qendrave për punë sociale (Tendencat zhvillimore)“, faqe 6, Ministria e punës dhe politikës sociale, Enti për veprimtari sociale, Shkup, 2005.

<sup>154</sup> Këtu u vu në dukje shembulli i punësimit të personave me nevoja të veçanta, për punësimin e të cilëve pronarët janë liruar nga pagesa e tatimeve të caktuara ndaj shtetit.

**3.3.4. Roli i bashkësisë në zbatimin e masave alternative.** Duke pasur parasysh se qendrat nuk kanë përvojë praktike në zbatimin e masave alternative, por megjithatë kanë njohuri për metodat e risocializimit dhe riintegritit të personave të përjashtuar social, kanë të paktën përvoja teorike e, deri diku ndoshta edhe përvoja praktike në trajtimin postpenal të personave të rritur, mund të merren parasysh edhe qëndrimet, më saktësisht, mendimet e të anketuarve në këtë kontekst.

Kështu, sa i përket rolit të bashkësisë pikërisht në zbatimin efikas të këtyre masave, të anketuarit konsiderojnë se me rëndësi të madhe për risocializimin e tyre është pranimi i këtyre personave nga ana e bashkësisë dhe pjesëmarrja e tyre normale në jetën lokale. Por, në aspekt të gjendjes reale, numri më i madh mendojnë se vetëdija publike e popullatës sonë, posaçërisht asaj që jeton në vende rurale dhe më të vogla, është në nivel shumë të ulët. Në mjedise të këtilla këta persona nuk do të jenë të pranuar (të paktën në fillim). Është më se e sigurt se do të jenë të njollësuar dhe stigmatizuar, dhe së këndejmi edhe skepsa se në fillim nuk do të mund të realizohet qëllimi i këtyre masave.

Po qe se ngrihet vetëdija publik, po qe se opinioni informohet se për çfarë veprash shqiptohen këto masa, çka paraqesin ato dhe për çfarë kryerësish është fjala, ndoshta atëherë do të ekzistojnë mundësi për një realizim praktik dhe për zbatim efikas të masave, e me këtë edhe realizimi i qëllimeve të tyre. Aktivitetet e këtilla doemos të ndërmerren nga ana e shtetit edhe atë, nga Drejtoria, nga bashkësia lokale por edhe nga organizatat joqeveritare. Format më të shpeshta të informimit të opinionit dhe ngritjes së vetëdijes publike, për të anketuarit ishin mediumet, si ato të shtypura ashtu edhe elektronike.

## K O N K L U Z I O N E

Qendrat për punë sociale sipas esencës së punës së vet , pasqyruar nëpërmjet jorepresivitetit gjatë veprimit, janë organet kryesore të cilat drejtpërdrejtë do t'i zbatojnë masat alternative. Sipas gjendjes momentale sa i përket informimit dhe njohurive për problematikën e masave alternative, mund të konkludohet se personeli profesional në qendrat disponon informata parimore për aktivitetet që zhvillohen në drejtim të implementimit të masave. Njohuritë kanë të bëjnë kryekëput me atë që e organizon Enti për veprimtari sociale. Informata nga nivele më të larta nuk ekzistojnë. Informata kanë kryesisht drejtorët por jo edhe të punësuarit ose praktikuesit, ata të cilët do t'i zbatojnë masat. Njohuritë, midis tjerash, janë të përkufizuara për arsye se nuk ekziston rregullativë nënligjore për ripërpunimin dhe risaktësimin e kompetencave, përgjegjësi, koordinimit dhe, në përgjithësi, të procedurës së zbatimit të masave..

Rjedhimisht kësaj, ndonëse Ligji për zbatimin e sanksioneve parasheh, nëpër qendra nuk ekziston një strukturë e organizuar në mënyrë përkatëse, përkatësisht nuk ekzistojnë persona, ekipe profesionale ose seksione, që janë konkretisht kompetentë për zbatimin e masave alternative. Me këtë ndërlidhet edhe gjendja momentale që ekziston nëpër qendra, e kjo është ekipimi jo i mjaftueshëm posaçërisht në aspekt të mungesës së ekipit profesional. Kapacitetet e qendrave janë në nivel tejet të ulët të kryerjes së veprimtarisë., e me rritjen e obligimeve lind edhe skepticizmi se të njëjtat do të organizohen në mënyrë përkatëse që të mund të aplikohen në mënyrë adekuate. Mjetet materiale të cilat do të jenë të domosdoshme për masat alternative në përputhje me buxhetet ekzistuese të cilat janë zvogëluar për 30-40% për dallim nga viti i kaluar, nuk do të mjaftojnë. Më saktë, të njëjtat tani për tani janë shumë të vogla duke pasur parasysh vëllimin e madh të punës.

Meqë qendrat do të jenë vetëm një pjesë e tërë zinxhirit për implementimin e masave, bashkëpunimi me hallkat tjera të sistemit, përkatësisht me organet e tjera, doemos të përcaktohet hollësisht. Nga bisedat me përfaqësuesit e qendrave duke qartë pakënaqësia në këtë drejtim. Pakënaqësi e veçantë u shfaq lidhur me bashkëpunimin me gjykatat. Përkitazi me organet tjera, bashkëpunimi ose është në nivel tejet të ulët, si për shembull me prokurorinë publike ( me përjashtim të bashkëpunimit për delikucencën e të miturve) ose aspak nuk ekziston, siç është rasti me Drejtorinë për zbatimin e sanksioneve dhe njësitë e vetadministrimit lokal. Kjo nga ana tjetër do të thotë se , përveç në situata të jashtëzakonshme edhe atë me gjykatën, shërbimet që i japin qendrat për punë sociale, organet tjera nuk i shfrytëzojnë, e disa as që janë të interesuar për punën e tyre.

### 3.4. ANALIZË E PYETËSORËVE DEDIKUAR KOMUNAVE

Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte që të fitohen njohuri konkrete për njoftimet, rolin, iniciativat dhe kapacitetet e komunave për përfshirje në procesin e zbatimit të masave alternative. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh procesin e decentralizimit dhe bartjes së kompetencave prej nivelit qendror në atë lokal, njëra prej qëllimeve të veçanta ishte që të shihet se a është bartur një pjesë e procesit të zbatimit të sanksioneve në kompetencë të komunave, përkatësisht sa janë të inkuadruar dhe përgjegjëse në procesin e krijimit të politikës ndëshkimore në Republikën e Maqedonisë. Po qe se pajtohemi se masat alternative zbatohen në bashkësinë, në vendin e banimit të personit të dënuar, atëherë nuk mund e të mos pajtohemi se komuna duhet të përfshihet në mënyrë aktive, veçanërisht kur është fjala për punën e gjithëdobishme. Duke pasur parasysh mënyrën e zbatimit të saj, komuna do të duhet të jetë e përfshirë drejtpërdrejtë si pjesë e aktiviteteve dhe të ndër marrë përgjegjësi përkatëse. Mu për këto arsye, njëri prej qëllimeve ishte që të fitohen të dhëna konkrete se a janë komunat të njoftuarave për ekzistimin e masave alternative, si pjesë të sistemit të sanksioneve penale..

**Rezultate nga hulumtimi.** Gjatë procesit të hulumtimit, koordinatori i projektit zhvilloi intervista me përfaqësues të një numri të caktuar komunash në Republikën e Maqedonisë. Prej gjithsej 33 komunave me seli në qytet, janë realizuar 23 intervista, edhe atë me përfaqësues të komunave në Tetovë, Kërçovë, Dibër, Kumanovë, Kratovë, Koçan, Shtip, Ohër, Kriva Pallankë, Vinicë, Probishtip, Dellçevë, Berovë, Resnjë, Manastir, Gjevgjeli, Strumicë, Kavadar, Negotinë, Vallandovë, si dhe me përfaqësues të komunave Shkup-Qendër, Shkup-Shuto Orizarë dhe Shkup-Çair. Së këndejmi, mund të përfundojmë se të dhënat që u fituan gjatë hulumtimit, mund t'i kontribuojnë verifikimit të njohurive të caktuara dhe nxjerrjes së përfundimeve dhe propozimeve cilësore, të cilat do të jenë bazë e mirë për hulumtime të mëtejshme të thelluara si dhe inicimit të reformave për animimin dhe angazhimin e komunave në procesin e zbatimit të masave alternative.

#### 3.4.1. Kushtet dhe mangësitë.

**3.4.1.a. Rregullativa nënligjore.** Ndonëse në periudhën e realizimit të intervistave, masat alternative janë rregulluar vetëm me Kodin penal dhe me Ligjin për zbatimin e sanksioneve, megjithatë, të anketuarit u pyetën se a janë sjellë akte nënligjore për rregullimin e tyre më të afërt dhe në çfarë faze është procesi i miratimit të tyre. Më se 65% të të anketuarve deklaruan se nuk ekzistojnë akte nënligjore me të cilat për së afërmi do të rregullohej mënyra e zbatimit të tyre. Në këtë kontekst vlen të përmendet se numri më i madh i të intervistuarve, ishin udhëheqës të shërbimeve juridike në komuna. Intenca e hulumtimit ishte që të shihet se a janë të inkuadruara komunat në procesin e miratimit të tyre duke pasur parasysh aktivitetet të cilat ndërmerren nga ana e Entit për veprimtari sociale, si organ që, megjithatë, është më aktiv dhe më i informuar në fushën e përmendur.

Në drejtim të njëjtë shkojnë edhe përgjigjet sa i përket informimit për atë se a ekziston strategji e caktuar qeveritare ose program për implementimin e masave alternative. Ndonëse numri më i madh i të intervistuarve (12) u përmbajtën nga dhënia e çfarëdo përgjigjeje, të tjerët konsideronin se nuk ekziston strategji e qeverisë. Bile edhe në pyetjen se a ekziston iniciativë për sjelljen e programit të tillë, u vërtetuan rezultatet paraprake, sipas të cilave, përveç 4 të anketuarve, të cilët janë të mendimit se ekziston iniciativë për sjelljen e një strategjie të caktuar, edhe pse nuk dinin të saktësojnë, të tjerët ose nuk kishin njohuri ose në mënyrë kategorike pohonin se asgjë nuk ndodh në këtë plan. Nga përgjigjet e këtilla duket qartë se komunat janë përjashtuar nga procesi i aktiviteteve momentale modeste, që zhvillohen në fushën e masave alternative.

**3.4.1.b. Organizimi.** Sipas vendosjes organizative të komunave, shikuar nga aspekti i përfshirjes së tyre në krijimin e politikës ndëshkimore në shteti, mund të shihet se në këtë nivel komunat ende nuk janë aktive. Në kuadër të komunës nuk ekziston **strukturë/seksion organizativ** e cila ndërmerr aktivitete për parandalimin dhe pengimin e krimit dhe e cila, ndoshta në atë përbërje, do të ishte kompetente për implementimin e masave alternative. Përkundër përgjigjeve negative, te pjesa më e madhe e të anketuarve ekziston interesim, vullnet dhe dëshirë për bashkëpunim me institucione të tjera kompetente edhe në këtë fushë. Ndonëse nuk ekziston obligim ligjor për organet legjislativë që të dorëzojnë raporte/statistika/të dhëna për numrin e personave të dënuar si dhe për sanksionet e shqiptuara penale deri te komunat, për të fituar një pasqyrë më të plotë për atë se a janë njoftuar komunat, në çfarëdo mënyre, me gjendjen me krimin në përgjithësi, iu shtrua pyetja pikërisht për këtë, përkatësisht a kanë *shikim në numrin e masave të shqiptuara alternative*. Përgjigjet e dhanë rezultatit e pritur, kurse pasqyra për mosinformimit e plotë të komunave qartazi u pengon, që mund të shikohet nga përgjigjet se komunat kanë nevojë të jenë të informuar për numrin e masave të shqiptuara alternative ndaj personave të cilët kanë vendbanim të përhershëm në komunat e tyre (nga qëndrimi i këtyllë bëjnë përjashtim vetëm dy të anketuar). Në këtë kontekst ishte edhe propozimi se në kuadër të sigurimit publik<sup>155</sup> që është kompetencë e komunë, mund të inkuadrohet edhe pyetja për masat alternative, preventivën nga krimi, delikuenca e të miturve e të ngjashme. Përveç këtyre qenë theksuar edhe mundësi të tjera dhe propozime përkitazi me aktivitetet të cilat mund t'i ndërmerren komuna, përkatësisht vunë në pah:

- \* Nevojën e bashkëpunimit me seksionet penale të gjykatave themelore, pikërisht nga aspekti i informimit për gjenden me krimin në komunën përkatëse;
- \* Iniciativën për kryerjen e mbikëqyrjes në zbatimin e masave alternative, megjithëse nuk specifikuan në çfarë drejtimi kryerja e mbikëqyrjes;
- \* Nevojën e përgatitjes së programeve të veçanta për implementimin e masave alternative në nivel komunash;
- \* Mundësinë që komunat të kontribuojnë në identifikimin e shërbimeve publike dhe organizatave të tjera humanitare të cilat do të mund të pranenin persona të dënuar duke pasur parasysh se me bartjen e kompetencave prej nivelit qendror në atë lokal, ndërmarrjet dhe institucionet publike, të cilat kryejnë veprimtari me interes publik, janë në pronësi të vetadministrimit lokal;

<sup>155</sup> Komisioni i sigurisë, siç e bujnë të anketuarit, aty ku ishte përmendur, që thënë se nuk funksionon.



- \* Mundësinë që komunat të mund të angazhojnë persona të dënuar në veprimtaritë komunale dhe punë të tjera në interes të komunës;
- \* Mundësinë që komuna të ndërmarrë aktivitete për informim dhe edukim.

Përgjithësisht, prej propozimeve dhe dëshirave që u shfaqën nëpërmjet pyetësorit, mund të konkludohet se përveç kompetencave dhe obligimeve të parapara me Ligjin e vetadministrimit lokal, një numër i madh i të anketuarve janë të vetëdijshëm për nevojën e përfshirjes edhe të fushave të tjera që janë në interes për bashkësinë.

**3.4.1.c. Kapacitetet.** Kur është fjala për masat alternative dhe faktin se ato do të zbatohen në bashkësinë, përkatësisht në vendin e banimit të personit të dënuar, është i pamohueshëm fakti që komuna do të jetë e inkuadruar, në këtë apo atë mënyrë, në procesin e implementimit. Gjithashtu, meqë në masë të caktuar ekzistojnë zgjidhje ligjore të cilat nuk flasin në mënyrë decide për masat alternative dhe aktivitete të komunës gjatë zbatimit të tyre, por përfshijnë ose, thënë më mirë, mund të prekin aspekte të kësaj fushe, të anketuarit ishin të pyetur se a ekzistojnë, në kuadër të komunave të tyre, *kapacitete institucionale, njerëzore dhe materiale* për implementimin e suksesshëm të masave alternative. Me këtë rast, si fakt ishte marrë supozimi se komuna ka një kompetencë të tillë.

Përgjigjet e dhëna lëvizin varësisht nga ajo se a është fjala për kapacitete materiale, njerëzore ose institucionale. Kështu, derisa 4 të anketuar mendojnë se komunat nuk kanë kapacitet, ose ai nuk është në masë të mjaftueshme, për t'u përfshirë në zbatimin e masave alternative, përgjigje pozitive mund të vërehet sa i përket ekzistimit të potencialit njerëzor. Prapëseprapë, të njëjtët janë të mendimit (14) se përveç ekzistimit të kuadrit, nevojiten një organizim plotësues dhe mjete materiale (6). Vetëm në tre raste të anketuarit mendojnë se komunat kanë kapacitet përkatës për implementimin e masave alternative, që munden të rrisht t'u përgjigjen kërkesave të reja përkatësisht detyrave plotësuese, po qe se barten në kompetencë të tyre.

Sa u përket *burimeve të financimit* për kryerjen e atyre kompetencave, duke pasur parasysh se komunat kanë buxhetin e vet, imponohet dilema, vallë a do të jenë pjesë e buxhetit tanimë të definuar, shpenzimet e nevojshme për kompensimin e një pjese të aktiviteteve të cilat do të ndërmerreshin nga ana e komunave, ose së bashku me bartjen e kompetencave shtesë, do të barten edhe mjete financiare shtesë. Ndonëse momentalisht komunat nuk kanë zëre të veçanta në buxhetet e tyre për zbatimin e masave alternative, megjithatë, paralajmëruan se ka mundësi që të shfrytëzohen zëra të tjerë të buxhetit nëse përputhen me dedikimin e tyre. Disa komuna ndajnë mjete për projekte të organizatave joqeveritare të cilat ndoshta, si modalitet, do të mund të shfrytëzohen po qe se koordinimi gjatë implementimit të masave alternative zhvillohet edhe në atë nivel.

**3.4.1.ç.** Duke marrë parasysh specifikën e materies që është në pyetje, mosekzistimi i strukturës organizative, mungesa e njohurive për masat, mungesa e informatave për aktivitete në planin e masave alternative, është e qartë se, nëse komunat marrin një pjesë të obligimeve në këtë drejtim, do të jetë i nevojshëm trajnimi dhe profesionalizimi i personave përkatës. Veçanërisht u theksua nevoja e precizimit të qartë të kompetencave, organizimit, mënyrës së kryerjes së mekanizmave të bashkëpunimit me institucione relevante, si dhe nevoja e bartjes së ditorisë nga ana e institucioneve përkatëse të specializuara për këtë qëllim.

**3.4.1.d. Bashkëpunimi.** Prej përgjigjeve të marra lidhur me bashkëpunimin ekzistues ndërmjet komunave dhe organeve të tjera implementuese të masave, është i dukshëm izolimi i plotë i komunës në cilindo kontekst, jo vetëm sa u përket masave alternative. Qe theksuar

vetëm ajo se , në masë të caktuar, komunat bashkëpunojnë me qendrat për shkak të kompetencës që e kanë në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, por as ai bashkëpunim nuk mund të thuhet se është në nivel të kënaqshëm. Përkatësisht, ky bashkëpunim më shumë realizohet në sferën e realizimit të të drejtave nga mbrojtja sociale, edhe atë në rastet me angazhimet në punë të pranuesve të ndihmës sociale me të holla.

Pyetja e përmendur u imponua për shkak të dispozitave jo të rregulluara ose jo të precizuara plotësisht në Ligjin për zbatimin e sanksioneve që kanë të bëjnë çështjet në vijim:

- \* kush do ta kryejë mbikëqyrjen mbi përmbushjen e obligimeve të personit të dënuar?
- \* cilat janë burimet e financimit për kryerjen e atyre kompetencave?

Lidhur me çështjen e parë, sipas KP, mbikëqyrjen e përmbushjes së obligimeve të të dënuarit e kryen gjyqi, kurse sipas LZS, seksioni (mendohet për seksionin në kuadër të qendrave) në afat prej 15 ditësh cakton një person i cili do të kryejë mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të zbatimit të punës së gjithdoshme. Nga ana tjetër sipas nenit 36/1, pika 4 të Ligjit të vetëadministrimit lokal, komunat janë kompetente që të kryejnë mbikëqyrjen mbi punën e shërbimeve publike që janë në kompetencë të tyre. Së këndejmi ekziston kompetencë e ndarë ndërmjet të gjitha palëve të përfshira dhe për shkak të shmangies së përplasjes eventuale të kompetencave në kryerjen e mbikëqyrjes, nevojitet të bëhet një ndarje e përpiktë e kompetencave, bashkëpunimi dhe koordinimi i tyre i ndërsjellë.

Shikuar nga përgjigjet e përfaqësuesve të këtij organi dhe nga veprimi me drejtim autist, gjendja në këtë nivel në këtë moment është krejtësisht e pakënaqshme, përkatësisht nuk ekziston kurrfarë relacioni ndërmjet komunës dhe organeve të tjera.

**3.4.1.dh. Njohuritë dhe pranueshmëria.** Lidhur me atë se sa përfaqësuesit e komunave janë të informuar dhe të njoftuar me masat alternative, me mënyrën e realizimit të tyre, me mundësitë që i ofrojnë, dëshpërues ishte fakti se gati gjysma e të anketuarve aspak nuk janë të njoftuar me ekzistimin e masave alternative, rëndësinë e tyre, mënyrat e zbatimit ose me qëllimet që duhet t'i arrijnë. Të anketuarit tjerë (11) kishin njohuri parimore. Duke pasur parasysh faktin se shumica e të anketuarve ishin përfaqësues të sektorëve juridikë të komunave, kishin njohuri të caktuara për masat. Megjithatë, ishin mjaft të pa sigurt gjatë dhënies së përgjigjes pohuese. Duke sigur kishin dëgjuar për masa të tilla, por informata të hollësishme për të njëjtat nuk kishin.

Ajo që u tha më lartë shkon në llogari të përgjigjeve , sipas të cilave, të anketuarit masat alternative i shohin si zëvendësim i mirë i dënimit me burg dhe mendojnë se të njëjtat mund ta arrijnë qëllimin e vet, përkatësisht risocializimin e personave, pa privim nga liria. Ekziston pajtueshmëria se masat alternative mund të jenë të dobishme kur është fjala për vepra më të lehta penale. Ndërkaq, numri më i madh i të anketuarve, realizimin e qëllimeve e kushtëzojnë me llojin, respektivisht , peshën e veprës së kryer penale si dhe me nevojën vendosjes organizative përkatëse të vetë masave.

**3.4.2. Puna e gjithdoshme.** Duke pasur parasysh se vetë fjala punë e gjithdoshme nënkupton kryerjen e punëve të cilat janë me karakter të gjithdoshëm , që do të thotë me interes për qytetarët dhe bashkësinë, ligjvënësi gjatë rregullimit të masës së përmendur alternative , nëpërmjet numërimit të vendeve se ku i dënuari mund t'i punojë orët e caktua qartë, ka tentuar që në mënyrë indirekte ta përcaktojë karakterin e tyre të gjithdoshëm. Kështu, sipas Kodit penal është përcaktuar minimumi dhe maksimumi i orëve të punës të cilat i dënuari do të jetë i obliguar t'i punojë pa kompensim në organe shtetërore,

ndërmarrje publike, institucione publike ose në organizata humanitare. Sipas Ligjit për vetadministrim lokal<sup>156</sup>, është përmendur në mënyrë eksplicite se cilat punë konsiderohen si punë me interes të përgjithshëm, në kompetencat e kujt janë të njëjtat dhe në çfarë forme institucionale zbatohen ato.

Në të vërtetë, sipas nenit 21, komunat në mënyrë të pavarur i përcaktojnë dhe i kryejnë punët me interes publik me rëndësi lokale, deri sa në nenin vijues është dhënë lista e tyre e hollësishme.

Do të thotë, gjykatësi gjatë shqiptimit të masës, mund të zgjedhë njërin nga aktivitetet, që assesi nuk përjashton edhe aktivitete tjera me karakter të gjithdobishëm, që mund të ofrohen nga ana e organeve ose organizatave tjera humanitare, siç është përcaktuar në ligj.

Megjithatë, në këtë pjesë të analizës do të ndalemi në kompetencat në suaza të komunave, si subjekte përgjegjëse për zbatimin e tyre. Kështu, nëse pranohen kompetenca të caktuara me karakter publik si mundësi për implementimin e punës së gjithdobishme, komuna *doemos* duhet të njoftohet sepse e njëjta bën mbikëqyrjen ndaj punëve të cilat kryhen nga kompetenca e saj. Kjo është në pajtim me neni 234 të LZS, sipas të cilit për kryerjen e punës së gjithdobishme, Drejtoria lidh marrëveshje përpos me organin shtetëror, organizatën humanitare, institucionin, ndërmarrjen publike, edhe me njësinë e vetadministrimit lokal në të cilën personi i dënuar do t'i kryejë obligimet e veta punuese.

**3.4.2.a.** Si rezultat i kësaj që u tha më lart, të anketuarit u pyetën se *a janë krijuar kushte për zbatimin e saj*, dhe në rastin e përgjigjes negative, cilat kushte, sipas tyre do të duhej të plotësohen.

Edhe pas dy vitesh nga zbatimi i punës së gjithdobishme, përgjigjet e të anketuarve e vërtetojnë të njëjtin mendim si edhe para vetë realizimit të këtij projekti. Përveç 3 të anketuarve të cilët konsiderojnë se janë krijuar kushte, duke mos përmendur konkretisht cilat, të tjerët konsiderojnë se nuk janë krijuar parakushte për implementimin e saj të tërësishëm. Shkakun për gjendjen e këtillë disa e gjejnë në mosekzistimin e akteve nënligjore përkatësisht të legjislacionit dhe programeve të caktuara. Të tjerët konsiderojnë se nuk ekziston vendosje institucionale përkatësisht organizative ose madje mekanizëm i cili do të bënte mbikëqyrje ndaj zbatimit të masës konkrete alternative. Një pjesë e vegël e të anketuarve e shikojnë në mosekzistimin e ndonjë marrëveshjeve për bashkëpunim, e cila do të lidhej ndërmjet shërbimeve publike, ku do të kryhej puna, dhe Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve kompetente për procesin e zbatimit. Më tutje, si shkaqe të moszbatimit të këtyre masave, të anketuarit përmendën edhe procesin e papërfunduar të decentralizimit dhe kompetencat e ndara ose të transferuara në mënyrë joprecize, prej pushtetit qendror në atë lokal, mosekzistimin e komunikimit ndërmjet organeve, mosekzistimin e praktikës e cila mund t'i vë në pah mangësitë. Sipas këtyre të anketuarve kushtet që duhet të plotësohen, në mënyrë që të mund të sendërtohen këto masa, lëvizin në këtë drejtim: sjellja e akteve nënligjore, vendosja e strukturës përkatëse organizative, precizimi i kompetencave. Përveç dilemës që paraqitet te shumica e të anketuarve sa i përket asaj se cili organ do të ishte përgjegjës për kryerjen e mbikëqyrjes, një pjesë e tyre konsiderojnë se komunat duhet ta marrin këtë kompetencë. Me këtë rast, në plotësimin e përgjigjeve mund të shihen mendimet e tyre për formimin e një trupi/seksioni kompetent për këto punë, ose madje emërimi i një personi, koordinatori i cili do të ishte kompetent për aktivitetet e këtilla.

<sup>156</sup> Ligji për vetadministrimin lokal, neni 21

Duke marrë parasysh atë se puna e gjithdobishme realizohet në shërbimet publike, institucionet publike, shoqatat humanitare, u bë pyetja se deri tash në suazat e komunës a janë *identifikuar shërbime publike konkrete* në të cilat personi i dënuar duhet ta kryejë obligimet e veta punuese. Përgjigja e të anketuarve është negative. Gjithashtu, numri më i madh i të anketuarve konsideron se në komunat e tyre ekzistojnë ndërmarrje publike të cilat mund të ofrojnë punë me karakter të gjithdobishëm, ku mund të përfshihen personat e dënuar. Duke marrë parasysh atë se edhe shoqatat e qytetarëve janë paraparë si vende ku mund të kryhet puna e gjithdobishme, një numër i vogël i të anketuarve nuk i dhanë besim obcionit të këtillë, duke konsideruar se shoqatat e qytetarëve nuk janë adekuate që të ofrojnë shërbime të mira, përkatësisht të marrin obligim që të pranojnë persona të dënuar në mënyrë që masa të zbatohet në mënyrë efikase. Sa i përket asaj se në kompetencë të kujt është obligimi i këtillë, përgjigjet ishin të ndara, por mund të thuhet se dominonte përgjigja sipas së cilës komuna është trupi që duhet ta ketë këtë kompetencë, duke marrë parasysh faktin se i njeh më së miri kushtet dhe nevojat lokale.

Sa i përket asaj se *a do të duhej puna e gjithdobishme të zbatohet edhe ndaj personave të mitur*, përgjigjet lëviznin në mënyrë ekstreme. Në të vërtetë, një numër jo i vogël i të anketuarve japin përgjigje negative me arsyetim se masa nuk do të ketë efekt, nëse të miturit ndëshkohen me punë, përkatësisht se, për shkak të personalitetit të tyre të paformuar, nuk do ta kuptonin rëndësinë e saj. Të tjerët e lidhin masën alternative me vitet e moshës së të miturve, si dhe me llojin e punës, përkatësisht duke i pasur parasysh kategoritë të mitur më të rinj dhe më të vjetër sipas KP, një pjesë e të anketuarve konsiderojnë se ajo mund të shqiptohet ndaj të miturve më të rritur. Mbështetje për këtë qëndrim para së gjithash, gjejnë në Ligjin për marrëdhënie pune, sipas të cilit ndalohet puna për të mitur nën 15 vjeç. Edhe përpos asaj se shumica (10) konsiderojnë se masa alternative është shumë më efikase të zbatohet ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, një pjesë e tyre e kushtëzojnë me zgjedhje të veçantë të punës ose e kombinojnë me komponentin edukativ. Njëri madje shkoi deri atje sa që konsideron se parimi i oportunitetit duhet të përjashtohet në rast të ndjekjes së të miturve. Vetëm njëri nga të anketuarit përgjigjen për pyetjen e përmendur ia lë Qendrës për punë sociale.

**3.4.3. Mendimi publik.** Përgjigje interesante janë dhënë në pyetjen *si e shikojnë përfaqësuesit e komunave rolin e bashkësisë* në procesin e zbatimit të masave alternative, veçanërisht të punës së gjithdobishme. Numri më i madh i të anketuarve pajtohen se ajo duhet të ketë rol më aktiv në pranimin e personave. Kur është fjala, madje, për madhësinë e mjedisit lokal në të cilin personi i dënuar jeton, ekzistojnë qëndrime të ndryshme për anët pozitive, përkatësisht negative, të lidhura me afërsinë dhe njohjen e ndërsjellë të qytetarëve në një qytet. Kështu, njëri nga të anketuarit konsideron se, vetë fakti që është zhvilluar një afërsi më e madhe ndërmjet banorëve në një qytet më të vogël, ndikon në atë që personi të pranohet më lehtë nga ana e tyre. Kundrejt qëndrimeve dhe mendimeve të këtilla janë edhe mendimet e një numri të vogël të të anketuarve se afërsia, njohja e këtillë dhe mjedisi i ngushtë mund të ketë ndikim negativ para së gjithash ndaj personit të dënuar. Si veçanërisht karakteristike theksojmë mendimin sipas të cilit roli i bashkësisë varet nga personaliteti i personit. Në të vërtetë, në përgjigje thuhet se nëse personi ka pasur funksion të lartë, reagimi i bashkësisë do të ishte më negativ në krahasim me atë që do ta kishin ndaj të kthyerve ose personave me ndikim të vërejtur dhe sjellje delikvente. Qëndrimi i këtillë vë në dukje mundësinë e retributivitetit i cili do të orientohet ndaj personit të dënuar nga ana e atij i cili duhet t'i ndihmojë më së shumti.

Pikërisht lidhur me këtë numri më i madh (23) i të anketuarve konsideron se *qytetarët duhet të njoftohen me qëllimet, mënyrën e zbatimit të masave*. Dallime e ekzistojnë vetëm në shkallën e paraqitjes së të dhënave në opinion, e të cilat u dedikohen të dhënëve personale të personave të dënuar. Kështu, përderisa pakica konsideron se të dhënat për personin

duhet të mbeten në dosjet e gjyqeve dhe nuk duhet të prezantohen publikisht me qëllim që të mos stigmatizohen dhe t'i nënshtrohen turpit, numri më i madh përkrasin stigmatizimin dhe argumentojnë se qytetarët duhet të informohen se personi nuk është i punësuar në mënyrë të rregullt në shërbimin publik, por "i përpunon orët e përcaktuara nga ana e gjyqit si pjesë e masës së marrë".

Njohja dhe informimi i opinionit sa u përket masave është e domosdoshme, e sa i përket mënyrës nëpërmjet të cilës mund të rritet vetëdija publike, të anketuarit përmendin fushatat e medimeve, tribunat publike, trajnimet, shpërndarjen e broshurave dhe doracakëve të ndryshëm, si dhe emisionet kontaktuese të medimeve elektronike për burime themelore të njohjes nëpërmjet të cilave mund të njoftohet dhe edukohet popullata. Një propozim pak më ndryshe u ofrua nga ana e komunës së Çairit, që paraqet edhe befasi duke marrë parasysh iniciativën për marrjen e aktivitetit të hulumtimit të opinionit publik të qytetarëve, që paraqet edhe hap konkret të vetiniciativës dhe angazhimit të asaj që padyshim do ta prekë vetë komunën me sendërtimin e këtyre masave në praktikë.

## KONKLUZIONE

Bashkësia ka rol të madh në sistemin e zbatimit të masave alternative. Parakushte themelore për pranimin e rolit të këtyre bashkësisë të organizuar nëpërmjet komunës, janë mendimet se vepra penale është kryer në bashkësi, është e orientuar ndaj individëve në bashkësi, në kushte dhe gjendje që ekzistojnë në bashkësi, të cilat paraqiten si faktor shoqëror që ndikon në kryerjen e veprës penale ose paraqitjen e krimit.

Masat alternative për nga natyra dhe qëllimi i vet janë masa të cilat duhet të zbatohen në liri në bashkësi. Duke marrë parasysh atë se bashkësia, e organizuar nëpërmjet komunës do të duhej të kishte rol veçanërisht aktiv në procesin e zbatimit të tyre dhe në procesin e krijimit të politikave. Veçanërisht i rëndësishëm është roli i bashkësisë në procesin e preventivës dhe mënjanimin e kushteve, faktorëve, rrethanave që e inkurajojnë ose, madje e mundësojnë sjelljen kriminale. Prandaj, nevoja për informim të përhershëm, bashkësi aktive dhe kreative është e domosdoshme që masat alternative të cilat do të zbatohen në të të zbatohen në mënyrë përkatëse. Gjithashtu, gjatë sjelljes së çfarëdo qoftë konkluzionesh lidhur me komunën dhe sa janë ato të njoftuara me masat alternative, me politikën ndëshkimore, sa munden në mënyrë të organizuar t'i përgjigjen një sistemi ndëshkimit i cili pjesërisht do të zbatohet në liri, në bashkësi, doemos duhet të merret parasysh se tash nuk ekziston asnjë obligim ligjor për komunën që të veprojnë në këtë plan. Në pajtim me përgjigjet e përfaqësuesve të komunave do t'i marrim si bazë për punën e mëtejme. Kjo është një temë për të cilën doemos duhet të flitet shumë dhe për të cilën duhet të bëhet shumë.

Megjithatë, në mënyrë që të fitojmë një pasqyrë të përgjithshme për relacionin e komunave dhe masat alternative, prej përgjigjeve të pyetësorëve mund të nxirren konkluzione të caktuara. Në të vërtetë, sipas legjislacionit ligjor ekzistues për rregullimin e sferës së masave alternative dhe Ligjit për vetadministrim lokal, nuk ekziston asnjë dispozitë e cila e obligon komunën në çfarëdo qoftë mënyre me politikën ndëshkimore të shtetit, e as me masat alternative si specifike. Kështu, përfaqësuesit posedonin disa njohuri parimore për atë që paraqesin masat alternative. Krahas me izolimin e këtyre, është edhe mosbashkëpunimi i komunës me organet tjera, të cilat paraqiten në sistemin e zbatimit të masave alternative. Më saktë, bashkëpunimi që e kanë vetëm me qendrat për punë sociale sa i përket angazhimit punues të personave që marrin ndihmë sociale. Me organet tjera nuk kanë komunikim. As që dihen ndërmarrjet ose institucionet dhe organizatat tjera publike, as që ekzistojnë rregulla të vendosura të lojës me ndarjen e kompetencave, as që ekziston ndonjë strukturë

organizative, e as financa. Gjendja e këtillë është mjaft e padëshirueshme nëse kemi parasysh se puna e gjithëdobishme do të realizohet në bashkësi, në liri, e do të kryhet në ndërmarrjen publike e cila është në kompetencë të komunës. Mund të përfundojmë se tash për tash në Republikën e Maqedonisë nuk ekzistojnë kushte të cilat do të mundësojnë realizimin adekuat të qëllimeve dhe detyrave të cilat organet e sipërpërmendura do të insistojnë t'i kryejnë.

## REKOMANDIME

Duke marrë parasysh atë se hulumtimi që u bë në mënyrë tematike dhe u nda në disa pjesë, në të njëjtin drejtim do t'i prezantojmë edhe rekomandimet e përgjithshme të cilat dolën nga analiza e gjendjes me sanksionet dhe masat alternative në Republikën e Maqedonisë. Kështu, rekomandimet do t'i dedikohen nivelit të legjislacionit dhe nivelit të rekomandimeve drejtuar organeve që duhet t'i zbatojnë.

## LEGJISLACIONI

Janë të domosdoshme risaktësime plotësuese të zgjidhjeve ligjore ekzistuese si lidhur me rregullimin e disa sanksioneve dhe masave alternative, ashtu edhe lidhur me kompetencat e organeve të cilat janë të përfshira drejtpërdrejt në procesin e zbatimit të tyre. Në këtë drejtim nevojiten ndryshime në Kodin penal, në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, në Ligjin për gjykatat, në Ligjin për mbrojtje sociale.

Sa u përket ndryshimeve në Kodin penal, propozojmë zgjerimin e listës me obligimet të cilat mund t'i shqiptojë gjykatësi së bashku me dënimin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, të cilat do të mund ta zgjeronin sasinë e mundësive për situata të ndryshme dhe kryerës të ndryshëm.

Më tutje, propozojmë ndryshimin e kushtit "kundërvajtës për herë të parë" në situatat kur mund të shqiptohet puna e gjithdoshme. Kjo ngase njëra nga kritikrat për burgun është pikërisht fakti që në masë të madhe të burgosurit janë edhe recidivistë.

Nëse mbetet kushti i këtyre, kritika e mëparshme ngel vetëm si kritikë, pa ndonjë mundësi tjetër për t'u marrë me këta njerëz. Nga ana tjetër, jo gjithnjë delikti i parë e bën të dytin më të rëndë me qëllim që personi të mos ketë shans tjetër edhe në sanksionim. Argument tjetër në këtë drejtim është pikërisht parimi i mosdiskriminimit kur është fjala për zbatimin e këtyre sanksioneve dhe masave.

Pikërisht në këtë kontekst është zbatimi i dispozitës së veçantë me të cilën do të vërtetohej pikërisht parimi i mosdiskriminimit, si dhe zbatimi i dispozitave për mbrojtjen e të drejtave të personave të cilët do t'i zbatojnë, përkatësisht do të sanksionohen me këto alternativa.

Duke marrë parasysh atë se masat alternative në të njëjtën kohë edhe do të mbikëqyren, përkatësisht gjatë zbatimit të tyre, personave do t'u ofrohet ndihmë, kujdes dhe mbikëqyrje, dispozitat ekzistuese në Kodin penal dhe në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, është e domosdoshme që të harmonizohen pikërisht në raport me organin kompetent për kryerjen e kësaj mbikëqyrjeje (veçanërisht te puna e gjithdoshme dhe te mbikëqyrja shtëpiake). Në të njëjtën kohë, do të duhet të përcaktohen në mënyrë precize të drejtat dhe obligimet e personave të cilët do ta zbatojnë mbikëqyrjen. Nuk guxon të harrohet as mbrojtja e këtyre personave duke marrë parasysh atë se puna e tyre mban me vete rreziqe të posaçme duke marrë parasysh specifikën e materies që përfshijnë. Prandaj, nevojiten mekanizma të caktuar mbrojtës të cilat po ashtu do të jenë aq specifike që nuk do ta çrregullojnë jorepresivitetin në

karakterin e shërbimit që e kryejnë. Karakteri i veçantë që e ka burgu shtëpiak si sanksion, paralajmëron edhe nevojën e përcaktimit preciz dhe përdorimin e mundshëm të shërbimeve të policisë, më saktë se çfarë shërbimesh do të mund të kërkoheshin, në atë masë do t'i realizojë, se a do të përdoret arma ose jo, cilat do të jenë kompetencat dhe detaje të ngjashme.

Ndryshimet në këto ligje në mënyrë të domosdoshme do të sjellin në nevojën e ndryshimeve edhe në tekstet tjera ligjore, si për shembull në Ligjin për gjykatat, ku në mënyrë të veçantë do të duhej të theksohej ekzistimi i gjykatësit për zbatimin e sanksioneve, kurse në mënyrë më të hollësisht funksioni do të përpunohej në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, ku momentalisht ekzistojnë dispozita të caktuara, por megjithatë janë parimore. Po ashtu, duke marrë parasysh atë se me Ligjin për procedurën penale, Kodin penal dhe me Ligjin për zbatimin e sanksioneve rregullohet pozita dhe roli i qendrave për punë sociale, ndryshimet e këtill udhëzojnë edhe në nevojën e ndryshimeve në Ligjin për mbrojtje sociale, i cili e rregullon veprimtarinë e këtyre organeve.

Zgjidhjet ekzistuese momentale ligjore ofrojnë suaza të përgjithshme të cilat është e domosdoshme të riprecizohen dhe konkretizohen me legjislacion nënligjor përkatës për çdo masë veçanë.

## PROKURORITË THEMELORE PUBLIKE

Për shkak të nevojës që masat alternative të zbatohen nga fazat e mëhershme në procedurë dhe me pjesëmarrjen e më shumë organeve veçanërisht jorepresivët, prokurori publik duhet që më shpesh në propozim-aktakuzë të inkorporojë edhe llojin e sanksionit penal, posaçërisht masën alternative. Është e domosdoshme që prokurori publik të ketë pasqyrë të tërësishme për profilin, përkatësisht për personalitetin e kryerësit në mënyrë që të mund ta përcaktojë llojin e masës alternative të cilën mund ta propozojë. Për këtë qëllim, që është edhe në pajtim me nenin 21 të Ligjit për prokurorinë publike, prokurori publik më shpesh duhet t'i shfrytëzojë organet tjera si burim të informatave. Në rastin me propozimin e masave alternative duhet ta përfshijë Qendrën për punë sociale dhe ta shfrytëzojë mendimin e tij lidhur me profilin e personit me qëllim që të marrë analizë profesionale për personalitetin, për motivet dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, i cili do të jetë i domosdoshëm gjatë propozimit të llojit konkret të masës alternative. Kësisoj do të shtohet edhe praktika e propozimit të llojit të sanksioneve penale dhe do të precizoheshin dhe zhvilloheshin metodat dhe kriteret e nevojshme për zbatimin e masave të caktuara alternative. Kjo jo vetë që do të shkonte në favor të zhvillimit të praktikave të prokurorët publikë, trajtimit përkatës të personave të akuzuar në situata të caktuara ku ka mundësi të zbatohet masa alternative, por do të ishin të dobishme edhe për gjykata të cilat nuk kanë të dhëna plotësuese për përcaktimin në mënyrë, matjen dhe shqiptimin në mënyrë precize të masës përkatëse alternative. Pikërisht sa i përket grumbullimit të të dhënave dhe etablimit të bashkëpunimit me institucionet tjera, duhet të nënshkruhen memorandume për bashkëpunim ndërmjet të gjitha organeve të involvuara. Memorandumet e këtilla për bashkëpunim jo vetëm që do të ishin mjet për mbajtjen e komunikimit ndërmjet organeve, por do të pengonin që i njëjti të ndërpritet nëse ndërrohet personeli në çfarëdo qoftë organi, përkatësisht do ta mbanin vazhdimësinë e aktiviteteve dhe zhvillimin e sistemit të masave alternative. Kjo ndodh nga se, edhe pse ekziston obligim ligjor për të gjitha organet që të bashkëpunojnë ndërmjet vetes, një praktikë e këtillë nuk ekziston. Ndoshta mënyra e këtillë do të mundësojë që ajo të vendoset ose, atje ku nevojitet, të thellohet dhe të zhvillohet.

Duke pasur parasysh atë se legjislacioni penal maqedonas insiston që gradualisht të inkorporojë elemente të së drejtës restrative, roli i viktimës doemos duhet të ketë rëndësi të posaçme edhe në këtë pjesë të procedurës. Prandaj nevojitet përfshirja aktive e viktimës



së veprës penale në procesin e vendosjes për zbatimin ose për propozimin e masave alternative. Kjo nënkupton si marrjen parasysh të momenteve të parapara ligjore momentale për rolin e viktimës, ashtu edhe të mbajturit llogari për nevojat e saj reale dhe sigurimin e mbrojtjes së saj.

Përdorimi përkatës i masave alternative është i lidhur edhe me organizimin përkatës të gjitha organeve implementuese. Prandaj është e nevojshme që në programin e sistemit dhe të organizimit të parashihet personel profesional dhe teknik i cili do t'i ndihmojë prokurorit gjatë marrjes së aktiviteteve nga aspekti i masave alternative. Duke marrë parasysh se aktivitetet e prokurorit publik në sistemin e masave alternative në janë përcaktuar në mënyrë precize, nevojitet përcaktimi decid i të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësi të prokurorëve publikë. Me këtë padyshim se ndërlihdhet edhe nevoja për trajnime edukative dedikuar prokurorëve lidhur me qëllimet e masave alternative, mënyrat e pjesëmarrjes së prokurorëve publikë në procesin e propozimit të masave alternative dhe ngjashëm. Pikërisht nga aspekti i përsosjes profesionale të prokurorëve publikë, buxheti i prokurorisë publike parasheh edhe me ligj ndarjen e mjeteve për këtë qëllim. Prandaj, për shkak të profesionalizimit të prokurorëve publikë në temën e masave alternative duhet të përcaktohet zë i veçantë buxhetor (që në moment nuk ekziston). Gjithashtu, në këtë drejtim duhet të shfrytëzohet edhe Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë, duke marrë parasysh funksionin e saj themelor.

Duke marrë parasysh atë se prokurorët publikë ishin skeptikë sa i përket pranimit të këtyre masave nga ana e opinionit, prokuroria publike në pajtim me obligimin ligjor të nenit 8 të ligjit për prokurori publike, duhet ta informojë opinionin si për gjendjen me krimin, ashtu edhe me opsionet që janë në dispozicion sa i përket sanksionimit. Kjo do të kishte me rëndësi të veçantë në fillim të zbatimit të masave, deri sa opinionin nuk sensibilizohet dhe nuk i pranon masat e këtilla si adekuate për preventivin e krimit në bashkësinë dhe të zvogëlojë stigmatizimin e personave, të cilët do të zbatojnë masa alternative në liri.

## GJYKATAT THEMELORE

Roli më i rëndësishëm i gjykatësve, i cili në të njëjtën kohë është edhe detyra më e vështirë, pikërisht është vendosja dhe shqiptimi i sanksionit adekuat për kryerës përkatës të veprës penale. Është e qartë se kur është fjala për praktikën gjyqësore në shqiptimin e masave alternative, gjykatësit plotësisht janë inertë dhe të pavendosur. Ndoshta frika nga zbatimi i asaj që është e re dhe e pakontrolluar është në prapavijë, ndoshta pikërisht për shkak të gjendjes së kritikës së përhershme të cilës i nënshtrohen gjykatësit ose ngjashëm, me arsyetimin për zbatimin e masave. Megjithatë, duke marrë parasysh rolin që e kanë gjykatësit në krijimin e politikës ndëshkimore, është i domosdoshëm edhe intervenimi i tyre në këtë plan. Nevojitet iniciativë më e madhe në zbatimin e zgjidhjeve të reja ligjore për sanksionet dhe për pranimin e rolit më aktiv në iniciimin e ndryshimeve në praktikën e vjetruar të “luajtjes në sigurt” dhe zbatimi më i shpeshtë i masave alternative. Domethënë, është i domosdoshëm ndryshimi i rolit të gjykatësit. Nevojiten gjykatës të cilët do të jenë aktivë gjatë gjithë zhvillimit të procedurës, që do të jenë të informuar, kreativë, të përkushtuar dhe fleksibilë. Po ashtu, nuk duhet të anashkalohej edhe fakti se ndoshta për disa gjykatës burgu ende paraqet mënyrën e vetme të sigurt dhe të mirë për ballafaqim me kriminelët. Është i domosdoshëm ndryshimi edhe në këtë drejtim, përkatësisht mund të thuhet se kërkesat e këtilla janë të mëdha duke marrë parasysh gjendjen momentale në Republikën e Maqedonisë.

Duke marrë parasysh atë se është e domosdoshme që nevoja e përmendur nuk është i vetmi kriter për ndryshimin e politikës ndëshkimore dhe efektuimin e zgjidhjeve ligjore

ekzistuese dhe parimore, nevojitet miratimi urgjent i akteve nënligjore, udhëzimeve, rregulloreve, doracakëve për përpunimin e hollësishtëm të mekanizmit të zbatuar në mënyrë të përgjithshme për zbatimin e masave alternative. Ose miratimi i rregulloreve të veçanta për zbatimin e punës së gjithdoshme, por edhe për masa tjera të cilat do të zbatohen në bashkësi. Kuptohet, një aktivitet i këtillë duhet të dalë prej strukturave në nivel më të lartë menaxhues/shtetëror, megjithatë kujdesi që doemos duhet ta kenë gjykatësit gjatë përgatitjes së dokumenteve të këtilla është i pashmangshëm. Nëse intenca jonë është që të sigurojmë zbatimin e vërtetë, adekuat të masave, gjykatësit doemos duhet të përfshihen në krijimin si të politikave, ashtu edhe konkretisht të japin kontributin e vet ndaj krijimit edhe të dokumentacionit të nevojshëm. Në këtë drejtim doemos duhet të bëhen ndryshime si në Ligjin për gjykatësit, Rregulloren gjyqësore dhe në Ligjin për zbatimin e sanksioneve, ku do të precizohet dhe definohet konkretisht roli i gjykatësit për zbatimin e sanksioneve në implementimin e masave alternative. Duke marrë parasysh faktin se gjykatësit gjykues pa dyshim janë të ngarkuar me një vëllim të madh të detyrave punuese, e duke marrë parasysh atë se masat alternative kërkonin përkushtim, përsheptim dhe përpikëri në zbatim, është e domosdoshme të formohet ekip profesional në suazat e gjyqit ose si trup ndihmës për gjykatësin gjykues, që është në pajtim edhe zgjidhjen ligjore të nenit 12 të Ligjit për gjykatësit. Ky ekip do të duhet t'i shfrytëzojë resurset nga të gjitha institucionet (veçanërisht të Qendrave për punë sociale) gjatë grumbullimit të të dhënave për personalitetin e individëve në mënyrë që gjykatësi të mund të ketë pasqyrë më të plotë për personin. Në të vërtetë, përfshirja e Qendrave për punë sociale duhet të bëhet që në fillim të procedurës me ç'rast ekipi profesional ose gjykatësi gjykues do të inkuadrohej drejtpërdrejt në procesin e përgatitjes së analizës së profilit, përkatësisht vlerësimin të personalitetit të kryerësit. Gjithashtu, duke marrë parasysh atë se momentalisht gjykatësit si burim themelor të të dhënave për personat shfrytëzojnë evidencat e MPB, së shpejti do të duhet ta marrin edhe këtë funksion dhe të mbajnë evidencë personale me të cilën do të disponojnë çdo moment.

Gjithashtu, me rëndësi të posaçme është që gjykatësit me kohën, nëpërmjet zbatimit të masave alternative të ndërtojnë sistem për kategorizimin e llojeve të veprave penale dhe kategori të kryerësve ku masat alternative do të kenë zbatim më të madh dhe efekte më të mëdha. Në të njëjtën kohë kjo çon në përfundimin se gjykatësit duhet të krijojnë edhe programe personale evaluimi nëpërmjet të cilave në të vërtetë do të mund t'i vlerësojnë dhe notojnë praktikat që i zhvillojnë dhe rezultatet që i arrijnë.

Duke pasur parasysh atë që u përfundua më lart se bashkëpunimi momental që ekziston ndërmjet gjykatave dhe organeve tjera (edhe pse është obligim ligjor) nuk është në nivelin e kënaqur, kurse diku edhe nuk ekziston, është i domosdoshëm miratimi dhe nënshkrimi i memorandumeve për bashkëpunim ndërmjet organeve kompetente për zbatimin e masave alternative. Është e domosdoshme mbajtja e vazhdueshme e takimeve koordinuese me të gjitha organet implementuese në kuptim të përcaktimit të mekanizmave organizative dhe përcaktimit dhe precizimit të kompetencave, mënyrave të zbatimit, detektimit të mangësive, evaluimit të praktikave e ngjashëm.

Pikërisht për shkak të praktikës joekzistuese, mosinformimit të gjykatësve për përmbajtjen, qëllimet e masave alternative, mënyrave të zbatimit të tyre, është i domosdoshëm organizimi i trajnimeve edukative. Gjatë zbatimit të masave veçanërisht në këtë periudhë kalimtare, lehtësim i madh për gjykatësit do të ishte nëse përgatiten doracakë të cilët do t'i dedikohen zbatimit praktik të masave alternative në kontekst të kompetencave, mënyrave të komunikimit ndërmjet organeve, kryerjes së mbikëqyrjes dhe informimit të ndërsjellë, zbatimit dhe revokimit të masave. Këta doracakë do të përmbanin edhe mundësitë që i kanë në dispozicion gjykatësit lidhur me korpusin e obligimeve që mund t'u shqiptohen kryerësve të veprave penale, obcionet për zbatimin e punës së gjithdoshme, d.m.th., listat e institucioneve, organizatave të cilat ofrojnë ose kërkojnë shërbime të caktuara, obcionet që ekzistojnë në

vetadministrimin lokal, mundësitë dhe praktikata e vendeve tjera që mund të ofrojnë ide për evitimin e gabimeve dhe realizimin e praktikave efikase e ngjashëm.

Në kontekst të edukimit, e duke marrë parasysh atë se masat alternative i kushtojnë kujdes të posaçëm edhe viktimës, nevojitet organizimi i trajnimeve edukative, këshillimeve ose seminareve nga sfera e shkencës së viktimologjisë që do të shkojë në dobi të përmirësimit të saj. Në për gjithësi, edukimi dhe përsosja profesionale e gjykatësve është edhe pjesë e dokumentit për reforma në jurisprudencë, ku është precizuar se kjo është e drejtë dhe obligim i gjykatësit. Nga ky aspekt, është i domosdoshëm sigurimi i trajnimit në këtë sferë, sepse masat alternative janë qëllim strategjik i dokumentit reformues për jurisprudencën. Duke marrë parasysh se para do kohe u reformua edhe Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë<sup>157</sup>, këto nevoja doemos do të duhet të realizohen nëpërmjet të njëjtës, sepse kjo është edhe veprimtari e saj themelore.

## DREJTORIA PËR ZBATIMIN E SANKSIONEVE

Në suazat e Drejtorisë nevojitet formimi urgjent i një seksioni të veçantë për masat alternative që është paraparë të ekzistojë në suazat e Drejtorisë. Edhe pse Ligji për zbatimin e sanksioneve bën fjalë për një seksion për zbatimin r sanksioneve në suazat e qendrave për punë sociale, është e domosdoshme që sa më shpejt të formohet edhe në suazat e këtij organi. Sa i përket gjendjes së këtyre, nuk është në rregull që Ministria e Drejtësisë të paraqesë informata për ekzistimin e një strukture organizative përkatëse (në suazat e saj), për këtë ta informojë opinionin, ta sjellë në lajthitje.

Duke marrë parasysh atë se ish ekipin menaxhues të Drejtorisë ka pasur aktivitete përkatëse në drejtim të përgatitjes së legjislacionit nënligjor, kanë pasur vizita në vendet e jashtme prej nga kanë marrë përvoja e ngjashëm, që do të thotë se rezultate të caktuara me siguri janë arritur, transferimi i informatave nga njëri ekip në tjetrin është më se obligues dhe doemos duhet të ekzistojë vazhdimësi në punë. Nevojitet të shfrytëzohen përvojat, të vazhdohet me zhvillimin e problematikës, e jo të vendnumërohet ose të fillohet nga fillimi.

Sa i përket mënyrës së funksionimit të Drejtorisë lidhur me zbatimin e masave, mbikëqyrja instruktore profesionale ndaj punës së qendrave ekskluzivisht duhet t'u dedikohet mënyrave procedurale të veprimit dhe assesi zbatimit të përmbajtjes së masës. Duke marrë parasysh se aktivitetet e Drejtorisë në masë të madhe do të implementohen me punët e qendrave, me punën e gjykatësit për zbatimin e sanksioneve nevojitet të miratohen akte nënligjore, rregullore pune dhe për bashkëpunim me organet tjera dhe përpunimi i hollësishtëm i procedurës për zbatimin e masave. Gjithashtu, Drejtoria doemos duhet të vendosë mekanizma bashkëpunimi dhe të nënshkruajë marrëveshje me komunat, ndërmarrjet publike, organizatat për zbatimin e punës së gjithëdobishme. Duhet të përgatisë rregullore për zgjedhjen e organizatave, institucioneve ku do të mund të drejtohen personat të cilët do të kryejnë punë të gjithëdobishme.

Në nivelin e politikave, është e domosdoshme që Drejtoria të përgatisë edhe vlerësime dhe parashikime të caktuara për atë se çka ofron burgun, e çka ofrojnë masat alternative. Drejtoria do të duhej ta zhvillojë politikën dhe orientimin strategjik të sistemit të masave alternative. Gjithashtu, për realizimin e këtyre qëllimeve është e domosdoshme të sigurojë përkrahje sa më të gjerë nga ana e opinionit për masat e këtyre, duke demistifikuar me këtë rast burgun si opcion për ballafaqim me krimin, por edhe me format ekzistuese alternative

<sup>157</sup> Ligji për akademi për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë, Gazeta zyrtare nr.13/06

të mosburgimit. Padyshim se përkrahje për punën e vet të këtyllë do të nevojitet të marrë edhe nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Enti për zhvillimin e veprimtarisë sociale, por edhe nga organet tjera.

## QENDRAT PËR PUNË SOCIALE

Qendrat për punë sociale si organe bartëse të implementimit të drejtpërdrejtë dhe praktik të masave alternative doemos duhet të trajnohen dhe edukohen në mënyrë përkatëse në drejtim të mirëkuptimit të qëllimeve dhe mënyrave të zbatimit, rezultateve që insiston të arrihen, modaliteteve të punës e ngjashëm. Duke pasur parasysh shkallën e informimit dhe të njohjes për masat alternative, nevojitet organizimi i trajnimeve, mbajtja e seminareve dhe simulimeve me qëllim që sistemi i masave alternative të fitojë kuadër profesional dhe të kualifikuar për zbatimin dhe për zhvillimin e tij të më tejme.

